DEIZMI

Zvetënimi i mendjes



Osman Nuri TOPBASH



Titulli origjinal: Aklın Cinneti
DEİZM

Përktheu: Ilir Hoxha
Redaktor: Alban Kali
Design: Bledar Xama

PROGRESI
BOTIME

Adresa: **Sheshi "2 Prilli" / Rr: Studenti / Shkodër / Shqipëri**
Mob: **+355 67 340 6182**
http: **www.progresibotime.com**
e- mail: **rev.etika@gmail.com**

DEIZMI

Zvetënimi i mendjes

Osman Nuri TOPBASH

Përmbajtja

PARAFJALA 9

Shkaku i parë 13

Shkaku i dytë 17

Shkaku i tretë 21

BESIMI: MIRËSIA MË E MADHE 27

Kontributi i myslimanëve në shkencë 37

Deizmi 42

Ekziston një botë tjetër!.. 46

Nuk ka fe pa ligje! 50

Tre probleme 63

A ËSHTË E MUNDUR TË MOS BESOSH?!. 69

Qenie e përsosur 75

PYETJE NË VORBULLËN E VESVESEVE 85

Vdekja, dera e botës tjetër 112

Barazia tjetër gjë, drejtësia tjetër gjë! 115

A mund ta nxërë oqeanin një gotë? 118

Qabeja, pika e drejtimit 124

A është e mundur që ligjet fizike të kërcënojnë atë që i ka krijuar? 127

Nderi i gruas është në Islam! 133

E VËRTETA ABSOLUTE DHE FEJA E VËRTETË 137
Fetë e tjera dhe Islami 141
Kultura e Kuranit 149
Ligj hyjnor i lehtë dhe i natyrshëm 153
Fetë dhe luftërat 155
E vërteta absolute nuk ekziston! 161

METODA E PREDIKIMIT 165
Pyetje që presin përgjigje 171

FJALA E FUNDIT
NUK LYHET DIELLI ME BALTË! 183



Përballë imitimit dhe të vërtetës

Një piktor i famshëm pikturon disa pamje prej kësaj bote të krijuar nga Allahu i Madhëruar. Më pas, për të ekspozuar ato piktura, hapen galeri që frekuentohen nga njerëzit. Madje, ata paguajnë edhe shuma të majme për të blerë qoftë edhe një tablo. Ndërsa piktori vlerësohet si "artist i madh". Mirëpo, artisti i vërtetë është Mjeshtri Absolut, i Cili ka krijuar edhe piktorin, edhe pamjet e vërteta që ai zgjedh për të pikturuar. Artisti i vërtetë është Krijuesi ynë i Madhëruar, i Cili ka krijuar njeriun dhe gjithçka tjetër.

Zemrat e urta i sodisin pamjet reale dhe madhështore që janë vepër e penelit të fuqisë absolute dhe që ndryshojnë çdo sekondë përgjatë njëzet e katër orëve, pa iu pakësuar dhe pa e humbur bukurinë. Mirëpo, indiferentët nuk ndjejnë admirim përballë artit të Mjeshtrit Absolut që ka krijuar gjithçka, por e ndjejnë përballë artit të një piktori të dobët, të përkohshëm dhe imitues.

Të hapim sytë dhe zemrën tonë, e të shohim:

Buqetat e ngjyrave në agim dhe në perëndim... Manushaqet,

zambakët dhe trëndafilat që dalin me një mijë e një ngjyra prej tokës së zezë... Detet, lumenjtë, malet dhe luginat... Pra, nëse njeriu e sheh veten dhe gjithësinë me syrin e dashurisë dhe pasionit, është e pamundur që ai të mos mahnitet para madhështive dhe mrekullive hyjnore.

Ndërsa miqtë e Allahut kanë një zemër të rafinuar dhe nuk janë si piktori, i cili pikturon vetëm për të shtuar famën e vet. Ata jetojnë me zemrën plot me emocion dhe admirim përballë Artistit të vërtetë dhe veprave të Tij. Ata arrijnë të ndjejnë kënaqësinë e artit hyjnor në mrekullitë e pafundme që ka shpalosur në natyrë fuqia hyjnore. Ata vështrojnë gjethet dhe lulet shumëngjyrëshe të bimëve të mbira e të rritura nga i njëjti dhé, variacionet e ngjyrave, frutat me lloj-lloj ngjyrash, aromash e shijesh, dekoret e mrekullueshme të krahëve të fluturave, të cilat kanë vetëm një apo dy javë jetë, mrekullinë në krijimin e njeriut, si shikimin e syrit dhe mendimin e trurit dhe dëgjojnë me vëmendje fjalët e mrekullive të pafundme hyjnore.

Për njerëzit e tillë, tashmë, e tërë gjithësia, është si një libër i gatshëm për t'u lexuar. Urdhri i parë i Zotit tonë për njerëzimin, është:

اِقْرَاْ بِاسْمِ رَبِّكَ الَّذِى خَلَقَ

"Lexo me emrin e Zotit tënd, i Cili krijoi (gjithçka)!" (Alak, 1.)

Një i urtë thotë:

"Në të vërtetë Allahu nuk është i fshehtë, por është i padukshëm për kapacitetin dhe aftësinë tonë dalluese si shkak i intensitetit të shfaqjes së Tij."

Allahu i Madhëruar, është autori i manifestimeve të madhështisë dhe fuqisë hyjnore që shfaqet në çdo gjë. Këtë të vërtetë e kuptojnë më mirë zemrat e ndriçuara që thellohen në meditim.



PARAFJALA

Falënderuar qoftë përjetë Allahu i Madhëruar!..

Selamet dhe salavatet e pafundme qofshin mbi Profetin ﷺ!

Allahu i ka dhuruar njeriut një mirësi shumë të madhe:

Mendja

Allahu i Madhëruar na ka falur mendjen që të diferencojmë të mirën nga e keqja. Nga kjo varet edhe përgjegjësia e njeriut në aspektin fetar. Pra, vetëm nëse dikush është privuar nga kjo mirësi, nuk është përgjegjës për obligimet fetare.

Mirëpo;

Të jetuarit pa përgjegjshmëri edhe pse zotëron një mendje të shëndoshë, është shndërruar në një ambicie mashtruese mes njerëzve, që prej Ademit عليه السلام. Një ambicie kjo që shpreh

robërinë ndaj egos, e cila i kthen në burg të dyja botët. Një robëri kjo që shpreh skllavëri ndaj shejtanëve me njëmijë e një lakmi dhe dëshira, mes llomotitjeve për liri.

Mirëpo, mendja nuk është dhuruar për të arritur tek kjo robëri dhe skllavëri e frikshme. Përkundrazi, ajo është një peshore hyjnore që është dhënë për të mos rënë në këto kurthe, një peshore e vetëdijshme që ndan të mirën nga e keqja.

Nëse s'do të ishte kështu;

Njeriu do të rrokullisej prej indiferencës në indiferencë dhe do të kthehej në një hutaq që godet veten me armën e vet.

Nisur nga kjo;

Është kusht që mendja të jetë e ekuilibruar dhe të mos bjerë në teprim ose pasivitet.

Dhe kjo;

Është e mundur vetëm duke pasuar Kuranin dhe Profetin ﷺ, të cilët, Fuqia që na ka krijuar prej asgjësë, i ka caktuar si udhërrëfyes për ne. E thënë ndryshe, kjo është e mundur vetëm me Islamin.

Mendja është mjet. Është si një thikë me dy presa e cila mund të shërbejë edhe për mirë, edhe për keq. Dhe i pari që tentoi të debatojë me Krijuesin duke e vënë mendjen në shërbim të së keqes, ishte Iblisi, shejtani i mallkuar. Ai u dëbua prej mëshirës hyjnore dhe u vu në shërbim të devijimit. E gjithë kjo sepse ishte kapluar nga sëmundja e xhelozisë dhe duke kaluar në çmendurinë e smirës, guxoi të protestonte vlerën që Allahu i Madhëruar i dha Ademit.

Të analizojmë drejtë:

Mendja nuk e pengoi atë prej këtij veprimi idiot. Përkundrazi, ajo e ndihmoi atë të arsyetonte gabimin në bazë të logjikës, duke pretenduar një logjikë absurde, si epërsia e

zjarrit ndaj dheut. Kështu, ai devijoi nga rruga e drejtë dhe u mallkua.

Ky rrezik vlen edhe për ne që kemi mendje të shëndoshë.

Për këtë arsye;

Zoti ynë na ka dhuruar një udhërrëfyes të besueshëm që do ta mbajë mendjen në rrugën drejt së mirës dhe do ta ruajë nga e keqja:

Kuranin dhe Sunnetin, pra, Islamin.

Sepse;

Çdo ide, mendim, drejtim, rrymë dhe botëkuptim tjetër jashtë tij, është përherë i prishur. Shejtani -mallkimi qoftë mbi të-, është duke ndjekur hapat e vet që e çojnë përjetësisht në Xhehnem.

Për rrjedhojë;

Është e domosdoshme që të vërtetat hyjnore të kuptohen para se të shkohet drejt shkatërrimit të përjetshëm. Përndryshe, kur të zgjohet në kthetrat e dënimit dhe vuajtjes së pafundme, asgjë nuk do t'i sjellë asnjë dobi dhe shpëtim njeriut. Përkundrazi, do t'i shtojë atij vuajtje dhe rënkime të padurueshme.

Kjo tregon se:

Pasimi i rrymave jashtë Islamit në jetën e kësaj bote, me arsyetime të thjeshta dhe të palogjikshme, duke thënë: "Unë kështu mendoj dhe askush s'mund të më përzihet!", mund të pandehet një qejf, kënaqësi dhe argëtim i lehtë. Por në fakt, ajo është një bela shkatërruese dhe poshtëruese, e cila në ditën e gjykimit do të jetë e pamundur të përballohet.

Megjithatë;

Për fat të keq, shejtani dhe ndjekësit e tij, i bëjnë këto mendime të duken jashtëzakonisht të bukura. Përndryshe,

kush do ta blinte një shkatërrim të papërballueshëm? Askush! Prandaj, për shkak se nuk do të gjenin kurrë klientë, shejtani dhe e keqja përherë bëjnë tregti pas lloj-lloj joshjeje dhe zbukurimi. Edhe gjërat më të ulëta ata i ofrojnë të zbukuruara si nuse, me qëllim që të pandehet se nuk ka asgjë më të bukur se ato. Po kështu, ata i zbukurojnë edhe gjërat më të këqija, që kush t'i shohë, të mendojë se s'ka më mirë se ato.

Sot;

Me këtë metodë po serviret edhe ateizmi, edhe deizmi, të cilat po i injektohet njerëzimit përditë e më shumë.

Por, çfarë janë ateizmi dhe deizmi?

Zvetënim mendor.

Është dhurimi i botës së çmuar të meditimit, dëshirave dhe ambicieve të egos. Është të jetosh në gjumin e indiferencës si një anije me timon të thyer, e cila nuk e di nga ka ardhur dhe ku po shkon. Për rrjedhojë, është e natyrshme që një njeriu të tillë t'i humbë urtësia e zgjuarsia dhe t'i vdesë të kuptuarit, sepse atij i është prishur peshorja e zemrës. Për të nuk kanë kuptim manifestimet e madhështisë dhe fuqisë hyjnore, sepse syri i zemrës së tij është verbuar. Tashmë, ai është si një robot i telekomanduar i egos së vet.

Për këtë arsye, ky njeri e konsumon jetën e tij, kapitalin më të çmuar, duke rendur pas modës, markave dhe dashurive kalimtare. Ndërsa zemra e tij kthehet në një rrënojë në vorbullën e sistemeve njerëzore. Ai jeton indiferent ndaj urtësisë së jetës dhe vdekjes dhe nuk e mendon aspak të vërtetën e botës tjetër. Ai përjeton një eklips të plotë mendor.

Këtu mund të përmendim tre shkaqe që qëndrojnë në themel të këtij devijimi të ditëve tona:

SHKAKU I PARË

Largimi nga feja dhe, si rezultat i kësaj, rrethimi përsëri prej botëkuptimit të kohës së injorancës, gjë që ka ndikuar edhe tek dijetarët.

Nëse i hedhim një sy ateizmit dhe deizmit, do të shohim se këto mendime të devijuara kanë ekzistuar edhe në periudhën e injorancës, sepse edhe njerëzit e asaj periudhe u zemëruan prej ligjërimeve të Kuranit në lidhje me vdekjen dhe çka vjen përtej saj, të cilat binin ndesh me dëshirat dhe ambiciet e tyre. Madje, ata kërkuan prej Profetit ﷺ që t'i ndryshonte ato në mënyrë që t'u pëlqente atyre, duke i thënë:

"Na sill një Kuran ku nuk flitet për ringjalljen, ose ndryshoje fjalën ringjallje që përmendet aty!" (Zexhaxh, Maani'l-Kur'an ue I'rabuhu, III, 11)

"Sillna një Kuran që të mos na urdhërojë ta lëmë adhurimin e Lat-it dhe Uzza-s. Nëse Allahu nuk të zbret një Kuran të tillë, bëje ti, ose atë që të ka ardhur nga Allahu ndryshoje kështu: Në vend të ajetit për ndëshkimin, vër ajetin për mëshirën, në vend të haramit, vër hallallin dhe në vend të hallallit vër haramin!" (Uahidi, fq. 270; Alusi, XI, 85.)

Pra, ata refuzuan të jetonin si njerëz sepse ju dukej shumë e vështirë. Këta të mjerë, që pandehnin se i forti ka gjithmonë të drejtë, nuk iu qasën vendosjes së drejtësisë dhe ligjit.

Lidhur me këta lloj njerëzish, Allahu i Madhëruar urdhëron:

"Kur u lexohen shpalljet Tona të qarta, atëherë ata që nuk shpresojnë se do të dalin para Nesh, thonë:

«Na sill ndonjë Kuran tjetër ose ndërroje atë!»

Thuaj (o Muhamed)**:**

«Është e pamundur ta ndërroj unë atë nga ana ime.

Unë shkoj vetëm pas asaj që më është shpallur. Unë druaj dënimin e Ditës së Madhe, nëse e kundërshtoj Zotin tim.»” (Junus, 15)

Ja pra, kjo është pika ku deizmi dëshiron t’i shpjerë njerëzit tanë. “Zoti ka krijuar gjithësinë dhe është tërhequr mënjanë!” -thonë ata. Madje, Ai nuk përzihet në asgjë. Pra, gjoja ashtu siç ka krijuar kafshët dhe i ka lënë pa kontroll, ashtu ka krijuar edhe njeriun dhe e ka lënë të veprojë në kokë të vet. Mirëpo, nuk është aspak kështu!

Edhe krijimi i botës së kafshëve ka një qëllim të veçantë. Cila prej tyre është jashtë qëllimit të krijimit dhe e lënë pa kontroll? Asnjëra! Për shembull;

Bleta prodhon mjaltë, pula bën vezë, lopa jep qumësht, kali mban barrë, milingonat janë shembulli më i bukur i punës së përbashkët me sistem, etj., etj...

Shpendët e shumëllojshëm ekspozojnë mrekullinë e artit hyjnor. Njëmijë e një krijesa, që prej harabelit deri tek elefanti, e prej mizës tek balena, të bëjnë të admirosh i mahnitur fuqinë hyjnore. Madje, edhe kafshët si akrepi dhe gjarpri kanë një detyrë hyjnore udhëzuese, e cila i kujton njeriut tmerrin e dënimit.

Në Kuran urdhërohet:

“Ai ka vënë në shërbimin tuaj çka gjendet në qiej dhe në Tokë, të gjitha janë prej Tij. Me të vërtetë, në këto ka shenja për njerëzit që mendojnë.” (Xhathije, 13)

Kjo e vërtetë, në një ajet tjetër shprehet në këtë mënyrë:

“A nuk shihni se si Allahu jua ka bërë të mundur t’i shfrytëzoni të gjitha ato që gjenden në qiej dhe në Tokë dhe ju ka mbuluar me dhuntitë e Tij të dukshme e të padukshme?..” (Lukman, 20)

Ky ajet vazhdon kështu:

"...E megjithatë, disa njerëz polemizojnë për Allahun pa kurrfarë dijenie, pa kurrfarë rrëfyesi dhe pa libër ndriçues." (Lukman, 20)

Duhet të mendojmë se edhe kafshët janë krijuar për një qëllim dhe, në bazë të kësaj u jepet jetë dhe furnizim. Atëherë po njeriu, i cili është krijuar në formën më të bukur, a është lënë të jetojë pa kontroll dhe pa qëllim?

Përgjigja e kësaj pyetjeje jepet qartë në Kuran:

"Mos vallë, keni menduar që Ne ju kemi krijuar kot dhe që nuk do të ktheheshit te Ne (për t'ju gjykuar)**?!"** (Mu'minun, 115)

"Ai i ka çelësat e së padukshmes dhe vetëm Ai i njeh ato. Ai e di ç'ka në tokë dhe në det; asnjë gjeth nuk bie, pa e ditur Ai dhe nuk ekziston asnjë kokërr në errësirën e tokës, as e njomë, as e thatë, që të mos jetë shënuar në Librin e qartë (Leuhi Mahfudh)." (En'am, 59)

Pra, çdo krijesë, që prej më të voglës e deri tek më e madhja, është një tablo mësimdhënëse, një mrekulli e artit hyjnor...

Për rrjedhojë;

Nëse nuk arrijmë të shkojmë prej pasojës tek shkaku, prej artit tek artisti, kjo nuk është gjë tjetër përveçse një çoroditje mendore.

E çfarë mund të jetë tjetër qëndrimi indiferent, pa ndjenja dhe injorant përballë mrekullive të pafundme madhështore që ndriçojnë më së miri mendjen dhe zemrën, përveçse çmenduri dhe falimentim i mendjes?!

Mendjet e robotizuara që largohen nga shpallja hyjnore dhe ndjenjat e larta, a nuk i vënë kështu kyçin dinjitetit dhe ndjenjave njerëzore?

A nuk është një mjeran ai që mburret me mendjen e vet

dhe rrënon shpirtin e tij duke e konsideruar si pa shkak, pa qëllim dhe të rastësishëm këtë rregull të mrekullueshëm që vërehet pandërprerë në gjithësi, si në vetet e tyre, ashtu edhe në horizonte?

Nëse mendojmë me mendje të shëndoshë, në çdo gjë mund të gjejmë njëmijë shkaqe për të mediturar. Nëse shohim drejtë dhe me vëmendje çfarëdo të vërtete, në çfarëdo aspekti, për ne do të jetë bota e meditimit të një të vërtete të mrekullueshme. Le të shohim një prej shembujve të pafund:

Në vitin 1915 popullsia e botës ishte 1.5 miliardë banorë. Ndërsa sot është mbi 7 miliardë. Por, pavarësisht kësaj rritjeje kaq të madhe të popullsisë, toka nuk e humbi aftësinë e prodhimit për t'i furnizuar të gjithë. Me shtimin e popullsisë janë shtuar edhe mirësitë e sofrës hyjnore.

Ndërsa fakti që ekzistojnë njerëz që vuajnë prej urisë për shkak të indiferencës së njerëzve dhe shfrytëzimit, është tablo e një realiteti tjetër të hidhur, siç është pamëshirshmëria. Përndryshe, nëse njerëzit janë të ndjeshëm dhe nuk shfrytëzojnë të tjerët, nuk do të bëhej fare fjalë për uri. Po ashtu, sikur të shmangej edhe luksi i tepërt dhe shpërdorimi, do të dilte e do të tepronte gjithçka. Pra, sado që të rritet popullsia e tokës, del në pah një ekuilibër hyjnor në përputhje me programin e furnizimit të Krijuesit, në mënyrë që të mjaftojë për të gjithë. Për rrjedhojë, shqetësimet e verbra ndaj kësaj të vërtete, nuk janë gjë tjetër veçse indiferencë dhe injorancë.

Mbase kjo indiferencë dhe injorancë ka shkaktuar çrregullime dhe çmenduri edhe para pesëmbëdhjetë shekujve, kur popullsia nuk ishte as një miliardë. Mbase edhe atëherë kanë menduar se kjo botë nuk mund të mbajë kaq shumë njerëz. E për rrjedhojë, teprica duhet eliminuar dhe të sapolindurit duhen zhdukur!

Mirëpo, e vërteta është se, Fuqia e vetme e pakufishme që siguron furnizimin materialo-shpirtëror të domosdoshëm për njeriun në të gjitha kushtet, ka treguar përherë gjatë gjithë historisë, se sado të jetë numri i popullsisë që jeton mbi tokë, ai patjetër që do t'i furnizojë ata.

Për ata që duan të shohin, kjo e vërtetë është një manifestim i mrekullueshëm i fuqisë hyjnore.

Shekujt dëshmojnë se;

Njeriu i arrin dijet duke u zvarritur. Të gjitha informacionet e vjetra dhe të reja që i janë dhënë njeriut në çdo periudhë, në fakt, janë mëshira, mirësia dhe gostia e Zotit tonë të Madhëruar, i Cili ka dëshiruar që ne të meditojmë rreth madhështisë dhe fuqisë së Tij.

Lum ata që i lexojnë siç duhet rreshtat e mbushur me urtësi dhe të vërteta të librit të kësaj gjithësie, i kuptojnë dhe thellohen në horizontin e meditimit!

SHKAKU I DYTË

Shkaku i dytë që i tërheq njerëzit drejt deizmit është gjendja e mjeruar në të cilën ndodhet sot krishterimi.

Historia dëshmon se:

Krishterimi është boshatisur nga Pali dhe Dëshmitarët e Jehovait.

•Parimet e besimit, u vendosën nga njerëzit në Këshillat Ekumenike.

•Adhurimet u transformuan. Namazi u kthye në meshë, syneti në pagëzim, agjërimi në pehriz, etj.

•Kishës iu dha kompetenca e faljes së mëkateve kundrejt pagesës. E si mundet një njeri të fshijë gjynahet e një njeriu tjetër si vetja e tij?

•Në saje të parimit, "Jepni Çezarit atë që është e Çezarit!", u fshin parimet e fesë në lidhje me jetën e kësaj bote dhe feja u burgos në tempuj. Mirëpo, si mundet që kryetari i shtetit të jetë i vetmi autoritet që ka në dorë çështjet në lidhje me fenë dhe ndëshkimet?

•Krishterimi fanatik i refuzoi të vërtetat shkencore dhe shkencëtarët i nënshtroi me anë të inkuizicionit. Të gjithë e dinë thënien e famshme të Galileo Galileit në gjykatën e inkuizicionit.

Si reagim kundër fanatizmit të krishterë lindën mendime dhe ide në lidhje me kontradiktën mes fesë dhe shkencës, aq sa filloi të mbizotëronte ideja se;

"Nëse mbështet shkencën, duhet të largohesh nga feja!"

Mirëpo;

Aq sa i drejtë është ky reagim ndaj një feje të prishur, po aq mendim i padrejtë është kur përdoret kundër një besimi të drejtë, sepse nëse njeriu zotëron dije të vërteta, qëndron larg besëtytnive dhe e respekton edhe më shumë fenë e vërtetë.

Pra;

Kundërshtia edhe e fesë së drejtë bashkë me fenë e prishur, i ngjan atij që për t'u ruajtur nga ushqimi i dëmshëm refuzon të hajë çfarëdo ushqimi tjetër, edhe nëse ai do t'i sillte shërim, gjë e cila nuk ndryshon aspak nga një vetëvrasje. Kjo, sepse ashtu siç është kusht furnizimi material për jetën e trupit, ashtu është kusht edhe furnizimi shpirtëror për jetën e shpirtit. Për rrjedhojë, të thuash: "Unë do të heq dorë edhe nga kjo nevojë", në vend që të eliminosh vetëm të dëmshmen, është me të vërtetë një vetëvrasje idiote.

Mirëpo, një filozofi e tillë mashtruese dhe tinëzare, e cila e fsheh këtë të vërtetë pas perdeve të bojatisura dhe ua servir mendjeve në tabaka të stolisura idenë se, "kush merret me

shkencë, duhet të qëndrojë patjetër larg fesë", për fat të keq ka mashtruar shumë intelektualë, duke i bërë ata të pafe.

Një mendimtar ka thënë:

"Nëse shkenca me fenë ndahen, feja (pa dije) i shpie njerëzit në prapambetje, ndërsa shkenca (pa fenë) i shpie në ateizëm."

Pikërisht për shkak të këtij gabimi, u prish edhe krishterimi. Në fillim, për arsye se u shndërrua në një strukturë që u vinte përshtat dëshirave të njerëzve, kjo prishje e rrezikshme nuk shqetësoi pothuajse askënd. Mirëpo, në këtë pikë, Allahu i Madhëruar dërgoi Islamin dhe i zhvlerësoi të gjitha fetë e prishura.

Kështu, krishterimi, i cili mori vulën e zhvlerësimit nga Allahu, sot, nuk është asgjë tjetër përveçse një rozetë e pavlerë. Një rozetë që nuk i jep asnjë qetësi shpirtërore dhe morale bartësve të saj...

Në fakt;

Edhe vetë ata janë të vetëdijshëm për këtë situatë. Mirëpo, në vend që të shpëtojnë prej kësaj, ata duan të qetësojnë ndërgjegjet e tyre duke e tërhequr edhe Islamin në këtë gjendje të ulët. Madje, pa pikë turpi, ata na e këshillojnë edhe ne myslimanëve këtë gjë. Njësoj si një i sëmurë rëndë, i cili në vend që të kërkojë shërim, i thotë doktorit: "Merre edhe ti sëmundjen time e mos më lër të vdes vetëm!". Dhe, pikërisht me një logjikë të tillë të prishur, Papa aktual Francesku shprehet kështu në një reportazh:

"Ashtu siç kemi vepruar ne me tekstet tona të shenjta, është mirë që edhe myslimanët të bëjnë një punë kritike mbi Kuranin. Metoda e interpretimit historik dhe kritik do ndihmojë në zhvillimin e tyre."

Mirëpo;

Ajo që ata quajnë zhvillim, është shkarja e njerëzve në ateizëm dhe deizëm përballë absurditeteve të fesë së tyre. E më pas, këtë mikrob duan t'ia injektojnë Islamit, me qëllim që të duken sikur kanë të drejtë.

E në fakt;

Zhvillimi i vërtetë, është largimi prej të padrejtës dhe mikrobeve, e kërkimi i të drejtës dhe shërimit.

Ata duhet të shohin se;

Mali me kontradikta që kanë në vetvete, i ka shtyrë njerëzit e tyre në ateizëm dhe deizëm.

Pas ndarjes së madhe të kishës në katolikë dhe ortodokse në shekullin e XI, në shekullin e XVI një kundërshtim i fortë erdhi edhe nga Martin Luther, i cili po ashtu u bë lideri i një rryme të re brenda krishterimit. Më pas edhe kjo rrymë u nda në fraksione të vogla brenda vetes, duke nxjerrë në pah shumë botëkuptime kontradiktore. Si rrjedhojë, masat që nuk kënaqeshin më prej absurditeteve, e braktisën fenë.

Problemet që fetë e manipuluara i kanë shkaktuar njerëzimit, për fat të keq i janë atribuuar me dashje edhe fesë së vërtetë nga ana e rrymave dashakeqe të filozofisë. Kështu, ata janë munduar të përbaltin fenë dhe besimin e vërtetë, duke i përgatitur ateizmit dhe deizmit një truall më të lehtë dhe më frytdhënës për të gjelbëruar.

E në fakt, shkaku i vërtet ishte krishterimi i manipuluar.

Ndërsa Islami ka qenë gjithmonë jashtë këtyre manipulimeve, sepse ai vazhdon të jetë e vetmja fe e vërtetë nën mbrojtjen e Vetë Allahut të Madhëruar dhe në rrugën e drejtë që ka caktuar Ai, e do të vazhdojë kështu deri në kiamet.

Për rrjedhojë;

Islami nuk ka qenë dhe nuk do të jetë kurrë feja e kon-

tradiktave me shkencën dhe e boshatisjes në aspektin e besimit. Të tilla mund të jenë vetëm fetë e manipuluara nga dora e njeriut.

SHKAKU I TRETË

Shkau i tretë që i shpie njerëzit indiferentë drejt deizmit, është filozofia materialiste. E thënë ndryshe, "zhvillimi" teknologjik...

Kur Europa u largua nga krishterimi, u shënua përparim në shkencat pozitive, industri dhe fusha të tjera të ngjashme. Gjatë gjithë historisë njeriu është dehur dhe lazdruar gjithmonë prej fuqisë materiale. Shembujt më të njohur të këtij fakti janë popujt Ad dhe Themud dhe njerëzit e pushtetshëm e të pasur si Nemrudi dhe Faraoni.

Mohuesit e atyre kohërave u trazuan së tepërmi prej çdo gjëje që sollën profetët e Zotit dhe veçanërisht prej parimeve të drejtësisë, sepse ata edhe dëshironin të jetonin me egoizmin e formës "feja ime janë dëshirat e mia", por donin edhe të mos jepnin llogari e të mos dënoheshin për gjynahet e rënda dhe krimet monstruoze që kryenin. Ata nuk donin të pranonin se do të vdisnin dhe do të ringjalleshin për të dhënë llogari. Ndërsa të vërtetën absolute dhe fundin e pashmangshëm, as që donin ta mendonin. Prandaj, mohimi ishte shpëtim për ta, edhe pse historikisht asnjë mohues nuk ka shpëtuar ndonjëherë... Por, ngushëllimi i tyre i vetëm mbeti fakti se nuk e kuptuan këtë mashtrim të hidhur deri në momentin që u erdhi vdekja.

Ja pra, ashtu siç ka ndodhur në çdo kohë, edhe në shekullin e fundit u shpikën ide të ndryshme dhe ideologji të helmatisura, si kurth dhe maskë e këtij mashtrimi të madh

e të hidhur. Përmbledhja e të gjitha këtyre;

Një materializëm që mohon shpirtin dhe urtësinë...

Këto ide janë shfaqur në forma të shumta, qoftë politike, qoftë ekonomike. Por në esencë janë të gjitha mohuese...

Për shembull;

Manifestimi i tyre si komunizëm dhe socializëm, e konsideroi fenë si opium, duke e përjashtuar plotësisht nga jeta. Në emër të barazisë, këto ideologji i shërbyen vetëm një pakice partiake, e cila e fshehur pas të gjitha sloganeve që hakërronin me zë të lartë mosshtypjen e popullit, e shtypi mizorisht atë, duke e shfrytëzuar dhe dhunuar sistematikisht.

Ndërsa kapitalizmi dhe liberalizmi e shtypën popullin me anë të monopoleve dhe koorporatave. Sipas të dhënave, vetëm 1% e njerëzve zotëron 50% të pasurisë së botës. Siç shprehet edhe poeti Nexhip Fazëll;

Këtë ndarje as ujku s'e bën, mbret i qengjave po të jetë!..

Kapitalizmi tha:

"Pasuria është e individit."

E thënë ndryshe:

"Të gjithë janë të lirë të fitojnë sa të duan, si të duan."

Kur pyet:"Po të dobëtit?", thonë:

"Pasuria që vjen me lirinë do t'i kthehet të gjithëve vetvetiu. Çmimet do të lirohen, punë do ketë për të gjithë dhe të mirat do të shtohen..."

Sa keq;

Kjo është një përrallë e maskuar që dikush e ka shpikur për të shfrytëzuar edhe energjinë, edhe shpresën e njerëzve. Një përrallë që nuk realizohet kurrë.

Për rrjedhojë;

Kapitalizmi dhe liberalizmi pasuroi vazhdimisht monopolet dhe koorporatat. Ndërsa i varfri u bë edhe më i varfër dhe shumë njerëz u shndërruan në skllevër nën kthetrat e fajdeve.

Ndërkohë komunizmi deklaroi;

"Pasuria është e popullit!"

Në bazë të parimit të barazisë, të gjithë shtetasit do të bëhen punëtorë të shtetit, ndërsa shteti do ta ndajë pasurinë në mënyrë të barabartë tek të gjithë. Sigurisht që edhe kjo ishte një tjetër përrallë e shpikur për të shfrytëzuar edhe energjinë, edhe shpresën e njerëzve dhe për ta bërë këtë qëndrim të pranueshëm. Po ashtu, edhe kjo përrallë nuk u realizua kurrë.

Për rrjedhojë;

Në komunizëm, vendin e monopoleve e zuri partia. Populli punonte si skllav, ndërsa liderët e partisë gëzonin shumë privilegje dhe u bënë të pasur. E në fakt, për shkak të këtyre padrejtësive, ra edhe komunizmi.

Si përherë, vetëm Islami e zgjidhi problemin e njeriut në kundërshtim me këto dy ideologji, duke u sjellë drejtësi popujve. Kjo, sepse Islami tha:

"Në të vërtetë, pasuria nuk është as e individit, e as e popullit. Pasuria është e Allahut dhe njerëzit janë vetëm ruajtës dhe përdorues të përkohshëm të saj..."

Duke u nisur nga ky parim;

Islami e pranoi pronën private. Mirëpo, të varfrin e la nën kujdesin e të pasurit dhe të dobëtin nën kujdesin e të fortit. Ai bëri që të pasurit t'u ndajnë të varfërve prej pasurisë së tyre në formë zekati dhe sadakaje, si adhurim ndaj Allahut. Një vëllazëri fetare e jetuar në këtë mënyrë e thuri të gjithë shoqërinë me dashuri dhe mëshirë. Në saje të

besimit në botën tjetër, besimtarët e shpenzuan pasurinë e tyre në bamirësi, vakëfe dhe shërbime të ndryshme për hir të Allahut. Në saje të moralit të bukur, ata i trajtuan të varfrit me mëshirë dhe dhembshuri.

Kurse ideologjitë që shfrytëzuan njeriun, nga një anë i rrënuan ata materialisht, e nga ana tjetër u injektuan atyre indiferencën, duke i mbajtur të zënë me gjëra të padobishme dhe negative.

Në këtë mënyrë, njerëzimi nuk mundi të shohë gjë tjetër përveç egos, materies dhe interesit. Ndërkohë që ndërgjegjeve u shteroi mëshira dhe dhembshuria...

Parimi i kapitalizmit: "të gjithë janë të lirë të fitojnë sa të duan, si të duan", e konsideron të lejueshme pothuajse çdo mënyrë për të arritur qëllimin e dëshiruar.

Masakrat që bëhen sot në Siri, Mjanmar dhe Jemen, janë rezultat i padrejtësisë që mbron deizmi...

E ndërkohë që të varfrit dhe të dobëtit u shtypën në këtë mënyrë, shtresës elitare iu injektua mizoria dhe egoizmi. Ndërsa masat u bënë të varura nga televizioni, interneti, argëtimi dhe kënaqësitë e tjera materiale.

Nuk mbeti më asnjë parim fetar e asnjë rregull moral!.. Asnjë shqetësim për botën tjetër dhe asgjë shpirtërore që i drejtohet ndërgjegjeve dhe shpirtit!..

Një përparim i tillë i hekurit dhe mekanikës e bëri njeriun egoist. Dëshira për të jetuar "çastin" në planin material, e eliminoi edhe ndjesinë e zemrës në lidhje me botën tjetër.

Pushtimi i kulturës globale e shpërndau këtë egërsi në çdo vend të botës. Në këtë mënyrë, ata krijuan një tip njeriu i cili dëshiron të bëjë një jetë për qejf të vet, pa asnjë parim moral, ligj apo rregull fetar. Dhe ky njeri i rënë në vorbullën e jetës vetëm për kënaqësi trupore, nuk i do as rregullat e

Islamit, fesë së vërtetë, e cila e edukon njeriun me virtyte të larta, si humanizmi, mëshira, drejtësia, modestia, etj.

Pra, si rezultat i këtyre tre shkaqeve që përmendëm, një pjesë e njerëzve preferuan ateizmin dhe deizmin.

Disa e konsideruan ateizmin të frikshëm, të palogjikshëm dhe të papranueshëm. Prandaj, për të shpëtuar nga kjo situatë dhe zbrazëti, ata pranojnë vetëm ekzistencën e një krijuesi, një ideologji kjo të cilën e quajnë deizëm. Tashmë ky absurditet ka filluar të shfaqet së tepërmi edhe tek fëmijët e familjeve fetare.

Mirëpo, mes ateizmit dhe deizmit nuk ka shumë dallim.

Të dyja janë çoroditje!..

Nëse ata që anojnë nga deizmit, devijojnë në këtë rrugë me mendimin:

"Të qëndroj larg fesë, të veproj haramin, të bëj një jetë qejfi pa rregulla, por në të njëjtën kohë të mos bëhem as ateist që e mohon plotësisht Zotin!", duhet të dinë se:

Deizmi nuk ka asnjë ndryshim nga ateizmi!..

A është e mundur që në një shishe me helm që të vret edhe me një pikë, të shtosh një pikë ujë e të thuash nuk të helmon më?

E çfarë ndryshimi ka? Të dyja janë mohim!..

Ashtu siç dyfytyrësia është më e keqe se mohimi, ashtu edhe deizmi është më i keq se ateizmi.

Kjo vepër, e cila është shkruar me qëllim që këto të vërteta të kuptohen nga njerëzit tanë me mendje të pastra dhe që bota e tyre shpirtërore të mos përlyhet me këto absurditete, synon t'i përgjigjet "ateizmit" dhe "deizmit", që janë "çmenduri mendore" dhe të shpalosë para të gjithëve batakun e tyre të mohimit.

I lutemi Allahut të Madhëruar;

Që kjo vepër të jetë një udhëzues edhe për vëllezërit tanë, të cilët merren me detyrën e kumtimit të fesë, kundër pyetjeve "kurth" dhe dyshimeve që u hidhen mendjeve të të rinjve tanë në mjediset virtuale si interneti dhe të ngjashme me të.

Udhëzimi është gjithmonë prej Zotit tonë të Madhëruar.

Allahu i ruajt fëmijët tanë dhe besimin e tyre prej ateistëve, idhujtarëve dhe hipokritëve deri në ditën e kiametit!

Amin!..

Osman Nuri TOPBASH

Mars **2019** - Rexheb **1440**
Akmesxhid

Falënderoj M. Ali Esmeli dhe M. Asim Kuçukasci për mundin dhe sakrificat e tyre në përgatitjen e këtij libri dhe i lutem Allahut që puna e tyre të jetë për ta një sadaka e përhershme.



BESIMI: MIRËSIA MË E MADHE

Besimi është paqe!
Është lumturi!

Kurse mohimi është privim
nga qëllimi dhe paqja, poshtërim
dhe mjerim.

Është rrënim i zemrës!



BESIMI: MIRËSIA MË E MADHE...

Mirësia dhe begatia më e madhe e Allahut ndaj nesh, është Islami. Pra, fakti që Ai na ka nderuar me besimin e drejtë.

Besimi (imani) është aprovim me zemër dhe deklarim me gojë. Pra, ai lind në zemër dhe prej aty përhapet në gjuhën, veprat, sjelljet, moralin dhe gjithë jetën tonë.

Besimi nuk është çështje e mendjes. Sigurisht që për të besuar duhen informacione të sakta. Mirëpo, dija nuk e sjell besimin në mënyrë të drejtpërdrejtë.

Iblisi (shejtani) padyshim që e njihte shumë mirë fuqinë dhe madhështinë e Allahut. Mirëpo ai smiroi interesimin që Allahu tregoi ndaj Ademit عليه السلام dhe, duke e kundërshtuar

urdhrin e Zotit të botëve, debatoi me Të. Më pas Allahu i Madhëruar urdhëroi e tha: "Iblisi u bë prej mohuesve!"

Gjatë historisë kanë ardhur shumë njerëz si Faraoni, Ebu Xhehli dhe Uelid bin Mugire, të cilët megjithëse kanë dëshmuar shumë mrekulli dhe nuk kanë gjetur asnjë të metë për të kundërshtuar moralin, drejtësinë dhe vërtetësinë e profetëve që i kanë ftuar në rrugën e drejtë, nuk kanë besuar për shkak të ndjenjave negative të egos së tyre, si smira dhe urrejtja. Pra, edhe pse logjikisht kanë pranuar, shumë mohues e kanë refuzuar të vërtetën për shkak të mendjemadhësisë. Kjo sepse besimi është çështje zemre. Muallim Xhudi Efendi e ka shprehur kështu këtë fakt:

Nëse prej Teje nuk vjen udhëzimi, ç'të bëjë zgjuarsia, o Zot!

Edhe nëse arabishten di, ç't'i bëjë ajeti injorancës, o Zot!

Po ashtu duhet theksuar edhe se:

Islami shkon përtej mendjes. Ai është e vërteta absolute e ardhur prej Zotit të botëve. Për rrjedhojë, të kundërshtosh urdhrat dhe fenë e Allahut me mendjen e dhuruar prej Tij, është jashtëzakonisht absurde.

Kjo është pika ku feja kërkon dorëzim. E në fakt, besimi është i fshehtë. Kur njeriu të vdesë, t'i hiqen perdet dhe të shohë melekët, botën e përtejme dhe shenjat e tjera, atëherë ka mbaruar edhe sprova e tij.

E rëndësishme është t'i besosh dhe t'i ndjekësh profetët dhe librat e shenj-



Zemrat që shohin, dëgjojnë dhe ndjejnë, në këtë gjithësi nuk perceptojnë gjë tjetër përveç manifestimeve të fuqisë dhe madhështisë hyjnore. Sa keq për ata që nuk mund të flasin me trëndafilat, zambakët, e bilbilat dhe nuk e kuptojnë gjuhën e gjendjes së tyre që në këtë botë!..

të sa je në këtë botë, duke shpëtuar prej dyshimeve dhe vesveseve të egos dhe shejtanit.

Pranimi i faktit se Kurani i është shpallur Profetit ﷺ nga Allahu i Madhëruar dhe i të vërtetave në lidhje me të ardhmen në botën tjetër që premtohen në të, nuk mund të bëhet me mendje, por me zemër.



Mohimi, është një falimentim i përjetshëm që e konsumon kapitalin e jetës në këmbim të kënaqësive të përkohshme. Është një ikje e kotë, fundi i së cilës del në Xhehenem, sepse në fakt, nuk ka asnjë vend ku mund të iket. Strehimi i vetëm është Allahu i Madhëruar.

Nga ana tjetër të vërtetat Islame, që duhen besuar domosdoshmërisht, kanë përmbajtje të atillë që një mendje e shëndoshë mund t'i pranojë pa ngurrim. Pra, Islami nuk është irracional. Përkundrazi, ai është një e vërtetë dhe fuqi madhështore që edukon mendjen dhe e ngre nivelin e saj. Përndryshe, njeriu do të shkatërrohet në humbjen e përjetshme të injorancës dhe mendjelehtësisë. Pra, mendjet forcohen me anë të Islamit.

Në këtë aspekt;

Kurani dhe Suneti na sigurojnë prova bindëse në lidhje me çështjet e teuhidit, profecisë dhe botës tjetër.

Çdo zemër që nuk qaset me paragjykim, dyshim dhe ngurrim, përfiton prej argumenteve të qarta dhe të arsyeshme të Islamit, e sheh qartë të vërtetën dhe beson. Kjo, sepse Islami i është përgjigjur çdo pyetjeje që mund të vijë në mendjen e njeriut, prej imagjinatës dhe kapacitetit të tij mendor, dhe e ka rregulluar jetën tonë në mënyrën më të përsosur.

Islami është receta e vetme e lumturisë dhe paqes për myslimanët, e madje edhe për gjithë njerëzimin.

Besimi është paqe! Është lumturi! Kurse mohimi është privim nga qëllimi dhe paqja, poshtërim dhe mjerim. Është rrënim i zemrës!

Të qëndrosh indiferent ndaj pyetjeve të tilla si, "Përse u krijova? Përse është krijuar ky univers? Cili është qëllimi i krijimit?", është mendjelehtësi që buron prej një jete të nënshtruar ndaj egos.

Mohimi është një falimentim i përjetshëm që e konsumon kapitalin e jetës në këmbim të kënaqësive të përkohshme. Është një ikje e kotë, fundi i së cilës është Xhehnemi, sepse në fakt nuk ka asnjë vend ku mund të iket. Strehimi i vetëm është Allahu i Madhëruar.

Kurani Fisnik na ka paraqitur skena të shumta prej historisë njerëzore. Po ashtu, edhe Profeti ﷺ na ka paralajmëruar në lidhje me fund-kohën me anë të tablove në hadithet e tij.



Besim i pranuar, është ai që pëlqen Zoti ynë i Madhëruar, që e ka shpjeguar me anë të shpalljes dhe profetëve të Tij.

Pika e përbashkët e të shkuarës dhe fund-kohës është:

Kur njerëzimi arriti pasuri materiale dhe mirëqenie, u largua nga feja dhe vlerat shpirtërore, u bë rob i dëshirave të egos, iu rrit mendja, braktisi besimin dhe devijoi në rrugën e mohimit të fesë, botës tjetër, e madje edhe të Krijuesit të tij.

Njerëzimi është munduar që ndjenjën e besimit, e cila ndodhet në natyrën e vet, ta kënaqë me pseudofetë e shpikura apo të manipuluara prej tij. Madje, për këtë ai ka shpikur edhe lojëra fjalësh që s'janë gjë tje-

tër veçse justifikime sentimentale si: "feja e të parëve tanë", "filozofia e jetës sime", "liri e besimit", ose "ky besim me jep qetësi", etj. Mirëpo, Zoti ynë i Madhëruar u ka vënë të gjithave vulën e "mohimit".

Besim i pranuar është ai që pëlqen Zoti ynë i Madhëruar, që e ka shpjeguar me anë të shpalljes dhe profetëve të Tij.



Deklaratat e disa individëve, murgjve të pavarur apo këshillave dhe institucioneve të tjera të ngjashme, të cilët vendosin parime në kokë të tyre dhe thonë, "kjo është feja jonë", janë vetëm prodhim i një çmendurie.

Deklaratat e disa individëve, murgjve të pavarur apo këshillave dhe institucioneve të tjera të ngjashme, të cilët vendosin parime në kokë të tyre dhe thonë: "kjo është feja jonë", janë vetëm prodhim i një çmendurie. Për rrjedhojë, një tablo të tillë e shohim edhe në krishterimin e ditëve tona, i cili është ndarë në qindra fraksione dhe rryma të ndryshme.

Allahu i madhëruar ka bërë të ditur se trinia është mohim/kufr dhe se Isai عليه السلام është vetëm rob dhe i dërguari i Tij.

Ndërsa jahudizmi është manipuluar nga njerëzit lakmitarë dhe të devijuar të fesë dhe është kthyer në fenë e një race. Mirëpo, Allahu i Madhëruar është krijuesi dhe sunduesi i të gjitha racave.

Në periudhat kur në perëndim filloi të përparojë mendimi dhe shkenca, shumë njerëz të dijes u ftohën nga feja si shkak i absurditeteve të krishterimit. Madje, kishte edhe prej atyre që si reagim, u bënë të pafe. Mirëpo, ata që në vetvete e pranonin se gjithësia e ka një Krijues dhe se krijimi e ka një qëllim, e gjetën veten mes refuzimit të krishterimit të devijuar dhe besimit në ekzistencën e një Krijuesi. Për rrjedhojë,

kësaj gjendjeje ata i gjetën një emër, që buron prej një besimi besëtytë të Greqisë së lashtë, i cili quhej deizëm.

Mirëpo, aq sa larg teuhidit/monoteizmit është krishterimi i devijuar, po aq mohues dhe refuzues është edhe deizmi, i cili është një besim që bazohet në botëkuptimin e një Zoti që vetëm krijon dhe nuk përzihet në asgjë tjetër.

Ata duhej të kishin menduar pak se:

Nëse krishterimi është manipuluar, vallë a duhej që Allahu të dërgonte ndonjë profet dhe libër tjetër pas tij?

E në fakt e ka dërguar:

Ja pra, Islami, Kurani dhe Profeti ﷺ.

Këtë të vërtetë e kanë pranuar edhe shumë fatlumë prej ithtarëve të librit.

Selman Farisiu ﷺ, në rrugëtimin e tij drejt së vërtetës që e nisi prej Iranit, ka qëndruar për vite me radhë pranë murgjve, më pas ka rënë rob, është shitur dhe në fund u takua me Profetin ﷺ.



Aq sa larg teuhidit është krishterimi i prishur, po aq mohues dhe refuzues është edhe deizmi, i cili është një besim që bazohet në botëkuptimin e një Zoti që vetëm krijon dhe nuk përzihet në asgjë tjetër.

Hebreu Abdullah ibn Selam ﷺ, i cili u bë pjesë e sahabëve, sapo e pa të Dërguarin e Allahut, ﷺ, tha: “Kjo fytyrë nuk gënjen!”- dhe u bë musliman.

Islami është e vetmja fe e vërtetë e së djeshmes, e së sotmes dhe së nesërmes.

Islami është e vetmja fe e pranuar tek Allahu i Madhëruar.

Islami është e vetmja fe që ka predikuar Ademi, Nuhu, Ibrahimi, Musai dhe Isai (alejhimu’s-selam).



Islami është e vetmja fe e vërtetë e së djeshmes, e të sotmes dhe të nesërmes. Islami është e vetmja fe e pranuar tek Allahu i Madhëruar. Islami është e vetmja fe që ka predikuar Ademi, Nuhu, Ibrahimi, Musai dhe Isai (alejhimu's-selam).

Shekujt e fundit, bota Islame ka përjetuar tronditje të mëdha në aspektin e zbatimit dhe mësimit të fesë. Që prej kohës së Reformave të Tanzimatit në Perandorinë Osmane, mësimi fetar në fillim mbeti jetim, e më vonë u ndalua.

Në Periudhën e Tulipanit (1718-1730), jeta rrëshqiti vetëtimthi nga plani shpirtëror në atë të ndjekjes së dëshirave dhe kënaqësive të egos. Kjo gjendje solli edhe disfatat përballë perëndimit. Ndërsa këto disfata, të interpretuara gabimisht, lindën mendimin se gjoja feja ishte pengesë e përparimit. Si rezultat i kësaj, u shfaq sëmundja e imitimit të perëndimit në çdo aspekt dhe për fat të keq në botën Islame u bartën helme kaotike perëndimore si ateizmi, deizmi dhe reformizmi, si botëkuptime të qëllimshme kundër fesë sonë të pastër dhe madhështore, Islamit.

Në këtë periudhë, në Europë feja po sulmohej vazhdimisht nga rryma të panumërta filozofike.

Materializmi mohonte shpirtin dhe të gjitha vlerat shpirtërore, duke mos pranuar asnjë ekzistencë tjetër përveç materies.

Pozitivizmi po ashtu e refuzonte çdo gjë që nuk provohej në mënyrë eksperimentale.

Sipas tyre, vendin e fesë në shoqëri do ta zinte dhe duhej ta zinte mendja dhe shkenca.

Darvinizmi hodhi idenë se njeriu rrodhi prej kafshëve si rezultat i rastësive, duke e prezantuar njeriun vetëm si

një specie kafshe. Po ashtu, ndikimi i Darvinizmit Social në sociologji bëri që fetë të konsideroheshin si një prapambetje e shoqërive në procesin e evolucionit.

Ndërsa Frojdizmi dhe psikoanaliza ishin një mendim pervers që e vlerësonte të gjithë psikologjinë njerëzore në aspektin e kënaqësisë seksuale.

Në erën e këtyre trazirave të mbushura plot helm;

Autorë si Tevfik Fikret, Beshir Fuad, Husejin Xhahit, Abdullah Xhevdet dhe të tjerë të ngjashëm, shkruan libra, poezi, romane dhe shumë gënjeshtra të tjera, duke u përpjekur të hidhnin shpifje dhe baltë kundër Islamit. Po ashtu, ata përkthyen në osmanisht librat e orientalistëve që hidhnin baltë kundra Islamit dhe Profetit ﷺ.



Kush e siguron dhe e shpërndan në mënyrën më të saktë furnizimin e triliona, katriliona e mbase edhe më shumë gjallesave? A nuk duhet të mendojmë pak më me logjikë?

Për shembull;

Tevfik Fikret, në poezinë e tij me titull "Tarih-i Kadime Zeyl", bënte propagandën e ateizmit dhe ofendonte sheriatin/ligjin e Allahut, duke e quajtur "kitab-i kohne / ligj i prapambetur". Ndërsa në një poezi tjetër është përpjekur të shkruajë një "amentu" tjetër (parime të tjera të besimit) me titull "Haluk'un Amentusu".

Në të njëjtën mënyrë, edhe Husejin Xhahid Jalçin, ka përkthyer në osmanisht librin e mbushur plot me shpifje ndaj Islamit, me titull "Historia Islame", të orientalistit Leone Caetani dhe studimet e pozitivistit Emile Durkheim, me titull "Format

elementare të jetës fetare", duke i publikuar ato në gazeta.

Tevfik Fikret, Ahmed Riza dhe të tjerë, u bënë tregtuesit e filozofive psikoanalizuese pozitiviste, materialiste dhe darviniste, që injektonin botëkuptimin e pafesisë në botën Islame. Po ashtu, ata përhapën edhe librat e armiqve të fesë, si August Comte, Ernest Renan, Dozy dhe shumë të tjerëve.



Në vitin 1915 popullsia e botës ishte 1.5 miliardë banorë. Ndërsa tani është 7 miliardë. Por, pavarësisht kësaj rritjeje kaq të madhe të popullsisë, toka nuk e humbi aftësinë e prodhimit për t'i furnizuar të gjithë. Me shtimin e popullsisë, janë shtuar edhe mirësitë e sofrës hyjnore. A nuk duhet të meditojmë?

Të njëjtët persona, duke i përgatitur fundin Perandorisë Osmane në saje të çerdheve politike që kishin krijuar, ia imponuan këto mendime mësuesve dhe nëpërmjet tyre brezave të rinj, duke i botuar ato bashkë me vepra letrare. Për rrjedhojë, intelektualët e mëvonshëm që u edukuan nga këta breza, e përhapën edhe më shumë këtë helm në dijen dhe kulturën tonë.

Për fat të keq, qëndrimi armiqësor ndaj fesë, që u trashëgua prej asaj periudhe, vazhdon ende sot të lulëzojë nëpër qarqet akademike dhe intelektuale.

KONTRIBUTI I MYSLIMANËVE NË SHKENCË

Në periudhën që u përmend, "feja dhe shkenca" janë shpjeguar si dy gjëra të kundërta, edhe në Europë, edhe në vendet Islame. Në këtë mënyrë, brezat e rinj që ushqenin dashuri për shkencën, u ftohën nga feja. Mirëpo, nëse e analizojmë historinë, do të shihet se myslimanët kanë kontribuuar shumë në fushën e shkencës dhe inovacionit.

Për shembull;

- Algjebra, zeroja, përdorimi i numrave në matematikë dhe sistemimi i matematikës, janë bërë nga el-Hauarizmi. Më vonë këto dije kanë kaluar në Evropë.

- Gjatësia e Ekuatorit është matur në kohën e kalifit Abbasit Me'munit (786-833) nga Ahmed bin Musa dhe vëllezërit e tij. Në bazë të matjeve që ata bën në Sinxhan dhe Kufe, llogaritën me një gabueshmëri prej 2.5% se Ekuadori është 39 mijë kilometra.

- Shumë gjeni myslimanë, si Hauarizmi në matematikë, Xhabir bin Hajjan në kimi, Ebu'l-Izz Ismail el-Xhezeri në mekanikë, Fergani dhe Battani në astronomi, Ibn Sinai në mjekësi dhe shumë të tjerë, kanë realizuar shumë zbulime dhe inovacione në historinë e shkencës.

Po ashtu, ata që e bënë gjeografinë një degë shkencore më vete, ishin po myslimanët. Ditarët e udhëtimeve të Evlija Çelebiut (1611-1682), i cili ka shëtitur cep më cep shumë vende të botës, dhe të Ibni Battutës (1304-1369), i cili ka udhëtuar nga një kontinent në tjetrin për 29 vjet me radhë pa u ndalur, përbëjnë një thesar të vërtetë në fushën e historisë dhe gjeografisë.



Allahu i Madhëruar përgatit lloj-lloj mirësish për çdo stinë sipas vendeve të ndryshme, duke mos e lënë të uritur as atë që gjendet në pole, as atë në ekuador, e as të në shkretëtirë.

Kristofor Kolombi (1446-1506) pohon se ekzistencën e Amerikës e ka mësuar prej myslimanëve, më konkretisht prej Ibni Rushdit.

Biruni (973-1048) ka folur për ekzistencën e Amerikës shumë shekuj më parë. Ndërsa Piri Reis (1465-1554), në librin e tij me titull Kitab-i Bahrije,



Allahu i Madhëruar, për stinën e verës ka krijuar fruta që shuajnë etjen, si shalqiri, bostani, etj. Ndërsa për stinën e dimrit, ka krijuar fruta që plotësojnë nevojat e asaj stine me vitaminë C, si portokalli, mandarina, limoni, etj. Këto janë vetëm disa prej mirësive të Tij të panumërta...

ka përpiluar hartën e Evropës. Përveç kësaj, Piri Reis ka përpiluar edhe një hartë të botës, e cila ende sot shihet si një enigmë nga shkenca. Në këtë hartë, Ishulli i Groenlandës është paraqitur në tre pjesë, në përputhje me realitetin. Mirëpo, kjo është diçka që njeriu ka mundur ta vërtetojë vetëm duke e eksploruar atë në këmbë.

Po ashtu, edhe Idrisi (1100-1166) ka përpiluar harta të botës të ngjashme me këto të kohës sonë përpara 800 e ca viteve.

Nuk duhet harruar se;

Shumica e eksploruesve perëndimorë si Kristofor Kolombi, Magelani, Amerigo Vespucci, etj., kanë vepruar si banditë dhe grabitës. Ata shfrytëzuan për vite me radhë njerëzit e Afrikës dhe Amerikës, duke i trajtuar si skllevër dhe duke i vrarë ata. Madje, ata pothuajse i shfarosën të tëra popullsitë vendase.

Ndërsa eksplorimet e vërteta janë bërë nga myslimanët si Ibni Battuta dhe Evlija Çelebiu, të cilët e njohën botën me të gjitha bukuritë e vendeve ku shkuan.

Një nga figurat më të shquara të filozofisë së historisë, Ibni Haldun (1332-1406), konsiderohet si themeluesi i shkencës së sociologjisë. Ende sot ai vazhdon ta ndriçojë botën e shkencës me anë të veprës së tij të famshme, Mukaddime.

Ndërsa kur bëhet fjalë për arkitekturë, ai që na vjen menjëherë në mendje është Arkitekt Sinani (1489-1588), i cili jeton ende në zemrat tona në saje të veprave të tij madhështore.

Në astronomi mund të përmendim dy nga figurat më

të shquara, siç janë Ullu Bej dhe Ali Kushçu, të cilët në saje të observatorëve që themeluan dhe hartave qiellore që përpiluan, u bënë nga pionierët e parë në historinë e shkencës.

Për fat të keq, në ditët tona, në veprat e shkruara në lidhje me shkencën nën kompleksin e inferioritetit, nuk flitet aspak për këto shkencëtarë dhe gjithmonë nxirren në plan të parë vetëm shpikjet e perëndimorëve.

Ky mohim është tregues i qartë i mosmirënjohjes perëndimore. Ndërsa lindja, e pavetëdijshme ndaj vlerave të veta, tregon indiferencën dhe kompleksin e saj të inferioritetit.

E në fakt, perëndimi përparimin që ka arritur, ia ka borxh dijeve dhe shkencës që zhvilluan myslimanët. Në mënyrë të veçantë, ata u njohën me zhvillimet shkencore nëpër universitetet e Andaluzisë myslimane dhe më pas filluan të përparojnë në fushën e shkencës.



Mendo rënien e borës! Bora mbulon tokën, e cila është si një batanije për shumë krijesa. E kur bora shkrin, ne nuk përballemi me kufoma gjallesash. Pra, kush është ai që i mbron gjallesat me një mbështjellje të tillë të veçantë?

Dijetari i famshëm Fuad Sezgin ishte një shkencëtar që ia kushtoi jetën argumentimit të kësaj të vërtete. Studimet e tij kanë treguar se:

Në ditët tona, Evropa, me botëkuptimin e saj centralist, përdorimin e matematikës për herë të parë në shkencat natyrore, ia atribuon Roger Bacon-it (1219-1292), ndërsa zbulimin e "dhomës së errët", e cila është themeli i makinës fotografike, ia atribuon Levi ben Gerson-it (1288-1344). Mirëpo, të dyja këto i takojnë Ibn Hejthem-it (v. 1041), i cili ka jetuar më herët se këta.

Formulimi i trigonometrisë si një

shkencë më vete, i atribuohet Regiomontanus-it (v.1476). Por, në të vërtetë ky kontribut i takon Nasiruddin Tusi-it (v. 1274)

Ndërsa ideja e botës me qendër diellin, i atribuohet Kopernikut dhe Keplerit. Mirëpo, që të dy këta shkencëtarë janë ndikuar nga dijetarët andaluzianë, si ez-Zerkali (shek. XI).

Shembuj si këta janë të shumtë për çdo fushë.

Mirëpo siç dihet, deri në shekullin e XVI, qëndrimi i perëndimit karshi të vërtetave shkencore ka qenë shumë negativ dhe i ashpër.



Ajo reshje dëbore si një fustan nusërie, i jep prehje shpirtit. Po sikur të binte e zezë si katrani ose e kuqe si gjaku, sa rëndë do t'i vinte shpirtit tonë?

Në saje të veprave të dijetarëve myslimanë, të cilat u përkthyen në gjuhët europiane, në Evropë filluan të përhapeshin njohuritë shkencore në lidhje me astronominë. Si rezultat i këtyre zhvillimeve, Galileo Galilei, në kundërshtim me pretendimet e kishës katolike, bëri deklaratën e tij të famshme se toka rrotullohej. Për këtë arsye, ai u nxor në gjyqin e inkuizicionit dhe për të u kërkua dënimi me vdekje. Për rrjedhojë, ai u detyrua të hiqte dorë nga deklaratat e tij dhe u dënua vetëm me burgim të përjetshëm, i cili më pas u kthye në arrest shtëpie. Megjithatë, edhe pasi hoqi dorë nga deklaratat e tij, ndërkohë që po dilte nga dera e gjykatës, tha: "E megjithatë, ajo rrotullohet!"

Nisur nga kjo, është e qartë se nuk ka asnjë shkak që myslimanët të ndjehen inferior në çështjen e përparimit të dijeve dhe të shkencës.

Një shembull tjetër është edhe fakti se kur mendimtarët

më të rëndësishëm të Evropës, si Thomas Aquinas, Pascal, Descartes dhe David Hume, po i jepnin formë sistemit të mendimit, ata kanë përfituar mjaft edhe prej veprave të Imam Gazaliut.

Mirëpo, në vitet e fundit, kur këto të vërteta janë lënë në harresë, me anë të televizionit, internetit dhe telefonit, është bërë të mundur futja e rrymave negative në çdo shtëpi. Brenda këtij kaosi të madh, besimi i myslimanëve është bërë shënjestra e sulmeve të armiqve të Islamit, njëri prej të cilëve është edhe "deizmi".

DEIZMI



Deizmi është një tregues injorance. Për rrjedhojë, edhe arabët e periudhës së injorancës, thoshin se; "Ekziston një Zot, i Cili ka krijuar njeriun, tokën, qiellin, gjithësinë dhe shiun... Mirëpo, Ai nuk ka dërguar profet dhe nuk ka zbritur asnjë libër dhe ligj hyjnor. Ndërsa ne nuk do të ringjallemi dhe nuk do të dënohemi!.." Dhe ky, është mohim!..

Deizmi është një tregues injorance, sepse në fakt, edhe arabët e periudhës së injorancës thoshin:

"Ekziston një Zot, i Cili ka krijuar njeriun, tokën, qiellin, gjithësinë dhe shiun... Mirëpo, Ai nuk ka dërguar profet dhe nuk ka zbritur asnjë libër dhe ligj hyjnor. Ndërsa ne nuk do të ringjallemi dhe nuk do të dënohemi!.."

Përveç kësaj, ata adhuronin edhe idhuj të tjerë bashkë me Allahun.

Mohuesit u shqetësuan shumë prej deklaratave dhe lajmeve të Kuranit Fisnik në lidhje me vdekjen dhe çka vjen përtej saj, të cilat ishin në kundërshtim me dëshirat dhe mendimet e tyre. Për këtë arsye, ata i kërkuan Profetit ﷺ që t'i ndryshonte ato sipas dëshirës së tyre, duke i thënë:



Idhujtarët e periudhës së injorancës, ishin si deistët. Ata shkuan tek Profeti ﷺ dhe i thanë: "Na sill një Kuran ku nuk flitet për ringjalljen, ose ndryshoji fjalët ringjallje që kalojnë aty!" (Zexhaxh, Maani'l-Kur'an ue I'rabuhu, III, 11.)

"Na sill një Kuran ku nuk flitet për ringjalljen, ose ndryshoji fjalët ringjallje që kalojnë aty!" (Zexhaxh, Maani'l-Kur'an ue I'rabuhu, III, 11.)

"Sillna një Kuran që të mos na urdhërojë ta lëmë adhurimin e Lat-it dhe Uzza-s.

Nëse Allahu nuk të zbret një Kuran të tillë, bëje ti, ose atë që të ka ardhur nga Allahu ndryshoje kështu:

(Hiq lajmin për botën tjetër!)

• Në vend të ajetit për ndëshkimin, vër ajetin për mëshirën,

• Në vend të haramit, vër hallallin!.." (Uahidi, fq. 270; Alusi, XI, 85.)

Lidhur me këta lloj njerëzish, Allahu i Madhëruar urdhëron:

"Kur u lexohen shpalljet Tona të qarta, atëherë ata që nuk shpresojnë se do të dalin, para Nesh thonë:

«Na sill ndonjë Kuran tjetër ose ndërroje atë!»

Thuaj (o Muhamed):

«Është e pamundur ta ndërroj unë atë nga ana ime. Unë shkoj vetëm pas asaj që më është shpallur. Unë druaj dënimin e Ditës së Madhe nëse e kundërshtoj Zotin tim.»" (Junus, 15)

Siç do shihet, ky besim i gabuar që quhet deizëm, hiqet sikur e pranon Krijuesin. Por me këtë qëndrim ata nuk është se pranojnë Allahun, Zotin e vërtetë, por një qenie antropomorfe imagjinare që kanë shpikur vetë dhe që në të vërtetë nuk ekziston aspak. Për rrjedhojë, kjo nuk tregon

gjë tjetër veçse mohimin e Allahut një e të vetëm, urdhrave të Tij, të dërguarve, librave që ka zbritur, kiametit dhe ekzistencës së botës tjetër.

Të mohosh plotësisht Allahun e Madhëruar është aq absurde sa të mohosh edhe diellin nën të nxehtin përvëlues në kohën e drekës. Po kështu, edhe forma e mohimit e ashtuquajtur deizëm, hiqet sikur nuk e mohon ekzistencën e Allahut si krijues, por nga ana tjetër, refuzon idenë se Ai mund t'i urdhërojë njerëzit, mund t'u shpall diçka, mund t'i dënojë apo t'i shpërblejë. Mirëpo ky qëndrim padyshim që është një botëkuptim imagjinar për një zot si idhull pajetë, pavlerë, e pafuqi, frerët e të cilit i mbajnë dhe i luajnë të tjerët në përputhje me çdo dëshirë të tyre egoiste, e cila do të pranojë çdo gjë të keqe.



Besim i gabuar që quhet deizm, hiqet sikur e pranon Krijuesin. Por me këtë, ata nuk është se pranojnë Allahun, Zotin e vërtetë, por një qenie antropomorfe imagjinare që kanë shpikur vet dhe që në vërtetë nuk ekziston aspak.

Nga një anë kemi një fuqi që ka krijuar një botë të mrekullueshme në të gjithë universin, duke i mbajtur ato vazhdimisht në ekzistencë, e nga një anë kemi një idhull pa pushtet, i cili është detyruar t'ia lërë kontrollin robërve dhe krijesave të veta. Nëse do të ishte kështu, a nuk do të shkatërrohej i gjithë universi?

Ajo që imagjinojnë deistët është vetëm një zot imagjinar dhe pa pushtet. Një idhull që nuk mund të japë asnjë urdhër. Një idhull që nuk mund të zhdukë asnjë padrejtësi. Një idhull që nuk ka të bëjë aspak me ligjet dhe drejtësinë. Një idhull që nuk predikon asnjë parim moral. Një idhull që nuk ka mëshirë ndaj të

dobtëve dhe qëndron indiferent ndaj padrejtësive që u bëhen atyre. Pra, një shpikje e rreme e prodhuar nga një imagjinatë sakate.

Një besimi i tillë nuk ka asnjë lloj logjike. Ky është vetëm një eklips mendor.

Në Greqinë e lashtë politeiste ekzistonte një deizëm i lindur prej pranimit të domosdoshmërisë logjike për një qenie si "motor i parë i palëvizshëm" për gjithësinë. Në këtë mënyrë, ata qetësonin ndërgjegjet e tyre duke besuar në një krijues i cili do t'i përshtatej edhe idhujve të tyre të shpikur, edhe mendjeve të tyre që i adhuronin, edhe domosdoshmërisë që ishin të detyruar të pranonin.



Ajo që imagjinojnë deistët, është një vetëm zot imagjinar dhe pa pushtet. Një idhull që nuk mund të japë asnjë urdhër. Një idhull që nuk mund të zhdukë asnjë padrejtësi. Një idhull që nuk ka të bëjë aspak me ligjet dhe drejtësinë. Një idhull që nuk predikon asnjë parim moral. Një idhull që nuk ka mëshirë ndaj të dobëtëve dhe qëndron indiferent ndaj padrejtësive që u bëhen atyre. Pra, një shpikje e rreme të prodhuar nga një imagjinatë sakate.

Një prirje e tillë është vënë re edhe shekujt e fundit në botën e krishterë, kur krishterimi u mposht plotësisht para logjikës së shëndoshë, shkencës dhe njerëzimit, duke u refuzuar edhe institucionet e tij, si kisha, papati, etj.

Siç dihet;

Krishterimi u shndërrua në një prodhim plotësisht njerëzor. Themelet e tij i vuri Pali, i cili nuk ishte profet. Ndërsa parimet e besimit i vendosën Këshillet nën presionin e mbretit. Madje, edhe ditët e shenjta që përkujtohen sot, si krishtlindjet, janë vetëm zakone të futura më vonë në këtë fe. Një tjetër nga absurditetet e krishterimit është edhe dhënia e titullit "i shenjtë", për njerëz të caktuar që përmbushin kushtet e vendosura prej tyre.

Sigurisht që një fe e tillë nuk mund të kënaqë as mendjen, as ndërgjegjen dhe as zemrën. Për këtë arsye në perëndim u shfaq rryma deiste, e cila nga një anë refuzon kishën dhe absurditetet e predikuara prej saj, e nga ana tjetër pranon ekzistencën e një Zoti.

EKZISTON NJË BOTË TJETËR!..

Për nga aspekti i këtyre rrymave që janë rishfaqur në kohën tonë, kjo kohë i ngjan me të vërtetë periudhës së injorancës, sepse një nga veçoritë kryesore të periudhës së injorancës është mohimi i botës tjetër.

Rezultati i ndjekjes së dëshirave të egos është dhuna, padrejtësia, egoizmi, koprracia, mendjemadhësia dhe shkelja e kufijve njerëzor. Të gjitha këto lindin gjynahe të panumërta kundër Allahut dhe njerëzve.



A ke menduar ndonjëherë për nivelin preciz të Azotit (77%) dhe Oksigjenit (21%) që gjendet në ajër? Ky ekuilibër preciz është kusht i domosdoshëm në atmosferë për jetën e të gjitha gjallesave. Kush e ka përgatitur këtë për ne?

Besimi se një ditë do të jepet llogari për të gjitha këto, e shpie njeriun drejt moralit të bukur, drejtësisë, të vërtetës dhe devotshmërisë.

Mirëpo, robërit e egos së tyre i shqetëson jashtë mase ky mesazh.

Para ca kohësh, në hyrje të varrezave të një lagjeje të Stambollit u vendos një tabelë ku shkruhej ajeti: **“Çdokush do ta shijojë vdekjen!..”** (Ankebut, 57)

Mirëpo, disa gazetarë filluan të ankoheshin duke thënë:

“Ky shkrim na ngjall pesimizëm

sa herë që kalojmë para tij, prandaj hiqeni!..”

Kjo është edhe arsyeja që në ditët tona varrezat bëhen gjithmonë në periferi të qyteteve.

Ndërsa në kohën e Perandorisë Osmane, e cila përfaqësonte një qytetërim të besimit Islam, varrezat bëheshin brenda qyteteve dhe në oborret e xhamive, me qëllim që njerëzit të jetonin gjithmonë me vetëdijen e përkohshmërisë dhe të mos harronin kurrë se një ditë do të dilnin para Allahut të Madhëruar, i Cili është e vetmja ekzistencë e përjetshme.



A ka ndokush që shqetësohet dhe shëtit me bombol oksigjeni pranë vetes nga frika se mos bie niveli i oksigjenit? A nuk është besim ndaj një fuqie hyjnore kjo siguri të cilën e ndjejnë edhe jobesimtarët?

Ja pra, në këtë botë injorante që promovohet nga ateizmi, deizmi dhe shekullarizmi, nuk ka vend për besimin në botën tjetër. Nuk ka mëshirë, ndërgjegje dhe humanizëm, por vetëm mizori, tirani dhe barbari. Këtë e kemi parë më herët në Andaluzi gjatë kryqëzatave, në të shkuarën e afërt në Kaukaz, Ballkan dhe Irak, e në ditët tona në Siri, Jemen, Mjanmar, etj.

Edhe në kohën kur erdhi Islami, kishte shumë prej atyre të cilëve nuk u pëlqente aspak ideja e botës tjetër, sepse ajetet e para që zbritën prej Kuranit i paralajmëronin ata me anë të skenave të tmerrshme të kiametit dhe botës tjetër. Për rrjedhojë, idhujtarët, të vërtetat lidhur me vdekjen dhe ringjalljen, i quajtën “lajm i madh” dhe filluan të diskutojnë mes tyre të shqetësuar, duke thënë “po sikur lajmi i madh, (bota tjetër dhe llogaria), të jetë i vërtetë? Po sikur të ringjallemi?” Këtë skenë, Kurani Fisnik na e tregon me këto fjalë:

عَمَّ يَتَسَآءَلُونَ ﴿١﴾ عَنِ النَّبَإِ الْعَظِيمِ ﴿٢﴾ الَّذِي هُمْ فِيهِ مُخْتَلِفُونَ ﴿٣﴾

"Për çfarë e pyesin ata njëri-tjetrin? Për Lajmin e madh, rreth të cilit ata kanë kundërshtime." (Nebe', 1-3.)

Edhe sot, ata që përhumben në vorbullën e jetës materiale brenda një injorance moderne, përpiqen të largohen sa më shumë prej idesë së botës tjetër.

Mirëpo;

"Atë ditë njeriu do të thotë: "Ku të iki?" Askund! S'ka strehë!" (Kijame, 10-11)

Nuk duhet harruar se;

Prej kohësh, pavarësisht se është lajmëruar edhe nga profetët, njerëzimi e ka vrarë shumë mendjen në lidhje me çështjen e vdekjes. Kjo pyetje, e cila ka zënë vend në mendje si një gjarpër helmues dhe që herë pas here rrotullohet në mënyrë të frikshme, është përpjekur të heshtet me trembje dhe frika të egos.



Besimi se një ditë do të jepet llogari për të gjitha këto, e shpie njeriun drejt moralit të bukur, drejtësisë, të vërtetës dhe devotshmërisë. Mirëpo, robërit e egos së tyre i shqetëson jashtë mase ky mesazh.

Mirëpo, vdekja i mbështjellë të gjithë si një vorbull zjarri dhe kthehet në një frikë dhe shqetësim që u bie të gjithëve në kokë pa përjashtim. Prandaj, të mësohesh me këtë realitet dhe ta zbukurosh vdekjen, duhet të jetë një prej qëllimeve më të rëndësishme të njerëzimit.

Jeta e varrit dhe e botës tjetër, të cilat janë të pamundura të kuptohen nga mendja njerëzore, mund të bëhen të qarta vetëm në saje të shpalljeve

hyjnore dhe shpjegimeve të profetëve. Mirëpo, në vend që të jenë mirënjohës dhe falënderues ndaj të gjithë profetëve, e në veçanti ndaj Profetit ﷺ, për këto lajme në lidhje me të ardhmen, shumë njerëz si ateistët dhe deistët, zgjedhin indiferencën dhe moskokëçarjen ndaj këtyre të vërtetave.

Nëse nuk do të ekzistonte bota tjetër, as ardhja në këtë botë dhe as sprova në të nuk do kishin kuptim.

Një mendje e shëndoshë duhet të mendojë;

• *Cili është qëllimi i ardhjes në këtë botë?*

• *Në pronën e kujt jetojmë?*

• *Kush i krijoi gjithë këto krijesa dhe përse i ka vënë në shërbim të njeriut?*

• *Ku është caku ynë?*

• *Për ku po shkojmë?*

Kur Hindi, e cila ishte një idhujtare në kohën e injorancës, dëgjoi se Islami i konsideronte të barabartë skllevërit dhe pronarët e tyre, u habit dhe e kundërshtoi këtë sistem drejtësie dhe barazie duke thënë: "Ç'është kjo fe? A mos do të jem unë e barabartë me një skllav?"



Para ca kohësh, në hyrje të varrezave të një lagjeje të Stambollit, u vendos një tabelë ku shkruhej ajeti: "Çdo shpirt do ta shijojë vdekjen!.." (Ankebut, 57.) Mirëpo, disa gazetarë filluan të ankoheshin duke thënë: "Ky shkrim na ngjall pesimizëm saherë që kalojmë para tij, prandaj hiqeni atë!.."

NUK KA FE PA LIGJE!

Edhe pse deizmi ka disa forma, të gjitha synojnë një fe pa ligje, pa rregulla, pa parime, pa hallall dhe pa haram!.. Nga

një pikëpamje është sikur të thuhet: "feja të jetë sipas qejfit tim dhe të mos përzihet aspak me dëshirat dhe mendimet e mia!"

Mirëpo, ashtu siç vuri rregull në gjithësi, Allahu i Madhëruar ka dërguar edhe një sistem ligjor për njeriun. Në Kuranin Fisnik urdhërohet:

"Ai e ka ngritur qiellin lart dhe ka vënë Balancën (për çdo gjë)**, që ju të mos e shkelni atë."** (Rrahman, 7-8)

Qëllimi i krijimit është devotshmëria ndaj Allahut. Dhe, për të parë nëse realizohet apo jo ky qëllim, është krijuar kjo botë si një vend sprove. Nxënësit dembelë dëshirojnë që në shkollë të mos ketë detyra dhe provime. Mirëpo, nëse nuk bëhen këto, nuk realizohet dot as qëllimi i shkollës.

Ndërsa;

Nxënësit e mirë janë të vetëdijshëm se në shkollë gjenden për të realizuar qëllimin e arsimimit. Prandaj ata i mirëkuptojnë provimet dhe detyrat dhe përpiqen t'i bëjnë ato me dëshirë dhe vullnet.



Nëse nuk do të ekzistonte bota tjetër, as ardhja në këtë botë dhe as sprova në të nuk do kishin kuptim.

Njerëzit e këqij nuk e duan aspak drejtësinë. Po ashtu, as tiranët nuk e duan mëshirën. Ndërkohë, njerëzit e mëshirshëm janë të kënaqur prej ligjeve dhe drejtësisë. Madje, ata punojnë dhe përpiqen shumë për ndërtimin dhe forcimin e tyre.

Sepse;

Vendet ku tashmë nuk hidhet më fara e mëshirës dhe rënkojnë nën bombardimet e padrejtësive, si Siria, Iraku, Jemeni, Mjanmari dhe Pales-

tina, janë vende që tregojnë realitetin dhe fytyrën e vërtetë të ideologjive shfrytëzuese dhe të pamëshirshme që rrezikojnë të gjithë njerëzimin, siç janë kapitalizmi, ateizmi, deizmi dhe komunizmi.

Njeriu që nuk njeh mëshirë, ka humbur çelësin që hap derën e lumturisë dhe thesarit më të madh. Mëshira është si një zjarr që nuk shuhet kurrë në zemrën e myslimanit. Është veçoria dalluese e myslimanit nga jomyslimani.

Mëshira është një cilësi hyjnore që dëshmon për humanizmin tonë në këtë botë dhe na afron me Allahun me anë të zemrës.



Një mendje e shëndoshë duhet të mendojë; - Cili është qëllimi i ardhjes në këtë botë? - Në pronën e kujt jetojmë? - Kush i krijoi gjithë këto krijesa dhe përse i ka vënë në shërbim të njeriut?

Mësimi i parë që na jep agjërimi, është mëshira. Ai hap syrin e shpirtit tonë të verbuar me pamëshirshmëri.

Vendet ku zhvillohet mësimi fetar, duhet të jenë shkolla mëshire. Nëse brenda atyre mureve, në vend të dashurisë hyn egoizmi, pema e mëshirës do të thahet pa u bërë ende filiz.

Nisur nga kjo;

Kurani Fisnik, duke synuar të na bëjë të kuptojmë se nuk mund të ketë asnjë krijim pa qëllim, na drejton këto pyetje:

“Vallë, a mendon njeriu se do të mbetet pa përgjegjshmëri (pa kontroll)**?”** (Kijame, 36)

“Mos vallë, keni menduar se Ne ju kemi krijuar kot dhe se nuk do të ktheheshit te Ne (për t’ju gjykuar)**?!”** (Mu’minun, 115)

Bota është e mbushur plot me ngjarje e ndjesi negative. Për rrjedhojë, mendoni se çfarë do të ndodhte nëse një vrasës do të lihej i lirë të bënte çfarë të donte! Mendoni se çfarë do të ndodhte nëse do ta linim të lirë një ujk mes deleve!

Në të njëjtën mënyrë, njeriu është duke shkelur shumë të drejta dhe ligje në këtë botë. Prandaj është e pamundur të mendohet se ai nuk do të merret në llogari për të gjitha ligësitë që bën!

Të mendosh që kjo gjithësi dhe njeriu, i cili është "ahsen-i takuim / krijimi më i mirë", janë krijuar për t'u lënë në qejf të vet, nuk ka asnjë logjikë. Ata që pandehin kështu, vetëm se i kanë vënë kyçin mendjes së tyre. Dhe argumenti më i qartë i kësaj të vërtete është fakti se edhe në sistemet më demokratike dhe liberale, burgjet janë të mbushura me kriminelë.



Edhe sot, ata që humbin në vorbullën e jetës materiale brenda një injorance moderne, përpiqen të largohen sa më shumë prej idesë së botës tjetër. Mirëpo; "Atë ditë njeriu do të thotë: "Ku të iki?" Askund! S'ka strehë!" *(Kijame, 10-11.)*

Nëse feja do të formësohej sipas mendjes së gjithkujt, sot do të kishim nga një fe për çdo mendje dhe do të përjetohej një kaos i vërtet mes miliarda feve. Askush nuk do të dëgjonte askënd dhe të gjithë do të përpiqeshin të mposhtnin njëri-tjetrin.

Kjo është edhe arsyeja pse filozofët vazhdimisht përgënjeshtrojnë njëri-tjetrin. Për shembull, filozofët e vjetër grekë, me mendjet e tyre të devijuara, e kthyen veten në idhuj dhe nxorën në pah shumë zota, që gjoja ishin të afërm me njëri-tjetrin. Po të njëjtët filozofë i konsideruan si tufa sho-



Idhujtarët, të vërtetat lidhur me vdekjen dhe ringjalljen, i quajtën "lajm i madh" dhe filluan të diskutojnë mes tyre të shqetësuar, duke thënë, "po sikur lajmi i madh, (bota tjetër dhe llogaria), të jetë i vërtetë? Po sikur të ringjallemi?"

qëritë njerëzore dhe i çuan ato drejt shkatërrimit. Librat e shumë prej tyre mbetën në raftet e pluhurosura të bibliotekave dhe nuk arritën ta ndriçojnë aspak rrugën e njerëzimit.

Përkundër kësaj;

Profetët kanë ardhur duke mbështetur njëri-tjetrin dhe i kanë sjellë paqe dhe udhëzim shoqërive njerëzore.

Sot "kultura globale" ka pushtuar të gjitha vendet Islame. Ashtu siç ekzistojnë pushtimet ushtarake, ekzistojnë edhe pushtimet kulturore. Reklamat që stimulojnë dëshirat e ulëta të egos, moda që shtyn drejt luksit dhe shpërdorimit, programet negative të televizionit, shtigjet e gabuara të internetit dhe propagandat që nxisin çdo gjë negative, kanë sjellë me vete një erozion shpirtëror të jashtëzakonshëm dhe kanë futur në kaos gjithë botën e mendjes dhe të zemrës njerëzore.

Qëllimi dhe mjeti po ngatërrohen, e jeta është kthyer vetëm në qejf dhe ushqim. Zemrat kanë rënë nën robërinë e kësaj bote dhe të dëshirave të ulëta të egos. Ndërsa pakënaqësia e brendshme po e shpie njerëzimin drejt problemeve individuale dhe shoqërore.

Njerëzve po u promovohet një botëkuptim larg shqetësimeve për botën tjetër. Po ashtu, në saje të propagandës së perëndimit materialist, i cili dëshiron ta largojë botën Islame nga vlerat e veta origjinale, njerëzit po largohen përditë e më shumë nga feja dhe besimi, duke u zhytur në probleme

shpirtërore. Dhe, për fat të keq, Islami ende nuk njihet dhe nuk mësohet ashtu siç duhet.

Në këtë pikë dëshiroj t'ju përcjell një histori që ka ndodhur në Stamboll pak a shumë njëzet a tridhjetë vite më parë:

Ish Sekretari i Partisë Komuniste të Francës, Roger Garaudy, kishte ardhur në Stamboll për një konferencë në Pallatin Jëlldëz, e cila u zhvillua me pyetje-përgjigje. Gjatë kësaj konference ai u pyet:

"Ju, një herë e një kohë ishit komunist. Madje, një komunist që mund të përmblidhte nga fillimi deri në fund komunizmin dhe të gjitha mendimet e Marksit. Ndërsa tani jeni bërë mysliman. Përse ishit i krishterë katolik, përse ishit komunist dhe përse tani jeni mysliman?"

Ai tha:

"Unë kam qenë katolik. Shkova në Amerikë për shkollim. Atë kohë monopolet dhe koorporatat nuk e di se sa ton grurë digjnin e sa ton qumësht derdhnin! Dhe këtë e bënin vetëm që të mbanin të gjithë tregun nën monopolin e tyre. Kjo mizori dhe barbari më ngjalli një revoltë përbrenda dhe më shtyu drejt komunizmit.

Me kalimin e kohës, pashë që edhe komunizmi ndërtonte ndërgjegje pa shpirt. Prandaj mendova të ndërtoj një urë me katolicizmin, e kështu t'i jap shpirt komunizmit. Por as kjo qasje nuk më dha rezultat dhe mbeta bosh.

Më vonë, për mua u nxor urdhri:



Edhe kafshët kanë një qëllim krijimi dhe, secila prej tyre jeton e qetë në rrugën drejt atij qëllimi
"Vallë, a mendon njeriu se do të mbetet pa përgjegjshmëri (pa kontroll)?" *(Kijame, 36.)*



"Mos vallë, keni menduar që Ne ju kemi krijuar kot dhe që nuk do të ktheheshit te Ne (për t'ju gjykuar)?!"

(Mu'minun, 115.)

"të qëllohet!". Mirëpo, një ushtar më toleroi dhe unë ia mbatha.

Ngaqë isha sociolog, u bëra kureshtar të dija se përse ky ushtar më la të ikja. Shkova e gjeta dhe e pyeta:

«Përse më le të ikja, ndërkohë që për mua kishte dalë urdhri "të qëllohet"?»

Ai u përgjigj:

«Unë jam mysliman! Nuk e di se çfarë ke bërë ti dhe përse donin të të vrisnin. Por nuk desha të bëhem vegël e tyre. Prandaj të tolerova dhe ti ia mbathe.»

Deri atëherë unë pandehja se Islami ishte fe fisesh. U bëra kureshtar dhe, ngaqë isha edhe ekonomist, së pari fillova nga ekonomia:

Çfarë është kamata? Sepse në komunizëm kamata është e ndaluar, për shkak se është një sistem abuzimi. Kështu mua më shtyu kureshtja të dija se çfarë është kamata në Islam.

Por, ngjarja me Bilalin ma shoi këtë kureshtje. Bilali i solli hurma të Dërguarit të Allahut, ﷺ. Ai i pa ato dhe e pyeti:

«*Bilal! Ku i ke marrë këta hurma?*»

Ai u përgjigj:

«Ne kishim ca hurma jocilësore. Prandaj dhamë dy masa prej tyre dhe morëm një masë nga këto (hurma të mira) që t'i hante i Dërguari i Allahut».

Pas kësaj i Dërguari i Allahut, ﷺ, tha:

«*Mos! Ky këmbim është i njëjtë me kamatën. Kujdes mos veproni kështu!*»

Më pas tregoi një rrugëzgjidhje:

«Nëse dëshiron të marrësh hurma të mira, shiti ato që ke, pastaj me ato para bli hurma të mirë.» (Buhari, Vekale,11.)

Aty kuptova se i Dërguari i Allahut, ﷺ, nuk lëshonte aspak pe në çështjen e kamatës. Për rrjedhojë, kjo ngjarje më bëri të hulumtoj në lidhje me Islamin në tërësi.

Ndërkohë, u përballa me jurisprudencën e mahnitshme të Ebu Hanifes. Çfarë botëkuptimi juridik! Kjo më qetësoi dhe më orientoi...

Por sot, mund të them se për fat të keq bota Islame nuk e njeh mirë juristin me famë botërore, Ebu Hanifen! Unë jap mësim në lidhje me botëkuptimin juridik të Ebu Hanifes edhe pse sapo jam bërë mysliman.

Ju jeni të shëndetshëm, por mendoni se jeni të sëmurë dhe imitoni perëndimin e sëmurë. A mundet që një njeri i shëndetshëm të imitojë një të sëmurë?..”



Roger Garaudy: “Ju jeni të shëndetshëm, por mendoni se jeni të sëmurë dhe imitoni perëndimin e sëmurë. A mundet që një njeri i shëndoshë të imitojë një të sëmurë?..”

Kjo do të thotë se, së pari duhet të jemi të vetëdijshëm për vlerat tona. Duhet t’i çmojmë të shenjtat tona. Në të kundërt, -Allahu na ruajt-, nuk do të jemi ndryshe nga të mjerët që vdesin të uritur edhe pse lundrojnë mbi thesare!..

Vërtet sot bota perëndimore është e sëmurë, sepse është oportuniste dhe pragmatiste. Dhe kjo e bën atë të tolerojë çdo të keqe dhe çdo sjellje të ndaluar përmes teorisë: “Lërini të bëjnë ç’të duan!”

Krishterimi nuk e ngop shpirtin, sepse është i zbrazët nga brenda. Goditjen e parë krishterimi e mori nga



Duhet të jemi të vetëdijshëm për vlerat tona. Duhet t'i çmojmë të shenjtat tona. Në të kundërt, -Allahu na ruajt- nuk do jemi ndryshe nga të mjerët që vdesin të uritur edhe pse lundrojnë mbi thesare!..

Pali. Ai hoqi ligjin hyjnor, duke thënë:

"Besoni në Atin, Birin dhe Shpirtin e shenjtë, pra në trini dhe lëreni të tjerat! Pjesa tjetër e ligjeve të Teuratit nuk vlen më për ju. Tashmë, nxjerrja e ligjeve i përket Çezarit!"

Pra;

"Jetoni të qetë si të dëshironi, sepse ligjet e kësaj bote për ju do të vendosen nga mbretërit!"

Kjo u shkoi për shtat mbretërve. Më pas u mblodhën një pas një Këshillet Ekumenike, të cilët përcaktuan sistemin e ri të besimit të krishterë. Pra, parimet e besimit të tyre u përcaktuan nga vetë njerëzit.

- Në Këshillin e Nikeas, që u mblodh në vitin 325 (e.j), u vendos që Jezusi (Isai -a.s.) është Zot.

- Në Këshillin e Stambollit, që u mblodh në vitin 381, u vendos që edhe Shpirti i Shenjtë është Zot.

- Në Këshillin e Efesit, që u mblodh më 431, Marias (Merjemes) iu dha titulli "lindëse e Zotit". Po ashtu, në këtë mbledhje u pranua se Jezusi kishte edhe natyrë njerëzore, edhe natyrë hyjnore.

- Në Këshillin e Kalcedonisë, që u mblodh më 451, Kishat e Lindjes (Koptët e Egjiptit, Armenët, Surjanitë, Etiopianët) të cilat mbronin tezën se Isai kishte vetëm një natyrë, atë hyjnore, u shpallën të devijuara.

- Në Koncilin e Dytë të Nikeas, më 787, u vendos që adhurimi i ikonave nuk është mëkat. Ndërkohë që deri atëherë, për afro 200 vite, ishte debatuar mjaft mbi çështjen

nëse adhurimi i ikonave ishte mëkat apo jo. Madje, në disa raste perandorët e kishin ndaluar adhurimin e tyre.

Të krishterët Ortodoks pranojnë 7 Këshillet e para. Ndërsa të krishterët katolikë pranojnë gjithsej 21 Këshille, përfshirë edhe atë të fundit më 1965. Në Këshillin e fundit të Vatikanit Katolik është bërë thirrje për "dialog" ndërmjet fraksioneve të ndryshme dhe feve të tjera.

Me pak fjalë, parimet e besimit të Krishterimit të sotëm janë përcaktuar nga Këshillet. Ligjet hyjnore u shfuqizuan dhe feja u boshatis. Gjithashtu, për të siguruar përfitime materiale, kishës iu dha autoriteti i pastrimit të mëkateve. Pra, prej atëherë njeriu filloi të fshijë gjynahet e një njeriu tjetër si vetja e tij.

Përkundër këtyre, Islami është nën mbrojtjen hyjnore në çdo aspekt. Kurani Fisnik gjendet në duart tona i pandryshuar, qoftë edhe një presje, ashtu siç i ka zbritur Profetit ﷺ prej Allahut të Madhëruar. Po ashtu, në saje të punës së përpiktë dhe rigoroze të dijetarëve, sot kemi në dorë edhe traditën autentike profetike (sunnetin), që përfshin fjalët dhe zbatimet e Profetit ﷺ. Gjithashtu, sot kemi në dorë edhe fetvat (vendime juridike) e sahabëve dhe shkollat juridike të themeluara më vonë prej pasuesve të tyre që në shekullin e parë.



"Ata që nuk jetojnë siç besojnë, fillojnë të besojnë ashtu siç jetojnë." Sepse siç na paralajmëron edhe Imam Shafiiu: "Nëse nuk e angazhon veten me të vërtetën, do të pushtojë e kota!"

Pavarësisht këtyre fakteve, janë shfaqur rryma të cilat pretendojnë se:

- Islami ka nevojë për reforma.
- Medhhebet (shkollat juridike) janë të panevojshme.



"Në çdo periudhë do të dalë një grup prej umetit tim, do të vazhdojë të jetë në rrugë të drejtë deri sa të vijë urdhri i Allahut. Këta do të kenë gjithmonë ndihmën e Allahut dhe në fund dalin gjithmonë triumfues." (Muslim, Iman, 247; Imare, 173.)

• Të gjitha hadithet apo shumica e tyre, janë të shpikura.

• Shumë ajete të Kuranit janë të kufizuara në "hapësirë dhe kohë" dhe për rrjedhojë nuk është e nevojshme të zbatohen.

Mirëpo, me këto pretendime synohet që në Islam të bëhen reforma të njëjta me ato që ndodhën në fenë e krishterë. Por në fakt Islami është i garantuar nën mbrojtjen hyjnore deri në ditën e kiametit, si feja e fundit dhe e vërtetë. Këtë të vërtetë, që ne e quajmë "Vija e Ehli Sunnetit dhe Xhematit", i Dërguari i Allahut, ﷺ, na e bën të ditur me këto fjalë:

"Në çdo periudhë do të dalë një grup prej umetit tim, i cili do të vazhdojë të jetë në rrugë të drejtë deri-sa të vijë urdhri i Allahut. Këta do të kenë gjithmonë ndihmën e Allahut dhe në fund do të dalin gjithmonë triumfues." (Muslim, Iman, 247; Imare, 173.)

Feja e vetme e vërtetë, Islami, është e përsosur, dhe e përsosura nuk ka nevojë për atë që është me të meta. Pra, Islami nuk ka nevojë për asnjë sistem njerëzor ose për asnjë fe të manipuluar që t'i shërbejë si protezë.

Ata që mbushin ekranet dhe flasin pa kriter në lidhje me fenë, ata që përpiqen të hedhin hije dyshimi mbi parimet themelore dhe të pandryshueshme Islame dhe ata që duan të shesin mendimet e idhujtarëve si mendimet e veta, duke përfituar prej paditurisë së shoqërisë në çështjet fetare, mund të mashtrojnë vetëm mendjet e cekëta dhe naive.

Nëse nuk do të pasosh asnjë medhheb, nëse nuk i beson haditheve dhe nëse nuk i pranon ligjet e Kuranit, atëherë çfarë të ka mbetur më?

Padyshim se këto janë taktika mohimi, si deizmi, të cilat janë kurthe për të dëmtuar themelet Islame. Nisur nga kjo, nuk është rastësore që kur bëhet fjalë për teolog reformist dhe modernist, personi i parë që na vjen në mendje në vendin tonë është edhe autori i një libri që promovon deizmin. Po ashtu, në një broshurë të Shoqatës së Deistëve që u themelua më 2018, falënderohet ky person dhe një tjetër teolog që mohon sunnetin.

Detyra jonë është të bëjmë të qartë se deizmi nuk mund të jetë absolutisht asnjëherë një "besim" dhe se ky botëkuptim, që është tërësisht prodhim i huaj dhe mentalitet i periudhës së injorancës, nuk ka asnjë dallim nga llojet e tjera të mohimit, siç është idhujtaria, ateizmi, etj.



Nëse besimin ia përngjajmë dritës së kandilit, atëherë na duhet një mburojë xhami për ta ruajtur atë nga shuarja përballë erërave të forta të mohimit.

Po ashtu, një tjetër detyrë e jona është t'i tregojmë njerëzve rëndësinë e besimit të vërtetë. Nëse besimin ia përngjajmë dritës së kandilit, atëherë na duhet një mburojë xhami për ta ruajtur atë nga shuarja përballë erërave të forta të mohimit.

Kjo mburojë është;

- Vënia në jetë e besimit,
- Qëndrimi larg prej harameve,
- Veprat e mira, rruga e drejtë, devotshmëria,
- Shoqërimi me njerëzit e mirë dhe të devotshëm.

Sepse;



Mburojë që do të ruajë besimin, është; Vënia në jetë e besimit, qëndrimi larg prej harameve, veprat e mira, rruga e drejtë, devotshmëria dhe shoqërimi me njerëzit e mirë e të devotshëm.

"Ata që nuk jetojnë siç besojnë, fillojnë të besojnë ashtu siç jetojnë."

Sepse siç na paralajmëron edhe Imam Shafiu:

"Nëse nuk angazhohesh me të vërtetën, do të të pushtojë e kota!"

Një pjesë e rëndësishme e bisedave që bëhen mes të rinjve, si: "unë jam deist, unë jam modernist, etj...", burojnë prej një imitimi të verbër e të thatë. Por, për fat të keq, ambientet e të rinjve universitarë janë shumë të përshtatshme për lulëzimin e këtyre lloj mikrobeve. Prandaj, për ta zgjidhur këtë problem, duhet menduar përsëri në lidhje me "arsimimin e vërtetë".

Prindërit i çojnë me duart e veta bijtë e tyre në këto ambiente të mbushura me këto lloj mikrobesh, me idenë për t'i arsimuar. Mirëpo, në ambientet e arsimit të lartë, ka disa lloj rreziqesh:

Jeta në indiferencë dhe devijim, që zhvillon robër të dëshirave të ulëta të egos, përzierja meshkuj-femra, devijimi në mendim e vepra dhe kaosi në identitet dhe karakter...

Për rrjedhojë, është kusht që zemra të ruhet prej këtyre rreziqeve.

Imam Gazaliu thotë:

"Shoqërimi me gjynahqarët dhe indiferentët, me kalimin e kohës shndërrohet në unitet të mendjeve dhe të zemrave, gjë e cila e shpie njeriun drejt shkatërrimit. Kjo ishte edhe arsyeja që gruaja e dytë e Nuhut عليه السلام dhe gruaja e Lutit عليه السلام, merituan dënimin e Xhehenemit."

Ndërsa Profeti ﷺ, kur po kalonte afër rrënojave të popullit të Themudit, i cili ishte dënuar shekuj më parë, u tha shokëve të vet:

"Ecni shpejt dhe të hidhëruar! Mos merrni ujë, e atë që keni marrë derdheni!" (shih. Buhari, Enbija, 17.)

Le të mendojmë pak gjendjen e popullit tonë, i cili sot sheh mëngjes e mbrëmje nga ekranet e televizioneve dhe telefonave transmetimet dhe propagandat e panumërta të mohuesve të fesë!

Nëse i braktisim përpjekjet tona për edukim dhe arsimim, nëse nuk e realizojmë siç duhet misionin tonë të urdhërimit në punë të mira dhe ndalimit nga të këqijat, atëherë, fëmijët tanë do të përvetësohen nga të tjerët. Në Kuran thuhet se shejtani bëhet ortak në fëmijët tanë. Pra, nuk ka rëndësi nëse jemi apo jo prindërit biologjikë!.. Nëse atë e ushqejnë shejtani dhe mohuesit e Allahut, atëherë ai bëhet fëmija i tyre.



"O Ibni Omer! Kapu fort pas fesë tënde, kapu fort pas fesë tënde, sepse ajo është edhe mishi, edhe gjaku yt! Bëj kujdes nga kush e mëson fenë!.." *(Hatib el-Bagdadi, el-Kifaje fi Ilmi'r-Rivaje, fq. 121.)*

- Sa i përket edukimit fetar të bijve tanë, ne duhet t'u mundësojmë atyre një arsimim të vërtetë fetar dhe t'i mbajmë larg mendimeve të devijuara e të importuara prej modernistëve dhe orientalistëve.

Njëherë, i Dërguari i Allahut, ﷺ, i ka thënë kështu Abdullah ibn Omerit رضي الله عنهما:

"O Ibn Omer! Kapu fort pas fesë tënde, kapu fort pas fesë tënde, sepse ajo është edhe mishi, edhe gjaku yt! Bëj kujdes nga kush e mëson fenë! Dijet dhe vendimet fetare merri prej dijetarëve që

janë në rrugë të drejtë, e jo prej atyre që anojnë majtas e djathtas!" (Hatib el-Bagdadi, el-Kifaje fi Ilmi'r-Rivaje, el-Medinetu'l-Munevvere, el-Mektebetu'l-İlmijje, fq. 121.)



Profeti ﷺ, kur po kalonte afër rrënojave të popullit të Themudit, i cili ishte dënuar shekuj më parë, u tha shokëve të vet: "Ecni shpejt dhe të hidhëruar! Mos merrni ujë, e atë që keni marrë derdheni!" (shih. Buhari, Enbija, 17.)

TRE PROBLEME

Në kohën tonë, përballë arsimit Islam qëndrojnë tre probleme:

• **I pari:** Sot po bëhen përpjekje për ta zhvlerësuar ixhtihadin[1] dhe medhhebin[2], duke i nxitur njerëzit të marrin vendime (të bëjnë ixhtihad) sipas mendjes së tyre. Si rrjedhojë e këtyre nxitjeve, të gjithë, madje edhe të paditurit, përpiqen të caktojnë rrugën e tyre, duke thënë: "për mendimin tim!". Mirëpo, kjo sjell dobësimin e fesë dhe, -Allahu na ruajt- shkatërrimin e saj.

Ja pra, edhe përpjekjet e dikujt për t'i bërë vend deizmit burojnë nga fakti se ata e gjejnë veten në këtë truall.

Mirëpo, medhhebet janë shkolla juridike Islame të cilat kanë mbledhur në një vend mendimet autentike të dijetarëve Islamë që prej brezit të sahabëve. Për rrjedhojë, zgjedhja e njërës prej këtyre shkollave juridike është shumë e nevojshme. Ndërsa braktisja e tyre në mënyrë të plotë, nuk është e lejuar, sepse të gjitha medhhebet janë ndërtuar mbi Kuranin dhe Sunetin.

• **I dyti:** Po bëhen përpjekje të mëdha për të hedhur sa

1. Ixhtihad: Përpjekja e një juristi Islam për të gjetur zgjidhje dhe për të marrë vendim në lidhje me çështje të caktuara, duke përdorur metodologjinë e jurisprudencës Islame (fikhut).

2. Medhheb: Shkollë e jurisprudencës Islame.

më shumë dyshime mbi autenticitetin e sunetit profetik. Dhe, për t'ia arritur këtij qëllim bëjnë sikur nxjerrin në plan të parë Kuranin.

Mirëpo, Kurani Fisnik u zbrit në zemrën e bekuar të Profetit ﷺ. Për rrjedhojë, edhe kumtimi, edhe zbatimi i Kuranit në mënyrën më të mirë, i takon Profetit ﷺ. Prandaj interpretimi më autentik i Kuranit është vetë tradita, suneti profetik. Sunneti është zbatimi i Kuranit dhe jo diçka që del jashtë tij. Pra, Suneti nuk mund të shkëputet prej Kuranit.

Libri hyjnor dhe Suneti profetik janë dy damarët dhe dy argumentet kryesore të Islamit.

• **I treti:** Kurani përmban ligje që janë urdhrat e Zotit tonë për ne, por që disa njerëzve u vijnë shumë rëndë. Për këtë arsye ata përpiqen t'i nxjerrin ato jashtë funksionit. Me këtë synim ata mundohen të zhvlerësojnë ligjet e Kuranit duke u veshur disave prej tyre cilësi historike, gjë e cila nënkupton se "ato ajete kanë të bëjnë vetëm me kohën kur janë zbritur". Mirëpo, kjo i ngjan plotësisht kundërshtimit që shejtani i bëri Allahut të Madhëruar.



O Ibni Omer! Dijet dhe vendimet fetare merri prej dijetarëve që janë në rrugë të drejtë, e jo prej atyre që anojnë sa majtas, djathtas.

(Hatib el-Bagdadi, el-Kifaje fi Ilmi'r-Rivaje, fq. 121.)

Siç e dimë, kur Allahu i Madhëruar krijoi Ademin عليه السلام, i urdhëroi melekët:

"Bëni sexhde Ademit!"

Në fakt, ajo nuk ishte sexhde adhurimi, por sexhde respekti. Mirëpo, Iblisin, nga mendjemadhësia që kishte, e kaploi smira ndaj Ademit dhe nuk i bëri sexhde, duke kundërshtuar urdhrin e Allahut të Madhëruar. Kur

u pyet se përse nuk bëri sexhde, ai nuk kërkoi falje për veprimin e tij, por filloi të bënte krahasime dhe arsyetime të pakuptimta, duke thënë:

"Unë jam më i mirë se ai. Mua më krijove nga zjarri, kurse atë e krijove nga balta."

Mirëpo, Allahu i Madhëruar nuk e pyeti atë: "Kush është më i lartë, ti apo Ademi?", por e urdhëroi vetëm t'i bënte sexhde Ademit.

Kështu, i pari që debatoi me Allahun e Madhëruar, ishte Iblisi. Për rrjedhojë, ai u dëbua nga mëshira hyjnore dhe meritoi mallkimin e përjetshëm. (shih. A'raf, 12-13; Sad, 71-78, etj.)



Tre fitne në teologji: - Refuzimi i medhhebeve, - Mohimi i Sunnetit, - Zhvlerësimi i ligjeve Islame. Këto fitne, të cilat dolën në pah në sajë të teknikave të orientalistëve në prapaskenë, shtojnë qasjen me dyshim ndaj dijeve fetare dhe për fat të keq, imponojnë me qëllim animin drejt deizmit.

Ja pra, e njëjtë është edhe gjendja e shëmtuar e historicizmit!..

Allahu i Madhëruar ia fali njerëzimit Kuranin si udhëzues deri në ditën e kiametit, sepse Ai nuk do të dërgojë më profetë dhe nuk do të shpallë më asnjë libër tjetër në këtë botë.

Mirëpo pretendimi se brenda atij libri, -Allahu na faltë-, ka ligje që mund t'u kalojë afati i përdorimit, është një shpifje e shëmtuar ndaj Allahut të Madhëruar dhe një mendësi e vogël në të cilën strehohen mendjet e cekëta.

Sot, për fat të keq, në shumë fusha të teologjisë, në emër të dijes dhe informacionit, studentëve po u përcillen pretendimet e kalbura dhe të pabaza të orientalistëve armiq të Islamit, si Caetani, Goldziher, etj. E gjithë kjo e turbullon jetën shpirtërore të studentëve. Prandaj, nuk duhet harruar se ata që japin të tilla mësime, marrin gjynahe të mëdha.

Këto tre probleme të mëdha për të cilat folëm, pra;

- Refuzimi i medhhebeve,
- Mohimi i Sunnetit,
- Zhvlerësimi i ligjeve Islame...

shtojnë qasjen me dyshim ndaj dijeve fetare dhe për fat të keq imponojnë qëllimisht animin drejt deizmit.

Rrugëzgjidhja është të mësojmë të vërtetën.

Brezat që mësojnë të vërtetën, nuk do të pinë helmet e zbukuruara që u ofrojnë orientalistët, të huajt dhe jomyslimanët.

Rumiu thotë:

"Para se të lexosh ajetet e Kuranit Fisnik dhe hadithet e Profetit ﷺ, drejto veten! Nëse nuk e ndjen aromën e këndshme në kopshtin e trëndafilave, të metën mos e kërko tek kopshti, por në zemrën dhe në nuhatjen tënde!"



Rumiu thotë: "Para se të lexosh ajetet e Kuranit Fisnik dhe hadithet e Profetit ﷺ, drejto veten! Nëse nuk e ndien aromën e këndshme në kopshtin e trëndafilave, të metën mos e kërko tek kopshti, por në zemrën dhe hundën tënde!"

Sot, për të mësuar ashtu siç duhet dijet Islame, duhen bërë përpjekje shumë serioze. Për këtë nuk mjaftojnë as medreseja dhe as kursi fetar në verë. Profeti ﷺ ua mësoi sahabëve fenë për njëzet e tre vite. Kjo do të thotë se mësimi duhet të vazhdojë gjatë gjithë jetës, duke u zbatuar dhe jetuar përditë. Gjithashtu mësimet duhen marrë prej mësuesve të devotshëm dhe në rrugë të drejtë.

Mirëpo ata që dijet fetare i kanë mësuar duke shkuar vetëm në xhami

gjatë verës në kohën e fëmijërisë dhe duke bërë vetëm një orë në javë kulturë fetare në shkollë, hutohen përballë debateve që zhvillohen në programet e televizioneve lidhur me fenë. E, nëse ndjenjat dhe dëshirat e egos së tyre mbështesin dyshimet që hidhen në këto programe, ata i braktisin edhe ato dije të pakta që kanë.

Në kohën tonë, botëkuptimi i injorancës që vjen prej perëndimit është përhapur kudo...

Mirëpo ne nuk e humbim shpresën! Zgjidhja jonë është ta kumtojmë fenë ashtu siç bëri Profeti ﷺ. Të gjithë ata që kanë mundësi, duhet të përpiqen! Madje nuk lejohet që ata të cilët kanë dije dhe aftësi për të mësuar Islamin, të heshtin pa bërë asgjë.



Ne nuk e humbim shpresën. Zgjidhja jonë, është ta kumtojmë fenë ashtu siç bëri Profeti ﷺ. Të gjithë ata që kanë mundësi, duhet të përpiqen! Madje, nuk lejohet që ata të cilët kanë dije dhe aftësi për të mësuar Islamin, të rrinë pa bërë gjë.

Nëse pavarësisht gjithë kësaj injorance, kuotat e nxënësve në kurset e Kuranit nuk plotësohen, atëherë do të thotë se ne nuk po punojmë!

Ne duhet që;

• T'u rikujtojmë vazhdimisht njerëzve se jeta e vërtetë, është ajo e botës tjetër,

• T'u tregojmë se për çdo punë që bëjmë do të japim llogari,

• T'u kujtojmë se qëllimi i krijimit tonë është njohja e Zotit tonë dhe adhurimi i Tij,

• Të ndihmojmë dhe të shërbejmë duke e jetuar dhe gjallëruar fenë e Allahut!




Do të ndihmojmë dhe do të shërbejmë duke e jetuar dhe gjallëruar fenë e Allahut. Zoti ynë na ka premtuar se do të na ndihmojë në frymën e fundit.

Zoti ynë na ka premtuar se do të na ndihmojë në frymën e fundit.

Allahu i Madhëruar na e bëftë të mundur!

Amin!..



A ËSHTË E MUNDUR TË MOS BESOSH?!.

Shejh Sadi ka thënë:

"Për njerëzit e mençur,
çdo gjethe peme është një poezi
e mrekullueshme që dëfton Allahun.
Ndërkohë që për të shkujdesurit,
të gjitha pemët nuk vlejnë as sa një gjethe."



A ËSHTË E MUNDUR TË MOS BESOSH?!.

Bota është një shkollë ku mësohet njohja e Allahut. Mësuesi i kësaj shkolle është Profeti ﷺ. Çdo gjë që ndodhet në këtë gjithësi ka rolin e laboratorit të kësaj shkolle. Për sytë që shohin, çdo gjë tregon, shpreh dhe shpjegon Atë.

Urdhri i parë i Allahut të Madhëruar në Kuranin Fisnik është:

"Lexo me emrin e Zotit tënd!" (Alak, 1)

Allahu i Madhëruar, në tokë e në qiej, tek njeriu dhe çdo gjë në gjithësi, ka vendosur shenja dhe arsye meditimi në lidhje me ekzistencën e Vet, njëshmërinë dhe fuqinë e Tij.

Zemrat që shohin, dëgjojnë dhe ndjejnë, në këtë gjithësi

nuk shohin asgjë tjetër përveç manifestimeve të fuqisë dhe madhështisë hyjnore.

E megjithatë;

Sa keq për ata që nuk mund të flasin me trëndafilat, zambakët, e bilbilat dhe nuk mund të kuptojnë gjuhën e gjendjes së tyre që në këtë botë!

Sa keq për ata që janë plotësisht indiferentë ndaj manifestimeve të cilësive "el-Bari" dhe "el-Musauuir" të Allahut të Madhëruar dhe për ato zemra të mefshta që nuk ndjejnë asgjë prej gjuhës së heshtur të erërave, përrenjve dhe maleve!..

Shkaqet që deizmi dhe prirjet mohuese gjejnë vend në këtë botë dhe tek të rinjtë, duhen kërkuar tek propagandat negative.



"Ai ka vënë në shërbimin tuaj çka gjendet në qiej dhe në Tokë, të gjitha janë prej Tij. Me të vërtetë, në këto ka shenja për njerëzit që mendojnë."

(Xhathije, 13.)

Dijetarët e medhhebit akaidor Maturidi, thonë:

"Njeriu, të cilit nuk i ka arritur asnjë libër hyjnor dhe asnjë profet, duhet të jetë në gjendje ta gjejë vetë ekzistencën e një Krijuesi dhe njëshmërinë e Tij."

Pra, gjithësia është një shkollë meditimi... Një laborator besimi. Dhe, për të mos besuar duhet të jesh i pamend, i trashë, i verbër dhe t'i kesh vënë vulën mendjes.

Dikush që sheh gjelbërimin e pranverës në mes të ditës, i gjendur përballë lloj-lloj ngjyrash, mund të thotë se "unë nuk shoh gjë tjetër përveç gjelbërimit!". Pra, ai nuk

e vë re dritën, e cila në të vërtetë i jep atij mundësinë për të parë atë gjelbërimin. Në këtë rast, drita është fshehur në intensitetin e qartësisë së saj.

Një i urtë ka thënë:

"Në të vërtetë, Allahu nuk është i fshehtë, por është i padukshëm për kapacitetin dhe aftësinë tonë dalluese për shkak të intensitetit të shfaqjes së Tij."

Për shkak të sprovës, është e domosdoshme që Allahu të jetë "i fshehtë/i padukshëm". Nëse Ai do të shfaqej qartësisht në këtë botë, atëherë "besimi" nuk do të kishte më cilësinë e "sprovës" dhe do të shndërrohej në një "dije të sigurt".



Gjithësia është një shkollë meditimi... Një laborator besimi. Dhe, për të mos besuar në këtë botë, duhet të jesh i pamend, i trashë, i verbër dhe t'i kesh vënë vulën mendjes.

Mirëpo, për shkak se çdo gjë dëshmon për krijimin e Tij, për madhështinë dhe fuqinë e Tij, në të njëjtën kohë, Allahu është edhe i dukshëm. Allahu është i dukshëm në saje të cilësive të Tij dhe çdo krijesë është nga një argument i qartë i kësaj.

Profeti ﷺ ka thënë:

"Mendoni mbi krijesat e Allahut (pra, meditoni ekzistencën dhe madhështinë e Allahut duke parë manifestimet e cilësive të Tij) dhe jo mbi Individualitetin e Tij, sepse ju kurrë nuk mund ta përcaktoni (denjësisht) vlerën e Tij!" (Dejlemi, Musned, II, 56; Hejthemi, Mexhmau'z-Zevaid, I, 81)

Po ashtu;

Ne jetojmë në saje të ajrit, të cilin edhe pse na rrethon plotësisht, ne nuk e shohim, por e ndjejmë vetëm duke e

thithur atë. Për këtë arsye, ne jo vetëm që nuk e mohojmë dot, por duke e parë si një domosdoshmëri jetike, ne themi se "s'mund të jetojmë pa të!"

Edhe gjallesat e ujit janë si ne. Edhe ato nuk e vërejnë ujin brenda të cilit jetojnë. Mirëpo, ai ujë i ka rrethuar nga çdo anë.

Nëse e shohim nga një pikëpamje tjetër;

Zoti ynë është i lartë, përtej botëkuptimit tonë. Ai është shumë madhështor dhe larg imagjinatës njerëzore.

Nga ana tjetër, ai është afër. Është më afër nesh se damari i qafës sonë. Nëse arrijmë ta ndjejmë, ne marrim mesazhet e Tij në çdo çast dhe për çdo ngjarje, furnizohemi me mirësitë e Tij, i lutemi Atij dhe ndjejmë pranimin e lutjeve tona.



"A nuk shihni se si Allahu jua ka bërë të mundur t'i shfrytëzoni të gjitha ato që gjenden në qiej dhe në Tokë dhe ju ka mbuluar me dhuntitë e Tij të dukshme e të padukshme?.."

(Lukman, 20.)

Mendja e shëndoshë e kupton se:

Për të urtët, çdo krijesë është argument i ekzistencës së Tij. Ndërsa për indiferentët çdo gjë është një shkak për shkujdesjen e tyre.

Rumiu thotë:

"Nëse i vendos gishtat para syve, nuk do të shohësh asgjë."

Kjo pra është edhe indiferenca, Allahu na ruajt!

Ateizëm do të thotë të jetosh i shurdhër dhe i verbër përballë manifestimeve të pafundme të madhështisë dhe fuqisë së Allahut të Madhëruar në gjithësi.

Ateizmi mbështetet në mohimin e

asaj që nuk sheh, gjë që nuk ndryshon aspak nga mohimi i shpirtit dhe i mendjes, sepse askush nuk e sheh dot, as shpirtin e as mendjen. Mirëpo, e di se e gjithë jeta varet nga ekzistenca e mendjes dhe e shpirtit. Madje, për këtë arsye edhe shumë mendimtarë racionalistë perëndimorë nuk e kanë mohuar Krijuesin.



"...E megjithatë, disa njerëz polemizojnë për Allahun pa kurrfarë dijenie, pa kurrfarë rrëfyesi dhe pa libër ndriçues."

(Lukman, 20.)

QENIE E PËRSOSUR

Matematikani dhe filozofi i shquar Descartes (1594-1650), i cili konsiderohet edhe si babai i filozofisë dhe racionalizmit modern, në saje të arsyetimeve që bëri duke u nisur prej "argumentit ontologjik", arriti në këto përfundime:

"Çdo gjë tek njeriu dhe në gjithësi është e përsosur. S'ka asgjë të pakuptimtë. Asgjë nuk mund të bëhet e përsosur vetvetiu. Atë e ka përsosur një qenie më e përsosur. Zoti është qenia më e përsosur, me një përsosmëri të pakufishme. Mos ekzistenca e «Qenies më të përsosur» në mendjen e njeriut, është e pamendueshme. Dhe kjo vërteton ekzistencën e Zotit edhe sikur të mos ketë asnjë argument tjetër."

"Zoti është një qenie e përsosur, e patëmeta dhe e pagabueshme. Prandaj edhe dituria e Tij është e vërtetë dhe e patëmeta. Për rrjedhojë, çdo dije e Tij është e saktë dhe e patëmeta. Dija e Zotit është burimi i dijes së saktë."

Ndërsa Pascal, në mbështetje të këtij mendimi, thotë:

"Është një zë që vjen prej thellësive të ekzistencës sonë dhe

na bën të ditur që jemi të pavdekshëm: ky është zëri udhëzues i Zotit që shfaqet tek ne!"

Këto janë pohime prej jomyslimanëve...

Me të vërtetë;

Nëse njeriu e sheh këtë rregull dhe këtë ekuilibër kaq të mrekullueshëm në gjithësi, dhe pandeh se është krijuar pa asnjë qëllim, e për rrjedhojë përpiqet të jetojë në mënyrë të papërgjegjshme si krijesat e tjera, atëherë kjo nuk është asgjë tjetër veçse një humbje e hidhur. Allahu i Madhëruar urdhëron:

"Mos vallë, keni menduar që Ne ju kemi krijuar kot?!."

(Mu'minun, 115)

Çdo gjë në këtë botë është krijuar për njeriun, e njeriu është krijuar për të adhuruar Allahun. Përndryshe ky krijim nuk do të kishte asnjë kuptim.



Çdo mohim dhe kundërshtim i Allahut; Është një budallallëk i të qenit rob i një jete bazuar në dëshirat e ulëta të egos, duke mbetur indiferent ndaj pyetjeve të tilla si, "përse ekzistoj?", "përse u krijua ky univers?", "cili është shkaku i krijimit?", etj.

Njeriu duhet të jetojë brenda këtij synimi me qëllim që të kthehet në Xhenet... Njeriu është krijuar si një qenie e nderuar. Ai duhet ta pastrojë veten, me qëllim që të meritojë Xhenetin e mrekullueshëm.

Për këtë arsye, Allahu i Madhëruar e ka ndihmuar njeriun duke i dërguar profetë, duke i zbritur shpallje dhe duke i hapur mendjen për të medituar rreth manifestimeve të panumërta të fuqisë dhe madhështisë hyjnore.

Në Kuranin Fisnik, Allahu i Madhëruar u drejtohet mohuesve me një pyetje gozhduese:



"A mos vallë, ata janë krijuar nga hiçi apo mos janë ata krijues të vetvetes?!"
(Tur, 35.)

اَمْ خُلِقُوا مِنْ غَيْرِ شَىْءٍ اَمْ هُمُ الْخَالِقُونَ

"A mos vallë, ata janë krijuar nga hiçi apo mos janë ata krijues të vetvetes?!" (Tur, 35)

Janë dy cilësi, të cilat Allahu i Madhëruar nuk ia ka dhënë njeriut në këtë botë:

- **Halk** / Të krijojë nga asgjëja.
- **Beka** / Të jetë i përhershëm.

➢ Njeriu nuk mund të krijojë asgjë nga hiçi. Megjithëse njeriu ka ndërtuar dhe prodhuar shumë gjëra, në të vërtetë ato përbëhen nga bashkimi i elementëve të krijuar më parë nga Allahu i Madhëruar. Asnjë makineri e prodhuar nga dora e njeriut, nuk mund të lindë vetë një makineri tjetër si vetja. Asnjë aeroplan nuk mund të sjellë në jetë një aeroplan tjetër.

Njeriu jeton plotësisht brenda një bote të krijuar nga Allahu i Madhëruar. Pra, edhe vetë ai, edhe çdo gjë tjetër që e rrethon, është krijesë e Allahut.

- Njeriu nuk mund të jetë i përhershëm. Të gjitha qeniet e tjera, përveç Allahut, janë të vulosura me vulën e përkohshmërisë.

Në Kuranin Fisnik urdhërohet:

"Çdokush do ta shijojë vdekjen!.." (Al-i Imran, 185)

"Çdo gjë që është në Tokë, do të zhduket!" (Rrahman, 26)

"...Çdo gjë do të shkatërrohet, përveç Fytyrës (Qenies) **së Tij! Atij i përket vendimi dhe tek Ai do të ktheheni të gjithë!"** (Kasas, 88)

Për këtë arsye, në gurët e varreve shkruhet në formë përkujtuese:

"Huve'l-Baki / Vetëm Ai është i përhershëm!"

Po ashtu, edhe ekuilibri dhe rregulli i përsosur në gjithësi, janë argumente të ekzistencës dhe njëshmërisë së Allahut. Ismail Fenni Ertugrul thotë:

"Në këtë univers, që prej grimcës e deri tek trupi më i madh, shohim veprat hyjnore të Allahut të Madhëruar. Madje, që në shikim të parë, pa bërë shumë kërkime, shihet një dorë e fuqishme, e cila është "shkaku fillestar" i të gjitha pjesëve të universit. Mendjet dhe trupat tanë, kafshët, planetët, yjet, toka dhe qielli, janë të gjitha brenda një rregulli dhe ekuilibri të përshtatshëm. Ky art dhe urtësi tregon për një mendje dhe inteligjencë shumë më superiore se e jona, ashtu si shpirti i gjithë universit, i padukshëm dhe i pandjeshëm, por që me një fuqi të madhe, i shpie të gjitha qeniet drejt qëllimeve të tyre. Pra, në krijimin e këtij universi dhe në çdo grimcë, shohim një përputhshmëri absolute.

Prej diellit deri tek milingona, në çdo gjë shohim artin dhe fuqinë e pakufishme të Allahut të Madhëruar!"[1]

"Ne nuk mund të rrimë pa u mahnitur dhe pa thënë: "sa e mrekullueshme!", për çdo vepër të artit hyjnor që shohim në këtë botë! Atëherë, përse kur shohim fuqinë dhe urtësinë e artistit të këtyre veprave, të mos themi: «Qenia më e përsosur dhe më superiore»!?



Descartes: "Çdo gjë tek njeriu dhe në gjithësi është e përsosur. S'ka asgjë të pakuptimtë. Asgjë nuk mund të bëhet e përsosur vetvetiu. Atë e ka përsosur një qenie më e përsosur."

1. Iman Hakikatleri Etrafında Suallere Cevaplar, s. 8.

Për mendimin tim, ata që nuk arrijnë ta perceptojnë madhështinë e Allahut, janë vetëm njerëzit mendjeshkurtër të kapluar nga sëmundja e dyshimit dhe të mahnitur nga idetë e gabuara e të pështjelluara të filozofisë!"[2]

Ndërsa atyre që pretendojnë se ekzistenca është shfaqur rastësisht, Ismail Fenni u drejtohet me këto pyetje logjike:

"Për të krijuar krahun e një mize duhet të formohen miliona mekanizma. Duke qenë se format e përputhshme me njëra-tjetrën në univers janë të pallogaritshme, a nuk është kusht që edhe format e papërputhshme që dalin në pah derisa këto të marrin formë, të jenë aq të shumta sa të mos krahasohen me këto? Atëherë, përse nuk i shohim këto?



Descartes: "Zoti është qenia më e përsosur, me një përsosmëri të pakufishme. Mos ekzistenca e "Qenies më të përsosur" në mendjen e njeriut, është e pamendueshme. Dhe kjo, vërteton ekzistencën e Zotit edhe sikur të mos ketë asnjë argument tjetër."

Nëse këto janë zhdukur ndërkohë që ekzistonin, atëherë përse nuk ka gjurmë të tyre? Përse natyra nuk krijon kafshë me forma të çrregullta, por nxjerr gjithmonë qenie tek të cilat shihet një harmoni e plotë?"[3]

"...Nëse diku shohim një punë të llogaritur dhe të rregullt, atëherë mendja jonë gjykon prerazi se aty gjendet edhe një llogaritar dhe organizues...

Ta zëmë se ju keni një vresht përreth të cilit keni mbjellë fidanë radhë-radhë. Një ditë, kur shkuat atje, vutë re se disa nga këta fidanë janë rrëzuar aty-këtu pa radhë. Kur pyetët

2. Maddiyyun Mezhebi'nin İzmihlali, s. 28.
3. Maddiyyun Mezhebi'nin İzmihlali, s. 54.

për shkakun, kopshtari ju thotë se ato i ka shkulur një furtunë e fortë dhe ju e pranoni këtë përgjigje.

Mirëpo, një ditë tjetër shkoni dhe shihni se fidanët që janë të rreshtuar njëri pas tjetrit, janë rrëzuar, fjala vjen, në çdo të pestin prej tyre, ndërsa katër të tjerët përpara tij jo, gjë e cila është e përsëritur për çdo të pestin fidan. Kur pyesni për shkakun, kopshtari ju jep të njëjtën përgjigje. Atëherë, a do ta besonit ju këtë? Padyshim se nuk do ta besoni, dhe këtë do t'ia atribuonit një njeriu dashakeqës. Nëse hera e parë mund të shpjegohej me rastësi, hera e dytë nuk pranohet aspak, sepse kësaj here ka hyrë në lojë njëfarë llogaritjeje."[4]

Ata që sot përpiqen ta shpjegojnë me rastësi gjithçka në gjithësi;

• Si mund të jenë të sigurt se nesër niveli i oksigjenit nuk do të pësojë ndryshime dhe si mund të flenë të qetë pa asnjë lloj shqetësimi?



Pascal: "Është një zë që vjen prej thellësive të ekzistencës sonë dhe na bën të ditur që jemi të pavdekshëm: ky është zëri udhëzues i Zotit, që shfaqet tek ne."

• Përse nuk kanë frikë se nesër mund të prishen ekuilibrat delikatë që formojnë stinët dhe moti mund të bëhet aq i nxehtë sa mund ta përcëllojë njeriun, ose aq i ftohtë sa mund ta ngrijë atë në vend?

• Si mund të jenë të sigurt se sistemet në trupat e tyre, në zemrat, veshkat, mëlçitë dhe të gjitha organet e tjera, të cilat ata as që mund t'i kontrollojnë dot, do të punojnë edhe nesër në mënyrë të mrekullueshme?

Mos vallë ky varg rastësish punon gjithmonë në favor të tyre?

4. İman Hakikatleri Etrafında Suallere Cevaplar, s. 21-22.

A besojnë ata me të vërtetë se këtë gjithësi dhe këtë rregull të përsosur nuk e menaxhon askush?

Në fakt, nëse ata besojnë me të vërtetë kështu, duhet të jenë të çmendur!

Çfarë do të bënte njeriu nëse do të merrte vesh se pilotët e aeroplanit në të cilin gjendet, kanë vdekur apo u ka rënë të fikët? Mbase do të pësonte krizë nervore nga frika!? A mund të rehatohej ai me mendimin se aeroplani do të ulej mrekullisht në tokë në saje të disa rastësive të njëpasnjëshme?

Asnjë ateist apo deist nuk ka frikë se mos nesër oksigjeni do të pakësohet, dhe për rrjedhojë nuk merr masa të tipit: të shëtisë përherë me një bombol oksigjeni pranë. Ata i besojnë një fuqie hyjnore. Pra, edhe pse logjikisht e pranojnë fuqinë e Allahut të Madhëruar, për shkak të egove të tyre ata jetojnë brenda një vorbulle të fortë indiference.



Ateizëm, mohim, kundërshtim... Këto janë një ikje... Prej përgjegjësisë, devotshmërisë ndaj Allahut dhe detyrës. E ndërkohë që ikin, këto i përdorin vetëm si justifikime. Ndërsa deizmi, është pranimi i këtyre me gjysmë zëri. Por një pranimi i tillë, nuk ka të bëjë me mendjen dhe kuptimin. Ajo është vetëm rrënim shpirtrash.

Ateizëm, mohim, kundërshtim...

Të gjitha janë ikje... Prej përgjegjësisë, devotshmërisë ndaj Allahut dhe detyrës. E ndërkohë që ikin, këto qasje i përdorin vetëm si justifikime.

Ndërsa deizmi është pranimi me gjysmë zëri. Por një pranim i tillë nuk ka të bëjë me mendjen dhe kuptimin. Ai është vetëm rrënim shpirtrash. Një besimi i tillë lidhur me Krijuesin, nuk ka asnjë vlerë për botën tjetër.

Siç e thamë, për të mohuar Krijuesin absolut, duhet të jesh i marrë!

Deisti, gjoja nuk e mohon Krijuesin, por mohon se Ai është Zot. Po ashtu, ai mohon fenë, librat, profetët dhe të gjitha ligjet e Zotit.

Përpjekja për ta shndërruar në një mendim, mohimin e profetit, librit të shenjtë dhe të botës tjetër, pavarësisht enigmave dhe urtësive të pafundme dhe të mrekullueshme në gjithësi, nuk është gjë tjetër veçse mohim i mendjes, logjikës dhe arsyes. Ky lloj mohimi i quajtur deizëm, është thjesht mjerim.

Ateizëm do të thotë;

- Të shohësh shkaqet, por jo Shkaktarin,
- Të shohësh veprën, e të anashkalosh Vepruesin,
- Të shohësh artin, e të mohosh Artistin!

Kurse deizmi, nënkupton se këto shkaqe, vepra dhe arte, janë pavlerë, paqëllim dhe padobi, gjë e cila do të thotë se nuk ndryshon thuajse aspak nga ateizmi. Zbukurimi dhe ndërrimi i emrit, është vetëm një prej hileve të shejtanit.

Për shembull, duke përdorur emra të tjerë për disa fenomene negative si zinaja/imoraliteti që sot quhet flirt apo dashuri, kamata e cila quhet fitim apo zhvillim, kumari i cili quhet lojë, etj., njerëzit po priren drejt tyre



Ismail Fenni: "Ne nuk mund të rrimë pa u mahnitur dhe pa thënë, "sa e mrekullueshme!" për çdo vepër të artit hyjnor që shohim në këtë botë. Atëherë, përse kur shohim fuqinë dhe urtësinë e artistit të këtyre, të mos themi, «Qenia më e përsosur dhe më superiore»?"

(Maddiyyun Mezhebi'nin İzmihlali, s. 28.)

pa e vënë re rrezikun që paraqesin. Pra, emri deizëm apo të ngjashëm me të, nuk e ndryshojnë aspak faktin se këto ide përfaqësojnë mohimin dhe pafesinë.

Allahu i Madhëruar na i mbushtë zemrat me besim dhe dije të sigurt dhe na pastroftë prej ndotjes nga dyshimet dhe vesveset! Allahu na bëftë prej atyre që gjejnë paqen dhe kënaqësinë!..

Amin!..



Ismail Fenni: "Për mendimin tim, ata që nuk arrijnë ta perceptojnë madhështinë e Allahut, janë vetëm njerëzit mendjeshkurtër të kapluar nga sëmundja e dyshimit dhe të mahnitur nga idetë e gabuara e të pështjelluara të filozofisë!" (Maddiyyûn Mezhebi'nin İzmihlâli, s. **28**)



PYETJE NË VORBULLËN E VESVESEVE

Shpesh dëgjohen pyetje mendjelehta si,
“a mos më pyeti Allahu kur më krijoi?” Mirëpo,
Allahu i Madhëruar thotë: “Ti ishe asgjë, Unë të krijova!”

E çfarë vlere ka një “hiç” para një “Fuqie absolute”?

Pastaj, sa logjike është që një Fuqi
dhe Vullnet absolut e pa të meta, të pyesë diçka
që nuk ekziston fare? Çfarë pyetje mund t’i bëhet asgjësë?



PYETJE NË VORBULLËN E VESVESEVE

Në internet dhe në media po qarkullojnë disa pyetje në lidhje me deizmin dhe ateizmin, të cilat burojnë prej një studimi akademik. Disa nga këto janë pyetje të cilat kanë marrë përgjigje prej kohësh nga ana e dijetarëve të Kelamit[5]. Ndërsa disa të tjera janë pyetje fëmijërore dhe tepër absurde, aq sa nuk mund të merren seriozisht për t'iu përgjigjur.

Këto lloj pretendimesh i vijnë rëndë zemrës së një besimtari kur flet për to apo i shkruan qoftë edhe për t'i përgënjeshtruar.

Mirëpo;

5. Kelam: Shkenca që studion doktrinën Islame.

Të bësh shpjegime përmirësuese, të cilat ua heqin dyshimet dhe vesveset e helmatisura mendjeve të turbulluara, është një detyrë e domosdoshme. Madje, përveç shpjegimit në mënyrë personale, sot është shumë e rëndësishme që të bëhet edhe me anë mediave të shkruara si gazetat, revistat e librat dhe ato audiovizive, si radioja, televizioni dhe interneti. E gjithë kjo konsiderohet si një prej degëve të urdhërimit në punë të mira.

Koha në të cilën jetojmë është një periudhë në të cilën masa e injorancës është në nivele të larta dhe rrymat e mohimit dhe devijimit po përhapen gjithandej.

Për këtë arsye është me vend tu japim përgjigje disa prej këtyre pyetjeve:

Një pjesë e rëndësishme janë pyetje në lidhje me çështjen e kaderit/caktimit hyjnor. Ndërsa vetë kaderi është një çështje përtej mendjes njerëzore, së cilës duhet t'i qasesh me dorëzim. Ata që nuk mund ta vazhdojnë rrugën e tyre të dorëzuar, bien ose në batakun e mohimit të kaderit, ose në atë të mohimit të vullnetit të lirë. Madje ka nga ata që guxojnë edhe të fajësojnë Allahun e Madhëruar për shkak të dijes dhe fuqisë së Tij të pakufishme.



Mendja është një vegël, si një thikë me dy presa, e cila mund të përdoret edhe për mirë, edhe për keq. I pari që e përdori mendjen për keq dhe tentoi të debatojë me Krijuesin, ishte shejtani, i cili u dëbua nga mëshira hyjnore dhe iu kushtua devijimit nga rruga e drejtë.

- Allahu zotëron dije dhe fuqi të pakufishme. Ai është i pastër prej çdo cilësie njerëzore. Ne nuk e njohim të ardhmen, por për Allahun nuk ka asnjë të fshehtë. Ai e di mirë përfundimin e çdo robi të Tij.

- Allahu i Madhëruar i sprovon

robërit e Tij dhe në bazë të rezultateve që ata do të marrin prej këtyre sprovave, ditën e gjykimit, Ai do t'i dërgojë ose në Xhenet, ose në Xhehenem.



Në fakt, mendja është një peshore hyjnore që është dhënë për të mos rënë në kurthet e egos dhe shejtanit. Ajo është një qendër vetëdijeje tek njeriu, e cila ndan të mirën nga e keqja. Prandaj ai nuk duhet ta lërë atë peshore në duart e egos dhe të shejtanit!..

Ata që nuk i bëjnë dot bashkë në mendjet e tyre këto dy të vërteta, bien në gabimin e vlerësimit të Zotit si një qenie njerëzore dhe me anë të interpretimeve të pallogaritura mirë, thurin pyetje të njëanshme dhe të palogjikshme. Mirëpo në fakt ata shfaqin ide absurde me qëllim që të bëjnë një jetë dembele, moskokëçarëse, pandjenja dhe pavetëdije ndaj përgjegjësive dhe për t'u zhytur sipas qejfit në vepra të ulëta, vetëm e vetëm se çështjet e mëdha u duken shumë të rënda. Ata veprojnë kështu edhe pse e dinë shumë mirë se gjykimi është personal dhe se fundi i keq do të shkatërrojë vetëm ata. Për shembull, ata thonë:

"Nëse Allahu e di se ne do të hyjmë në Xhenet apo në Xhehenem, atëherë përse na sprovon?"

Ose;

"Përderisa Allahu di gjithçka, përse na ka krijuar?"

Mirëpo, ata harrojnë se:

Vetë ata, për të dhënë vetëm një copë letre të thjeshtë, të cilën e quajnë çertifikatë apo diplomë, bëjnë provim pas provimi për vite me radhë në emër të arsimimit, sepse e dinë që dembelin do ta ngelin në klasë, ndërsa nxënësin e mirë do ta kalojnë. Më pas, kur duan ta marrin në një punë, i kërkojnë vetëm diplomat që i janë dhënë sipas kritereve të suksesit

në provimet e shumta. Përndryshe, as nuk e shohin me sy.

Tani;

Nëse dikush, i cili vepron me një sistem të tillë në të gjithë botën, refuzon idenë e sprovimit nga Zoti, dhënies së një diplome dhe përcaktimit të një vendi ku do shkojë në bazë të rezultateve, atëherë ai bie në një kundërshtim absurd me vetveten.

Ndërkohë që vetë ai, i bën të tjerët të përjetojnë humbje apo fitore në bazë të sistemit të provimit dhe diplomës, me çfarë logjike e quan të gabuar të njëjtin veprim nga ana e Allahut?



Absurditeti i deizmit: "Zoti e ka krijuar gjithësinë dhe është tërhequr mënjanë!" Pra, gjoja ashtu siç ka krijuar kafshët dhe i ka lënë pa kontroll, ashtu ka krijuar edhe njeriun dhe e ka lënë në kokë të vet. Mirëpo, nuk është aspak kështu! Të gjitha krijesat, që prej grimcës më të vogël, e deri tek trupi më i madh, janë të lidhura pas një qëllimi. Po ashtu çdo krijesë është një shkak meditimi për njeriu.

Nëse vendimet do të merreshin pa marrë parasysh provimet dhe pa ndonjë kriter, e ai do ta gjente veten në Xhehenem pa asnjë faj, a nuk do të pyeste:

"Përse Allahu nuk më vuri në provë?"

Po, ai do ta bënte atë pyetje dhe nuk do të thoshte:

"Në saje të dijes së Tij të pakufishme, Allahu e di se unë jam prej banorëve të Xhehenemit, prandaj nuk kishte nevojë të më vinte në provë!"

Kjo është përgjigja e pyetjeve: "pse, përderisa e di?" Kur Allahu i Madhëruar i sprovon njerëzit, cakton dëshmitarë dhe argumente të cilat ata nuk do t'i kundërshtojnë dot.

Melekët janë dëshmitarë, të cilët mbajnë shënim veprat e njerëzve.

Madje, edhe gjymtyrët e njeriut do të dëshmojnë për të. Edhe vendet do të dëshmojnë, edhe vetë ndërgjegjja e njeriut do të jetë aprovuese e vendimit që do të merret për të.

Allahu i Madhëruar nuk mund të krahasohet me asgjë. Por, me qëllim që të kuptohet, mund të bëhet një përngjasim i tillë:

Një mësues me përvojë i thotë nxënësit të tij:

"Nëse nuk mëson, do të mbetesh në klasë!"

Më pas fillojnë provimet dhe nxënësi mbetet vërtet në klasë. A është paralajmërimi i mësuesit shkaku i dështimit të nxënësit, apo mos vallë dija e mësuesit për dështimin e nxënësit? Padyshim që jo!



Edhe krijimi i botës së kafshëve ka një qëllim të veçantë. Bleta prodhon mjaltë, pula bën vezë, lopa jep qumësht, kali mban barrë, milingonat janë shembulli më i bukur i punës së përbashkët me sistem, etj., etj... Atëherë, si mundet që njeriu të mos e ketë një qëllim!?

Në fakt, këto pyetje, lidhen me këto pyetje të tjera:

"Përse sprovon Zoti?" dhe *"Pse i dënon Ai mohuesit dhe kundërshtuesit e Tij?"*

Mirëpo, në këtë pikë duhet të bëjmë shumë kujdes, sepse:

Allahu i Madhëruar është "Fail-i Mutlak / Vepruesi Absolut". Ai është e vetmja fuqi që mund të bëjë atë që dëshiron. Allahu është "Maliku'l-Mulk / Sunduesi Absolut". I gjithë universi i takon Atij. Po ashtu, Ai është "Fail-i Muhtar / i Lirë në çdo veprim". Pra, Ai e menaxhon pronën e Tij ashtu siç dëshiron dhe askush nuk ka të drejtë t'i kërkojë llogari.

Zoti ynë dëshiroi të na sprovojë. Xheneti nuk është aspak i lirë, ndërsa Xhehenemi aspak i panevojshëm.

Në këtë provim, Allahu i Madhëruar ka shfaqur mëshirë të pafundme.

• Njeriun e ka bërë të aftë për këtë provim, duke i dhënë atij mendje dhe vetëdije. Ndërsa njerëzit me aftësi të kufizuara mendore dhe ata nën moshën e caktuar, i ka përjashtuar nga ky provim.

• Çdo gjë në univers e ka krijuar si mundësi meditimi për njeriun. Nëse njeriu e përdor siç duhet mendjen dhe zemrën që i ka falur Allahu, meditimi do të jetë një çelës besimi për të.



"Ai i ka çelësat e së padukshmes dhe vetëm Ai i njeh ato. Ai e di ç'ka në tokë dhe në det; asnjë gjeth nuk bie, pa e ditur Ai dhe nuk ekziston asnjë kokërr në errësirën e tokës, as e njomë, as e thatë, që të mos jetë shënuar në Librin e qartë (Leuhi Mahfudh)."

(En'am, **59***)*

• Allahu i Madhëruar ka dërguar profetë dhe ka zbritur libra, me qëllim që ata t'i tregojnë rrugën mendjes dhe vetëdijes njerëzore. Krahas këtyre, Allahu i ka dhënë njerëzimit edhe dijetarë, të cilët kanë marrë përsipër detyrën e kumtimit të fesë, të urdhërimit në punë të mira dhe ndalimit nga të këqijat.

Në Kuranin Fisnik urdhërohet:

"(Këta janë) **të dërguar që kanë sjellë lajme të mira dhe kanë paralajmëruar, në mënyrë që njerëzit të mos kenë ndonjë justifikim ndaj Allahut, pas ardhjes së të dërguarve. Se, Allahu, është i Plotfuqishëm dhe i Gjithëdijshëm."** (Nisa, 165)

- Allahu i Madhëruar ka dhënë jetë të mjaftueshme që njeriu të vetëdijesohet. Për rrjedhojë, Ditën e Gjykimit, atyre që ankohen do t'u thuhet:



Çdo krijesë, që prej më të voglës, e deri tek më e madhja, është një tablo mësimdhënëse, një mrekulli e artit hyjnor... Për rrjedhojë, nëse nuk arrijmë të shkojmë prej pasojës tek shkaku, prej artit tek artisti, kjo nuk është gjë tjetër, përvese një çmenduri mendore.

"...«Vallë, a nuk jua zgjatëm jetën aq sa të mund të mendohej ai që donte të kujtonte (Allahun)**?! Madje juve ju erdhi edhe paralajmëruesi.**

Andaj, shijoni (dënimin)**! Për keqbërësit nuk ka kurrfarë ndihmësi!»"** (Fatir, 37)

• Allahu i Madhëruar nuk e ka dënuar njeriun menjëherë sapo ka vepruar një gjynah, por i ka dhënë atij afat për t'u penduar, deri në frymën e fundit.

• Allahu ka krijuar shumë shkaqe për faljen e gjynaheve. Veprat e këqija i dënon vetëm aq sa janë, ndërsa të mirat i shpërblen minimumi dhjetëfish më tepër.

Prandaj, ta fajësosh Allahun për shkak të atyre që meritojnë Xhehenemin, është arrogancë, fyerje dhe kalim i kufijve.

Komentuesi i Kuranit, Elmallëllë Hamdi Jazër, thotë:

"Ndëshkimi i Allahut është vetë drejtësia, ndërsa falja e Tij është vetë mirësia!"

Pra, nëse Allahu i Madhëruar ndëshkon, kjo nuk është padrejtësi, por vetë drejtësia. E, nëse Ai fal dhe dhuron Xhenetin, kjo nuk është meritë e robit, por mirësia bujare e Zotit.


Drejtësia ka të bëjë me çështjen e pagimit ose jo të çmimit të mirësive. Në fakt, në mirësi nuk kërkohet drejtësi dhe krijimi ynë nga ana e Allahut është vetëm prej mirësisë së Tij, jo për shkak të meritës sonë. Pra, ai që dhuron diçka,

nëse dëshiron jep, nëse jo nuk jep. Po ashtu, ai i jep shumë apo pak kujt të dëshirojë dhe askush nuk ka të drejtë t'i kërkojë llogari.

Mirëpo, nga ana tjetër, robi është përherë i detyruar të japë llogari, sepse atij i janë dhënë mirësi, përgjegjësi dhe detyra.

Në fakt, Allahu i Madhëruar na ka krijuar si njerëz, pa asnjë meritë. Na bëri më të nderuarit mes të gjitha krijesave të tjera dhe e zgjodhi umetin e Muhammedit ﷺ, mes gjithë umeteve të tjera. Prandaj, në këmbim të të gjitha mirësive që na janë dhuruar, ne duhet të paguajmë borxhin e tyre dhe ashtu të shkojmë në botën tjetër.

Pra, pasi të kemi bërë një jetë me përgjegjësinë për të shlyer borxhin e falënderimit në këtë botë, do të nxirremi para Zotit tonë. Atje do të lexojmë librin e punëve tona, që është si dëftesa e provimit tonë në këtë botë. Do të shohim filmin e jetës sonë dhe, kur të na vihen para dosjet e jetës sonë ku janë shënuar pa mangësinë më të vogël të gjitha veprat tona, ne do t'i lutemi Zotit tonë për "mëshirë", e jo për "drejtësi". Kjo, sepse veprat e mira që kemi bërë në këtë botë, do të jenë thuajse asgjë në krahasim me mirësitë që Allahu i Madhëruar na ka dhënë në këtë jetë.



E çfarë mund të jetë tjetër qëndrimi indiferent, pandjenja dhe injorant përballë mrekullive të pafundme madhështore, që prej grimcës më të vogël, e deri tek trupi më i madh, prej botës mikro, e deri në atë makro, të cilat ndriçojnë më së miri mendjen dhe zemrën, përveçse një çmenduri dhe falimentim i mendjes!?

Njëherë, i Dërguari i Allahut, ﷺ, tha:

"Askush nuk do të shpëtojë në saje të punës së tij!"

Sahabët të habitur pyetën:

"As ju nuk mund të shpëtoni, o i Dërguar i Allahut?"

Profeti ﷺ tha:

"(Po) edhe unë mund të shpëtoj vetëm në saje të mëshirës dhe bujarisë së Allahut!" (Muslim, Munafikin, 76, 78.)

Në drejtësi ekziston ekuilibri mes dobisë dhe dëmit.

Në fund të këtij provimi qëndron një mirësi e madhe si Xheneti i përjetshëm. Ndërsa dështimi i përjetshëm për ata që humbasin, pavarësisht gjithë ndihmës hyjnore, është vetë drejtësia.

Edhe pse është një krijesë e përkohshme, njeriu e ndjen veten të lirë ndërkohë që zotëron menaxhimin mbi krijesat e tjera që Allahu i Madhëruar ka vënë në shërbim të tij.



A nuk është një mjeran ai që mburret me mendjen e vet dhe rrënon shpirtin e tij duke e konsideruar si pashkak, paqëllim dhe të rastësishme këtë rregull të mrekullueshëm që vërehet pandërprerë në gjithësi, si në vetët e tyre, ashtu edhe në horizonte?

Për shembull;

• Njeriu përfiton prej deleve, lopëve, pulave dhe peshqeve, prej qumështit, mishit, vezës, etj. Por ai nuk pyet kurrë: "a kam të drejtë ta bëjë këtë?".

• Njeriu bën dallimin e të vlefshmes dhe të pavlefshmes mes krijesave. Atë që e konsideron të pavlefshme e hedh në plehra, ndërsa atë që i duket e vlefshme e ruan për vete. Por përsëri nuk pyet: "a kam të drejtë për këtë?".

• Njeriu vë në punë punëtorë, e nuk thotë kurrë: "çfarë të drejte kam t'i urdhëroj", por thotë vetëm: "unë i paguaj ata!".

Pra, kur puna na qenka kështu;

Kush dhe me çfarë të drejte mund ta kundërshtojë vendimin e Allahut të Madhëruar për ndëshkimin e atyre që e mohojnë Atë dhe bëjnë gjynahe, duke qenë se Ai i ka krijuar, u ka dhënë shpirt, mendje, mendim, vetëdije e jetë dhe u ka dërguar profetë dhe libra udhëzues?

Ja edhe disa pyetje të palogjikshme të ngjashme me ato të mësipërmet:

Pyetje: *"Nëse Allahu na do, përse na lejon të bëjmë gjynahe, e pastaj na çon në zjarr?"*

Pyetje: *"Përse Allahu nuk i pengon të këqijat?"*

Pyetje: *"Nëse është caktuar se ne do të shkojmë në Xhenet apo në Xhehenem, përse kryejmë adhurime?"*

O njeri;



Mendjelehti, përfiton prej deleve, lopëve, pulave dhe peshqve, prej qumështit, mishit, vezës, etj., por ai nuk pyet kurrë, "a kam të drejtë ta bëjë këtë?" E më pas, thotë, "Përse nuk më pyeti Allahu kur më krijoi?"...

Edhe në një sistem njerëzor, përgjigjet e një provimi varen nga ai që i nënshtrohet provimit. Nëse një mësuesi i cili e do fort një nxënës, ndërhyn gjatë provimit kur nxënësi u përgjigjet pyetjeve gabim, duke e shkruar vetë përgjigjen e saktë, atëherë ai do të dëbohej nga profesioni për shkak të favorizimit dhe kopjimit në provime.

Mirëpo, cili është kushti i mësuesisë së drejtë?

Të mos ndërhyjë në provim, qoftë edhe për nxënësin që e do më shumë. Pra, fakti që mësuesi e lejon nxënësin të bëjë gabim në provim, e më pas e ngel atë në klasë, nuk vlerësohet si mungesë dashurie.

Përkundrazi, një mësues i tillë,

përgëzohet për drejtësinë dhe besnikërinë ndaj profesionit. Pra, ndërkohë që për njeriun vlen ky qëndrim, përse kur vjen puna tek Zoti, përdoret logjikë e kundërt?

Pastaj;

Lojërat e fjalëve lidhur me çështjen e caktimit, se kush do shkojë në Xhenet apo në Xhehnem, bëhen nga njerëzit që e kanë të prishur peshoren e mendjes. E në fakt, këto lojëra nuk funksionojnë në asnjë peshore të rregullt.



Lojërat e fjalëve lidhur me çështjen e caktimit se kush do shkojë në Xhenet apo në Xhehenem, bëhen nga njerëzit që e kanë të prishur peshoren e mendjes. Mirëpo, këto lojëra, nuk funksionojnë në asnjë peshore të rregullt.

Sepse;

Dihet se ata që do të shkojnë në Xhenet janë besimtarët e drejtë. Këtë e vërtetojnë fjalët e Allahut të Madhëruar. Po ashtu, dihet edhe se në Xhehnem do të shkojnë mohuesit dhe gjynahqarët. Pra;

Nuk ekziston asnjë ligj hyjnor që thotë: "Nëse të është shkruar se do të shkosh në Xhehnem, ti do të hysh patjetër në Xhehenem, sado besimtar i drejtë dhe i dorëzuar tek Allahu të jesh!"

Po ashtu;

Nuk ekziston as edhe një ligj hyjnor që thotë: "Nëse të është shkruar se do të shkosh në Xhenet, ti do të shkosh patjetër në Xhenet, edhe pse ke qenë mohues, mizor, gjynahqar dhe i lidhur fort pas shejtanit!"

Ndërsa e vërteta është se, mohuesit e Allahut do të shkojnë në Xhehenem, ndërsa besimtarët e drejtë në Xhenet.

Loja e fjalëve që bëhet këtu, është paraqitja e vendimit

në anë të kundërt. Pra, në fillim flitet për fundin, e në fund për fillimin. Mirëpo, e vërteta nuk është aspak ashtu!.. Thënia, "përse të bëjë punë të mira ai që është caktuar për në Xhehnem?", ka një logjikë të gabuar, sepse realiteti nuk është kështu.

E vërteta është se:

Ekziston një kohë sprove deri në frymën e fundit dhe, kush e mbush këtë kohë me besim të drejtë, vepra të mira, dorëzim dhe mbështetje tek Allahu i Madhëruar, nuk do të shkojë në Xhehnem. Po ashtu, në asnjë vend të Kuranit nuk thuhet qoftë edhe një fjalë të vetme se një jetë të tillë do të përfundojë në Xhehenem.

Por, kujt i përkasin këto lloj fjalish?

Disa indiferentëve dhe injorantëve të cilët nuk e njohin të vërtetën.

Dhe kjo, tregon se përdorimi i një formule në të kundërtën, në mënyrë që të mos funksionojë, bëhet vetëm për të ngatërruar punë, e jo për të kuptuar të vërtetën. Pra, ndërkohë që Allahu ka vendosur formulën: "mohuesit dhe zullumqarët në Xhehenem", ata e kthejnë në të kundërt dhe e bëjnë të duket sikur më parë shkruhet për në Xhehnem, e më pas njeriu detyrohet të bëjë vepra të Xhenetit, gjë e cila nuk mund të pranohet në asnjë peshore të drejtë.

Kjo lloj filozofie, prapaskena e së cilës është ikja prej sprovës, nuk është asgjë tjetër përveçse një zgjedhje për t'u kapur prej dënimit më të hidhur.



Shekujt dëshmojnë se; Njeriu i arrin dijet duke u zvarritur. Të gjitha informacionet e vjetra dhe të reja që i janë dhënë njeriut në çdo periudhë, në fakt, janë mëshira, mirësia dhe gostia e Zotit tonë të Madhëruar, i Cili ka dëshiruar që ne të meditojmë rreth madhështisë dhe fuqisë së Tij.



Lum ata që i lexojnë siç duhet rreshtat e mbushur me urtësi dhe të vërteta të librit të kësaj gjithësie, i kuptojnë dhe thellohen në horizontin e meditimit!

Allahu është krijuesi edhe i së mirës, edhe së keqes. Në fakt, Ai nuk e pëlqen të keqen, por e ka krijuar atë vetëm si domosdoshmëri e sprovës. Kështu, edhe lejimi i robit për të bërë gjynah, është një prej kushteve të sprovës.

E megjithatë, Allahu jo çdo herë e lejon realizimin e së keqes. Shumë krime mbesin në tentativë dhe nuk e shohin dritën e suksesit për shkak të moslejimit nga ana e Allahut.

Mirëpo, le të mendojmë të kundërtën: Nëse Allahu i Madhëruar nuk do të kishte lejuar realizmin e asnjë të keqeje, atëherë nuk do të kishte më vend për një sprovë, gjë e cila e bën të pakuptimtë edhe vetë Xhenetin.

Po ashtu, le të mendojmë sikur në shkolla të mos bëheshin provime. A do të kishte vlerë sikur këto shkolla të jepnin diploma mjekësie pa provim?

Në natyrën e njeriut ekziston dëshira për të garuar, për t'u përpjekur dhe për ta merituar diçka sadopak. Allahu i Madhëruar urdhëron:

"...Garoni në punë të mira!.." (Maide, 48)

Ndërsa në një ajet tjetër urdhërohet:

لِيَبْلُوَكُمْ اَيُّكُمْ اَحْسَنُ عَمَلاً

"Ai i ka krijuar jetën dhe vdekjen, për t'ju provuar se kush prej jush do të veprojë më mirë..." (Mulk, 2)

Po ashtu, duhet të mos harrojmë edhe se në këtë botë, një pronar mund ta heqë nga puna punëtorin që nuk i bindet,

vetëm sepse është ai që ia jep rrogën, dhe e lë atë të papunë, e mbase edhe të uritur. Madje, ai as që e ndjen veten përgjegjës për këtë, sepse mendon se nuk është i detyruar të mbajë me bukë dikë që nuk i bindet urdhrave të tij si pronar.

Po Allahu i Madhëruar; a është i detyruar Ai t'i mbajë në jetë mes gjithë të mirave robërit që nuk i binden urdhrave të Tij, e akoma më keq, që e mohojnë Atë?..

Ai bën ç'të dëshirojë. Mirëpo nuk bën padrejtësi. Ai i trajton robërit e Vet me drejtësi, mëshirë dhe urtësi. Për këtë arsye, mohuesve dhe zullumqarëve nuk u pritet furnizimi prej Allahut pavarësisht paudhësive të tyre. Në Kuranin Fisnik urdhërohet:

إِنَّ اللهَ لَا يَظْلِمُ النَّاسَ شَيْئًا
وَلٰكِنَّ النَّاسَ اَنْفُسَهُمْ يَظْلِمُونَ

"Në të vërtetë, Allahu nuk u bën njerëzve asnjë të keqe, por ata i bëjnë keq vetvetes." (Junus, 44.)



Një mendimtar ka thënë: "Nëse shkenca me fenë ndahen, feja (pa dije) i shpie njerëzit në prapambetje, ndërsa shkenca (pa fenë), i shpie në ateizëm." Pikërisht për shkak të këtij gabimi, u edhe krishterimi u bë justifikim për deistët.

وَمَا ظَلَمَهُمُ اللهُ وَلٰكِنْ اَنْفُسَهُمْ يَظْلِمُونَ

"...Allahu nuk u ka bërë padrejtësi atyre, por ata i kanë bërë padrejtësi vetvetes." (Al-i Imran, 117. Shih. Nahl, 33.)

Gjithashtu, edhe këto pyetje kanë të njëjtat veçori me ato të mësipërmet:

"Ardhja në këtë botë, nuk është zgjedhja ime. Allahu thotë se unë e kam marrë përsipër këtë, por nuk e mbaj mend!?"

O njeri!

A nuk është i tillë edhe menaxhimi

që i bën ti jetës dhe gjërave në saje të veçorive të tua?

Kur ti e përpunon gurin dhe nxjerr në pah një vepër arti, kujt i takon zgjedhja e kësaj, ty apo gurit?

Ty!

A nuk është kjo ajo më e logjikshmja?

Ashtu është!

Po sikur t'i takonte gurit, çfarë do të ndodhte?

Nëse këtë logjikë absurde që tenton të përdorësh kundër Allahut, do ta përdorje edhe në lidhje me gurin apo për të gjitha gjërat që u jep formë, atëherë nuk do të jetoje dot.



Të kundërshtosh edhe fenë e drejtë bashkë me fenë e prishur, i ngjan atij që për t'u ruajtur nga ushqimi i dëmshëm, refuzon të hajë çfarëdo ushqimi tjetër, edhe nëse ai do t'i sillte shërim, gjë e cila nuk ndryshon aspak nga një vetëvrasje.

A pyet se çfarë dëshirojnë frutat që t'i i zgjedh dhe i ha me aq dëshirë? Po ashtu, a pyet për dëshirën e mishit, peshkut dhe kafshatave që ti i zgjedh dhe i ha me ëndje të madhe?

A ke menduar ndonjëherë t'i pyesësh gurët që ti i gdhend ashtu siç dëshiron, nëse e duan apo jo këtë? E në fakt, a nuk e kanë marrë vetë përsipër ata gurë artin tënd? Po e kanë marrë! A mundesh që aftësitë e treguara tek ta, t'ia shfaqësh edhe një copë letre apo teneqeje? Jo!

Të marrësh përsipër diçka, varet nga mundësia për ta bërë atë. Nëse nuk është e mundur, do ishte e gabuar.

Për shembull, druri i plepit nuk mund të bëhet shtylla kryesore e një ndërtese. Atij nuk mund t'i ngarkohet kjo përgjegjësi. Ai do të thyhej menjëherë, sepse struktura e tij

nuk është e përshtatshme për këtë detyrë, edhe pse ai mund ta ketë marrë përsipër atë.

Ja pra, e njëjtë është edhe marrja përsipër e amanetit hyjnor nga ana e njeriut. Për shkak se njeriu është krijuar në mënyrë që të ketë mundësi të bartë këtë të vërtetë, të cilën krijesat e tjera nuk munden, kjo detyrë i është ngarkuar atij dhe ai e ka marrë përsipër në mënyrë të natyrshme.

Kështu që;

Në shprehjen: "nuk është zgjedhja ime", ka një lloj arrogance dhe, në të njëjtën kohë, një gabim logjik.

• Nëse nuk ekziston, njeriu nuk mund të pyetet për zgg jedhjen e tij.

• E kur ai të ekzistojë, pra kur të jetë krijuar, tashmë nuk ka mbetur asgjë për të pyetur.

Ashtu siç edhe u shprehëm më sipër;



Krishterimi, i cili hëngri vulën e zhvlerësimit nga Allahu, sot, nuk është asgjë tjetër përveçse një rozetë e pavlerë. Një rozetë që nuk i jep asnjë qetësi shpirtërore dhe morale bartësve të saj...

Zgjedhja e një vepre i takon krijuesit të saj, sepse asnjë vepër nuk mund të zgjedhë vetveten. Pra, njeriu prodhon një makinë dhe zgjedhja e prodhimit të saj nuk i takon makinës, por vetë njeriut. Askush nuk e kundërshton këtë realitet. Përkundrazi, të gjithë e admirojnë dhe vetëm përfitojnë prej saj.

Po ashtu;

Njeriu prodhon kolltukë dhe krevate, të cilët i përdor për qejf të vet. Mirëpo, këtë nuk e ka dëshiruar druri me të cilin prodhohen ato orendi, por mjeshtri i tyre.

Kështu që;

Nëse njeriu ia bën vetes këto pyet-

je që mendon se ka të drejtë kur ia drejton Allahut, ai nuk mund të prodhojë më asnjë vegël dhe asnjë ndërtesë. Një pyetje e tillë do ta paralizonte të gjithë jetën.

Asnjë material nuk prodhon këpucë, shtëpi, makina, avionë, etj., me dëshirën dhe zgjedhjen e vet. Të gjitha këto janë zgjedhje e njeriut.

Pra, në sprovën e kësaj bote ekzistojnë vetëm dy mundësi:

Ose mos ekzistenca, ose nënshtrimi ndaj sprovës.

Prej sprovës nuk mund të iket!

Dëshira "edhe për të ekzistuar, edhe për të mos u sprovuar", është një iluzion i kot.

Mbi të gjitha, të ekzistosh është një mirësi. Prandaj, ta gëzosh këtë mirësi dhe të thuash, "mua nuk më pyetën!", i ngjan këtij shembulli:



Papa aktual Francesku, degjenerimin që i ka shkatërruar vet ata, përpiqet të na e shesë me këto fjalë: "Ashtu siç kemi vepruar ne me tekstet tona të shenjta, është mirë që edhe myslimanët të bëjnë një punë kritike mbi Kuranin. Metoda e interpretimit historik dhe kritik, do ndihmojë në zhvillimin e tyre."

Gjatë një zjarri që kishte rënë në një vend, njerëzit që po përpiqeshin të evakuonin vendin të kapluar nga paniku, shohin dikë që ende ishte në gjumë dhe përpiqen ta zgjojnë. Mirëpo, ai, në një mënyrë mosmirënjohëse, thotë:

"A më pyetët nëse doja të zgjohesha?"

Nëse do të pyetej, ai normalisht do të zgjohej. Mbi të gjitha, kush është ai që dëshiron të digjet e të shkrumbohet? Kush dëshiron të zhduket e të mos ekzistojë?

Një çështje tjetër që e mashtron njeriun, është edhe ngu-

shëllimi i vetes me anë të dëshirave dhe iluzioneve të kota. Këtë e vërtetojnë edhe ajetet e Kuranit fisnik ku tregohet se në fund të rrugës, pra në botën tjetër, dështakët do të thonë të dëshpëruar: "Ah sikur të kalojmë edhe njëherë përmes asaj sprove... ah sikur të ishim dhe... sikur të vdisnim, e të zhdukeshim...".

Fakti që njeriu shkon pas këtyre iluzioneve dhe dëshirave të kota, ndërkohë që ka nderin të jetojë si qenie njerëzore dhe të jetë rob i devotshëm i Zotit, duke qenë njëkohësisht edhe krijesa më e nderuar në këtë botë, nuk shpreh gjë tjetër veçse dëshirën e tij për t'i ikur sprovës.

Allahu e krijoi njeriun si krijesën më fisnike, duke e ngritur atë mbi krijesat e tjera dhe duke i fryrë prej shpirtit të Tij. Madje, siç urdhërohet edhe në Kuranin Fisnik, Allahu e bëri atë sundues në tokë:

"Ai ju ka bërë sundues në Tokë dhe ka ngritur në shkallë disa nga ju mbi të tjerët, për t'ju provuar në atë që ju ka dhënë..."

(En'am, 165.)



Kjo botë, është vendi i sprovës dhe prej kësaj sprove nuk mund të iket! Dëshira "edhe për të ekzistuar, edhe për të mos u sprovuar", është një iluzion i kot.

Tani duhet të pyesim;

A ka paguar njeriu ndonjë çmim për të ardhur në këtë botë si njeri? Ose, për shkak të cilave veçori, Allahu i Madhëruar e krijoi atë si njeri?

Ta pyesim atë që thotë: *"nuk e kam zgjedhur unë të jem njeri!"*:

A pranon ta ndërrosh?

Pra, nëse do të ishte e mundur, a do të pranoje ta ndërroje ekzistencën tënde njerëzore, mendjen, shpirtin dhe ndjenjat njerëzore, me një krimb toke, apo me një mi?

Është apo s'është zgjedhja jote?

Dikujt i dhurohet një thesar i madh me të cilin do të përballojë të gjitha nevojat e tij, ndërkohë që ai nuk ka as të drejta dhe as pretendime. A mundet që ky person t'i drejtohet atij që ia ka dhuruar këtë thesar dhe t'i shprehë pakënaqësinë e vet duke i thënë: *"si munde të ma dhurosh këtë thesar, a më more leje për këtë"*?



Nëse njeriu thotë, "ah sikur të mos ekzistonte sprova", ndërkohë që ai ka nderin të jetojë si qenie njerëzore dhe të jetë rob i devotshëm i Zotit, duke qenë njëkohësisht edhe krijesa më e nderuar në këtë botë, kjo nuk shpreh gjë tjetër veçse dëshirën e tij për t'i ikur sprovës.

Për të folur në këtë mënyrë, duhet të jesh i privuar plotësisht prej mirësisë së mendjes, sepse një njeri me mendje të shëndoshë do të shprehte vetëm mirënjohje, dashuri dhe falënderim ndaj atij që ia ka falur atë thesar.

Ndërkohë që në këtë botë të përkohshme e kemi për borxh moral të falënderojmë qoftë edhe atë që na jep një gotë ujë, si mund të thuhen këto fjalë kaq të shëmtuara kundër Allahut të madhëruar, i Cili përveçse na ka krijuar si njerëz, na ka falur edhe mirësi të tjera të panumërta!?

Njeriu nuk është krijuar dhe dërguar në këtë botë për shkak se e ka merituar apo se ka paguar ndonjë gjë. Përkundrazi, ai është krijuar dhe dërguar në këtë botë me "zero kapital". Gjithçka që posedon është një mirësi hyjnore.

Në fakt, Allahu mund ta krijonte edhe si gjarpër që zvarritet në tokë dhe ai nuk mund ta kundërshtonte aspak këtë fakt, sepse krijesat e tjera përveç njerëzve dhe xhinëve, nuk janë të përfshira në sprovën e kësaj bote. Për rrjedhojë, ata nuk posedojnë as vullnetin për të kundërshtuar qoftë edhe një urdhër të Allahut.

Mirëpo, edhe krijimi i kafshëve nuk është pa qëllim. Edhe ata kanë një sistem të veçantë. Ata janë manifestimi i emrave hyjnor të Allahut, "el-Bari" dhe "el-Musauuir".

Secila prej tyre është krijuar në mënyrë origjinale dhe çdonjëra ka veçoritë e veta. Ato janë të lumtura brenda llojit të vet dhe nëse ndodh të ndahen për një moment prej tyre, vrapojnë menjëherë drejt grupimit te tyre.

Ky është një manifestim i veçantë i fuqisë së Allahut të Madhëruar, me anë të së cilës çdo kafshe i ka bërë të dashur llojin e vet. Ata janë të kënaqur me gjendjen e tyre. Ky shembull i bukur e shpreh shumë qartë gjendjen e qetë dhe të dorëzuar të botës së kafshëve:

"O njeri! Që prej krijimit të botës, asnjë zog nuk është përpjekur të bëjë më shumë fole se sa fqinji i vet dhe asnjë dhelpër nuk është mërzitur se ka vetëm një vrimë ku të futet. Asnjë ketër nuk ka ngordhur prej stresit se nuk ka grumbulluar arra për dy dimra e jo për një dhe asnjë qen nuk ka i kaluar netët e tij pa gjumë se nuk ka mbledhur kocka për vitet e tij të pleqërisë."



"O njeri! Që prej krijimit të botës, asnjë zog nuk është përpjekur të bëjë më shumë fole se sa fqinji i vet dhe asnjë dhelpër nuk është mërzitur se ka vetëm një vrimë ku të futet."

Domethënë;

Të gjitha kafshët janë në paqe me atë që Allahu i Madhëruar ka caktuar për ta, sepse Allahu, çdo krijesë e ka krijuar në mënyrë që të jetë e lumtur për atë që është.

Për shembull, gjarpri është i lumtur brenda llojit të vet. Po ashtu, edhe zogjtë shumëngjyrësh janë të kënaqur prej jetës së tyre. Mbase e

vetmja pakënaqësi e tyre buron prej faktit se njeriu i shkëput ata prej natyrës ku jetojnë dhe i mbyll nëpër kafazet e kopshteve zoologjike apo cirqeve, duke i shndërruar në objekte argëtimi. E njëjta gjë vlen edhe për zogjtë që mbyllen nëpër kafaze dhe peshqit nëpër akuariume.



"O njeri! Asnjë ketër nuk ka ngordhur prej stresit se nuk ka grumbulluar arra për dy dimra e jo për një dhe asnjë qen nuk ka kaluar netët e tij pa gjumë se nuk ka mbledhur kocka për vitet e tij të pleqërisë."

Atëherë, pakënaqësia e njeriut dhe guximi për t'i kërkuar llogari Zotit të vet në mënyrë arrogante, tregojnë një indiferencë të frikshme ndaj cilësive të larta që i janë falur, një idiotësi të pamatë dhe mosmirënjohje të madhe. Një qëndrim i tillë injorant, nuk është gjë tjetër veçse asgjësim i mendjes dhe vetëdijes që i është dhënë atij.

Po ashtu, rënia në një gabim të tillë nga ana e njeriut, buron nga ngatërrimi i marrëdhënieve Krijues-krijesë me ato mes njerëzve me njëri-tjetrin.

Nuk duhet harruar se;

Allahu është "Halik", i Cili krijon nga asgjëja, ndërsa njeriu është "mahluk", i krijuar nga asgjëja.

Shpesh dëgjohen pyetje mendjelehta s: *"a mos më pyeti Allahu kur më krijoi?"* Mirëpo, Allahu i Madhëruar thotë: ***"Ti ishe asgjë, Unë të krijova!"***

E çfarë vlere ka një *"hiç"* para një *"Fuqie absolute"*?

Pastaj, sa logjike është që një Fuqi dhe Vullnet absolut e pa të meta, të pyesë diçka që nuk ekziston fare? Çfarë pyetje mund t'i bëhet asgjës?

Mbi të gjitha o njeri!

A i ke pyetur ushqimet që ke ngrënë, nëse dëshirojnë apo jo të bëhen ushqimi yt? A ke marrë aprovim prej tyre? Kë pyete kur i hëngre ato? A i ke pyetur sendet që ke përpunuar, ke prerë dhe ke copëtuar, apo kafshët të cilave u ke marrë jetën që të përfitosh prej mishit, qumështit dhe lëkurës së tyre? Po atyre luleve delikate, që ke këputur, a u ke marrë leje?

Por, përsëri Allahu i Madhëruar të pyet:

"O njeri! A dëshiron Xhenetin apo Xhehenemin?"

Ai ia ka lënë zgjedhjen në dorë vullnetit tënd. Ku dëshiron të shkosh, në Xhenet apo në Xhehenem? Pra, zgjedhja i takon njeriut. Allahu ka dërguar një libër ku të pyet:

"O njeri! A dëshiron Xhenetin apo Xhehenemin?"

Po ashtu, Ai na ka pyetur edhe me anë të profetëve:

"O njeri! A dëshiron Xhenetin apo Xhehenemin?"

E më pas urdhëron:

"Në daç ji mirënjohës, në daç mosmirënjohës!" (shih. Insan, 3.)

O indiferent dhe i paditur!

Ti nuk e sheh këtë liri zgjedhjeje që të ka dhënë Allahu i Madhëruar dhe hedh më kot fjalë injorante duke thënë: *"Nuk më pyeti kur më krijoi!"*.

Çudi;

Ti paske të drejtë të përdorësh si të duash çdo gjë në këtë botë që Allahu ta ka lënë amanet, kurse Allahu, i Cili të ka krijuar ty dhe ato, nuk paska të drejtë!?

Çfarë arrogance! Çfarë mosmirënjohje!

Mos harro se;



Njeriu nuk është krijuar dhe dërguar në këtë botë për shkak se e ka merituar apo se ka paguar ndonjë gjë. Përkundrazi, ai është krijuar dhe dërguar në këtë botë me "zero kapital". Gjithçka që posedon, është një mirësi hyjnore.

Edhe të drejtën e menaxhimit në këtë botë ta ka dhënë Allahu. Në Kur-an urdhërohet:

"Ai ka vënë në shërbimin tuaj çka gjendet në qiej dhe në Tokë, të gjitha janë prej Tij. Me të vërtetë, në këto ka shenja për njerëzit që mendojnë." (Xhathije, 13.)



Allahu mund ta krijonte njeriun edhe si një gjarpër që zvarritet në tokë dhe ai nuk mund ta kundërshtonte aspak këtë. Pra, të thuash, "pse më krijoi si njeri", është një mosmirënjohje e madhe.

Mos harro;

Allahu nuk ka nevojë për ty. Ai, me mirësinë dhe bujarinë e Tij dëshiron vetëm të të edukojë dhe në këtë mënyrë të lartësojë cilësinë tënde njerëzore. Pra, duke të bërë rob të virtytshëm, dëshiron të të mirëpresë në xhenetet e Tij. Prandaj, duhet ta lexosh vazhdimisht këtë ajet:

"O njeri, ç'të mashtroi ty që nuk i besove Zotit tënd bujar, i Cili të krijoi ty, të dha përmasa të rregullta, të harmonizoi dhe të ka mbrujtur në çfarëdo forme që ka dashur?!" (Infitar, 6-8.)

Të gjitha fjalët e tyre plot vetëmashtrim, janë vepër e injorancës dhe mungesës së urtësisë.

Nëse këto fjalë absurde do t'u drejtoheshin atyre që i thonë, a do të zgjidhnin ata mosekzistencën? Apo mos ndoshta do të dëshironin xhenetet?

Lidhur me këtë çështje, edhe ne do të bëjmë një pyetje që të fton në meditim:

Përse u dashka që Allahu t'i pyesë robërit e Tij? Një detyrim i tillë nuk ekziston as teorikisht.

Për shembull;

Personat që lëvizin në rrugë me automjete, i pranojnë rregullat e trafikut në mënyrë automatike. Po ashtu, njerëzit që lindin në një shtet të caktuar, i pranojnë automatikisht ligjet e atij vendi.

Edhe njerëzit që lindin në këtë botë, nuk mund t'i kundërshtojnë rregullat e jetës dhe duhet t'i dorëzohen atyre në mënyrë të detyrueshme. Ata nuk i japin vetes të drejtën që të kundërshtojnë ligjet fizike duke thënë: *"pse zjarri të djeg dhe i ftohti të ngrin?"*. Ato i përvetësojnë si parime të detyrueshme që duhen pranuar.

Mirëpo, kur vjen puna tek sprova, e cila është kushti shpirtëror i jetës si njeri, ata strehohen tek këto fjalë që janë filozofia e një indiference absurde.



Njeriu nuk ka për të shpëtuar nga sprova vetëm se paraqet pretendime absurde. Në Kuranin Fisnik urdhërohet: "Shiko se si gënjejnë kundër vetes, por zotat që ata i trilluan, do t'i lënë në baltë!"

(En'am, 24.)

Nuk duhet harruar se;

Njeriu struket në heshtje vetëm kur është i ditur. Vetëm kur i shtohet njohja, i shtohet edhe vetëdija për faktin se është asgjë. Ndërsa të pavetëdijshmit, mbyten në vorbullën e pyetjeve të tilla si: *"Përse Allahu i dënon me Xhehenem njerëzit të cilëve u ka vulosur zemrat?"*. Dhe këtë e deklamojnë vetëm e vetëm për të mbuluar të këqijat e tyre.

O njeri!

E përse ta vulosë Allahu zemrën e robit që ka krijuar Vetë, pa u bërë ai njeri shkak për këtë vulosje? A e hedh ndokush në plehra diçka që është ende e vlefshme? Atij që i ësh-

të vulosur zemra, pikësëpari duhet t'i shihet se çfarë ka bërë që e meritoi këtë vulosje!

Ky parim nuk duhet harruar:

Allahu posedon mëshirë dhe urtësi të pafundme. Ai nuk i bën padrejtësi robërve të Vet dhe nuk kryen veprime pa qëllim dhe pa dobi.

Për rrjedhojë;

Nëse Allahu i Madhëruar ia vulos zemrën një robi, kjo ka një shkak dhe një urtësi, edhe nëse ne nuk e dimë...



O indiferent dhe i paditur! Ti lëshon më kotë fjalë injorante duke thënë; "Nuk më pyeti kur më krijoi". Mirëpo, Allahu i Madhëruar urdhëron: "Në daç ji mirënjohës, në daç mosmirënjohës!" (shih. Insan, 3.)

Në Kuranin Fisnik, Allahu i Madhëruar na bën të ditur një pjesë të shkaqeve prej të cilave Ai "nuk i udhëzon" disa lloje njerëzish. Pra, Allahu i Madhëruar ua vulos zemrat atyre që vazhdojnë me këmbëngulje të jenë mosmirënjohës, të padrejtë, gjynahqarë dhe gënjeshtarë.[6]

Po ashtu, Allahu ka përmendur edhe cilësitë që i pëlqejnë dhe nuk i pëlqejnë Atij. Nisur nga kjo, nuk duhet të habitemi që ata të cilët këmbëngulin në ato cilësi që nuk i pëlqejnë Allahut, mund të privohen nga udhëzimi dhe, padyshim që nuk duhet ta shohim këtë as si padrejtësi që u bëhet atyre.

Siç shihet, të gjitha pyetjet që kanë ardhur deri tani, përpiqen të vënë në dyshim sprovën, që është edhe shkaku i ekzistencës sonë, duke u munduar të gjejnë një gabim logjik në të. Mirëpo, e vërteta është në shesh. S'ka nevojë për rrugë

6. shih. el-Bekare, 258, 264; Al-i Imran, 86; el-Maide, 51, 67; el-En'am, 144; et-Teube, 19, 24, 37, 80, 109; en-Nahl, 107; el-Kasas, 50; ez-Zumer, 3; el-Gafir, 28, el-Ahkaf, 10; es-Saff, 5, 7; el-Xhuma, 5; el-Munafikun, 6.

të tërthorta. Mbi të gjitha, njeriu nuk mund të shpëtojë nga sprova duke nxjerrë pretendime të tilla.

Në Kuranin Fisnik urdhërohet:


"Shiko se si gënjejnë kundër vetes, por zotat që ata i trilluan, do t'i lënë në baltë!" (En'am, 24.)

Ndërsa dikush tjetër arrin deri aty sa të mendojë pyetje të kota si:

"Përderisa do të ringjallemi pas vdekjes, atëherë përse vdesim?"

VDEKJA, DERA E BOTËS TJETËR

Vdekja është një instrument që ka dy funksione në sprovën e njeriut. Ata që nuk i besojnë Allahut dhe botës tjetër, pandehin se vdekja është fund.



Ata që mohojnë ringjalljen, marrin në duar kocka të kalbura dhe bëjnë pyetje tallëse si:

"E kush do ta ringjallë këtë?"

Por ata nuk mendojnë se:

"Atë do ta ringjallë Ai që e ka krijuar për herë të parë!" (shih. Jasin, 78-79.)

Kurse ata që besojnë janë të vetëdijshëm se vdekja është vetëm një derë për në jetën e vërtetë të botës tjetër. Ata meditojnë rreth vdekjes dhe nuk bien në kurthet mashtruese të kësaj jete të përkohshme, sepse këtë botë e konsiderojnë vetëm një stacion dhe nuk hutohen.

Për shkak se vdekja është një lloj deklarate e përkohshmërisë, ajo duhet konsideruar një mirësi ashtu si jeta. Në suren Mulk urdhërohet:

"Ai i ka krijuar jetën dhe vdekjen, për t'ju provuar se kush prej jush do të veprojë më mirë; Ai është i Plotfuqishmi dhe Falësi i madh."
(Mulk, 2.)

Ndërsa Rumiu thotë:

"Biri im! Vdekja e gjithsecilit është në ngjyrën e tij. Atyre që e urrejnë vdekjen dhe janë armiq të saj, për shkak se nuk mendojnë që vdekja është takim me Allahun, ajo ka për t'iu dukur një armik i frikshëm. Ndërsa atyre që janë miqësuar me të, ajo iu shfaqet si mik."



Në Kuranin Fisnik, Allahu i Madhëruar na bën të ditur një pjesë të shkaqeve se përse Ai "nuk i udhëzon" disa lloje njerëzish. Pra, Allahu i Madhëruar ua vulos zemrat atyre që vazhdojnë me këmbëngulje të jenë mosmirënjohës, të padrejtë, gjynahqarë dhe gënjeshtarë.

"O shpirt që frikësohesh dhe ikën nga vdekja! Nëse dëshiron të dish se si është puna dhe cila është e vërteta, dije se në të vërtetë ti nuk ke frikë nga vdekja, ti ke frikë nga vetja (gjynahet e tua)!"

"Sepse ajo që sheh në pasqyrën e vdekjes dhe frikësohesh, nuk është çehrja e vdekjes, por fytyra e shëmtuar e botës tënde të brendshme.

Shpirti yt i ngjan një peme, e vdekja gjethes së saj..."

Nëse në këtë sprovë nuk do të ekzistonte vdekja dhe nëse të gjithë do të jetonin deri në kiamet, sprova do të ishte edhe më e rëndë. E në fakt, plakja dhe fillimi i dobësisë trupore pas moshës së mesme, është një shenjë që tregon se kjo botë është e përkohshme dhe se jeta e vërtetë është ajo e botës tjetër.

Padyshim, për atë që sheh dhe kupton...

Në suren Jasin urdhërohet:

"Kujtdo, që i japim jetë të gjatë, Ne e bëjmë sërish krijesë të dobët. Vallë, a nuk kuptojnë ata?" (Jasin, 68)

Vdekja ekziston me qëllim që njeriu të kuptojë dobësinë e vet. Në suren Uakia, Allahu i Madhëruar i drejtohet kështu njerëzve të cilët qëndrojnë tek koka e një të vdekuri:

"Atëherë, përse kur (dikujt) **i vjen** (shpirti) **në grykë para syve tuaj, - ndërkohë që Ne jemi më afër atij se ju, por ju nuk e vini re- përse pra, nëse nuk do të gjykoheni** (në jetën e përtejme)**, ju nuk ia ktheni shpirtin atij? Përgjigjuni kësaj, nëse thoni të vërtetën!"** (Uakia, 83-87)



"Biri im! Vdekja e gjithsecilit është në ngjyrën e tij. Atyre që e urrejnë vdekjen dhe janë armiq të saj, sepse nuk mendojnë se vdekja është takim me Allahun, ajo ka për t'iu dukur një armik i frikshëm. Ndërsa atyre që janë miqësuar me të, iu shfaqet si mik."

Vdekja ekziston që njeriu të kuptojë mirë se jeta e përjetshme pas ringjalljes do të realizohet me vullnetin e Allahut të Madhëruar. Nëse nuk do të ekzistonte vdekja, njerëzit do të mendonin se "janë të përjetshëm".

Për rrjedhojë, njeriu duhet t'u përgjigjet këtyre pyetjeve;

Përse vijmë në këtë botë e ku do të shkojmë më pas?

- Në pronën e kujt jetojmë?
- Kush na furnizon?
- Për ku udhëtojmë?

Këto lloj meditimesh bëhen shkak që njeriu të kuptojë se kjo botë është një shkollë dhe vend sprove.

BARAZIA TJETËR GJË, DREJTËSIA TJETËR GJË!



"O shpirt që frikësohesh dhe ikën nga vdekja! Nëse dëshiron të dish se si është puna dhe cila është e vërteta, dije se në të vërtetë ti nuk ke frikë nga vdekja, ti ke frikë nga vetja (gjynahet e tua)."

Pyetje: *"Ne i besojmë Allahut sepse kemi lindur në familje myslimane. Po ata që kanë lindur në familje jobesimtarësh, çfarë faji kanë?"*

Pyetje: *"Përse Allahu, një robi i jep vështirësi, e një tjetri rehati? Përse Allahu nuk vepron me barazi në këtë çështje?"*

Për shkak se këto dy pyetje kanë të bëjnë me misterin e kaderit, do t'u përgjigjemi të dyjave përnjëherësh.

Në përgjithësi, njerëzit e nga-tërrojnë barazinë me drejtësinë. E në fakt, barazia jo gjithmonë është drejtësi.

Nëse do të flasim për barazinë, duhet dimë se Allahu i Madhëruar, robërve të tij i ka falur mendje dhe mundësi për të kuptuar në nivele të ndryshme. Për rrjedhojë, nëse ne i gjykojmë dhe i krahasojmë njerëzit të gjithë në mënyrë të barabartë, pavarësisht kushteve dhe niveleve të ndryshme që kanë, kjo do ishte padrejtësi.

Gjykimi dhe kërkimi i llogarisë nga ana e Allahut, do të jetë i veçantë për çdo individ. Prandaj, për të eliminuar frikën e njerëzve lidhur me këtë çështje, Allahu i Madhëruar urdhëron:

"Allahu nuk e ngarkon askënd përtej fuqisë që ka!.."

(Bekare, 286)

Të gjithë i nënshtrohen sprovës në bazë të kushteve në të cilat ndodhen. Përveç kësaj, Allahu i Madhëruar, të gjitha

vështirësitë, fatkeqësitë dhe problemet në jetën e njeriut, i ka bërë shkaqe për të fituar shpërblime.

Për shembull, njerëzit që janë të verbër në këtë botë, nëse bëjnë durim, kur të shohin mirësitë që do t'u falen në botën tjetër, do të falënderojnë për faktin se kanë qenë të verbër në dynja.

Allahu nuk u bën padrejtësi robërve të Tij. Lidhur me këtë në Kuranin Fisnik urdhërohet:

إِنَّ اللَّهَ لَا يَظْلِمُ مِثْقَالَ ذَرَّةٍ

"Vërtet, Allahu nuk bën padrejtësi asnjë grimë..." (Nisa, 40)

Ja pra, Islami kërkon të besohet në këto parime. Besimtari nuk dyshon kurrë në mëshirën e Allahut dhe nuk mendon aspak se Ai do t'i bëjë padrejtësi.

Disa persona, me qëllim që të mbrojnë pretendimet e tyre se Islami nuk është feja e vërtetë, abuzojnë me mendësinë e pyetjeve të mësipërme dhe thonë:

"Të gjithë besojnë në fenë e prindërve ose të shoqërisë ku jetojnë. Pra, nuk ekziston një fe e vërtetë në mënyrë absolute. Besimi është relativ. Të gjithë kanë të drejtë sipas mënyrës së tyre..."

Por kjo qasje nuk është e drejtë. Islami filloi në një zonë ku prej shekujsh nuk ka pasur shpallje dhe vendasit thoshin: *"ne nuk e braktisim fenë e baballarëve tanë!"* Ky ishte fanatizmi me të cilin luftoi edhe Profeti ﷺ.

Sprova e çdo njeriu zhvillohet



"Kujtdo, që i japim jetë të gjatë, Ne e bëjmë sërish krijesë të dobët. Vallë, a nuk kuptojnë ata?"

(Jasin, 68.)



"Ai i ka krijuar jetën dhe vdekjen, për t'ju provuar se kush prej jush do të veprojë më mirë; Ai është i Plotfuqishmi dhe Falësi i madh."

(Mulk, 2.)

brenda tij në mënyrë të veçantë. Për rrjedhojë, shumë njerëz të rritur dhe të edukuar në ambiente fetare, për fat të keq, ose e humbin besimin, ose zhyten në gjynahe, ndërkohë që disa të tjerë, të rritur dhe edukuar shumë larg ambienteve dhe vendeve Islame, arrijnë të gjejnë udhëzimin në rrugën e drejtë.

Çështja e besimit, është një mister hyjnor.

Për rrjedhojë, ndërkohë që Ebu Talibi ishte mbrojtës i Profetit ﷺ për vite me radhë, atij nuk iu bë kësmet besimi i vërtetë. Mirëpo, Hindi, e cila urdhëroi martirizimin e xhaxhait të dashur të Profetit ﷺ, Hamzait رضي الله عنه, dhe prej urrejtjes ndaj tij arriti deri aty sa t'i kafshonte edhe mëlçinë, u udhëzua në fenë e vërtetë. Ne nuk e njohim aspak urtësinë e këtyre udhëzimeve, sepse mendja jonë është tejet e kufizuar.

Ne nuk e dimë shkakun e fshehtë që Ebu Talibi nuk u udhëzua, por dimë se ai ka thënë hapur :

"O nipi im! Nëse të besoj ty, më përçmojnë gratë Kurejshe..." (shih. Uahidî, Esbabu Nuzuli'l-Kur'an, fq. 268 [et-Teube, 113])

Pra, ai preferoi më mirë të mos përçmohej nga gratë Kurejshe, se sa të besonte të Dërguarin e Allahut, ﷺ.

Po ashtu, në suren Kehf, tregohet ndodhia e Musait عليه السلام me Hidrin عليه السلام, ku Musai عليه السلام nuk arriti ta zgjidhte me mendjen e tij urtësinë për tre çështje që i tregoi Hidri عليه السلام. Mirëpo, kur ai e mësoi të vërtetën prej Hidrit عليه السلام, u qetësua plotësisht.

Nga ana tjetër, dijetarë te kelamit, e kanë konsideruar të

domosdoshme që dikush, të cilit nuk i ka arritur asnjë shpallje hyjnore, duhet ta kuptojë vetë ekzistencën dhe njëshmërinë e Allahut duke parë manifestimet e pafundme të madhështisë dhe urtësisë së Tij në univers.

Nuk duhet harruar se;

Edhe mëshira, edhe zemërimi i Allahut, mund të shkaktohen nga diçka shumë e vogël. Kuptimi i urtësisë së kësaj e tejkalon mendjen tonë.

Një tjetër pyetje absurde është edhe kjo:

"Koncepti i pafundësisë është përtej mendjes njerëzore dhe unë nuk arrij ta kuptoj faktin e pafundësisë së Allahut!"

Allahu i Madhëruar na ka dhënë aftësinë të kuptojmë aq sa na duhet për të pasur një besim të shëndoshë dhe nuk na merr në llogari për atë që nuk na e ka kërkuar.



Në përgjithësi, njerëzit e ngatërrojnë barazinë me drejtësinë. E në fakt, barazia jo gjithmonë është drejtësi. Ndërsa fakti që njerëzit vijnë në këtë botë në kushte të ndryshme si domosdoshmëri e caktimit hyjnor, nuk është padrejtësi.

A MUND TA NXËRË OQEANIN NJË GOTË?

Ne mund të mos kuptojmë jo vetëm pafundësinë, por edhe shumë gjëra të tjera në këtë univers. Ne nuk zotërojmë fjalë as për të shqiptuar numrat në lidhje me botën makro... Po ashtu, edhe në botën mikro mendja jonë mbetet e paaftë.

Por, nuk mund të themi se "nuk ekziston", për atë që nuk e kuptojmë. Shumë mendje njerëzore nuk arrijnë t'i kuptojnë shumë probleme matematikore. E megjithatë, ai problem nuk avullon për shkak se ata nuk

kuptojnë. Jemi të dobët! Prandaj, le të jemi të vetëdijshëm edhe për faktin se jemi "asgjë" para Zotit tonë.

Përveç këtyre;

Për shkak se feja jonë përfshin gjithë botën dhe synon çdo mendjen njerëzore, qoftë e dobët apo e fortë, ajo nuk na ka ngarkuar me detyra të thella teorike që vështirësojnë mendjen tonë. Detyrat tona të besimit dhe adhurimit janë aq të lehta dhe të natyrshme saqë mund të realizohen nga të gjithë, nëse u qasen atyre të dorëzuar. Në fakt, Allahu nuk e ka urdhëruar meditimin në lidhje me "individualitetin" e Tij. Lidhur me këtë, në një hadith fisnik thuhet:



Gjykimi dhe kërkimi i llogarisë nga ana e Allahut, do të jetë i veçantë për çdo individ. Prandaj, për të eliminuar frikën e njerëzve lidhur me këtë çështje, Allahu i Madhëruar urdhëron:

"Allahu nuk e ngarkon askënd përtej fuqisë që ka!.." (Bekare, 286)

"Mendoni mbi krijesat e Allahut (pra, meditoni ekzistencën dhe madhështinë e Allahut duke parë manifestimet e cilësive të Tij) dhe jo mbi Individualitetin e Tij, sepse ju kurrë nuk mund ta përcaktoni (denjësisht) vlerën e Tij!" (Dejlemi, Musned, II, 56; Hejthemi, Mexhmau'z-Zevaid, I, 81)

Ne meditojmë mbi atributet e Zotit tonë, manifestimet e madhështisë dhe fuqisë së pafundme të Tij, gjë e cila bëhet çelës i besimit tonë.

A është e mundur ta fusësh oqeanin në një gotë? Kur të mbushet, do të fillojë të derdhet. Për shembull, një nxënësi të shkollës fillore, nuk i jepen librat e universitetit!? Për rrjedhojë, edhe tentativa e robit për ta kuptuar plotësisht Allahun, është edhe më e pamundur se kjo. Një qenie e kufizuar, nuk mund ta kuptojë plotësisht një qenie të pakufishme.

Në Kuranin Fisnik urdhërohet:

"Sikur të gjithë drurët që gjenden në Tokë të ishin lapsa, e deti bojë shkrimi, e t'i shtohen atij edhe shtatë dete të tjera, fjalët e Allahut nuk do të shtereshin. Pa dyshim, Allahu është i Plotfuqishmi dhe i Urti." (Lukman, 27.)

Pyetje: *"Si mund ta zgjasë jetën sadakaja, ndërkohë që koha e vdekjes sonë është e caktuar?"*

Përcaktimi nga ana e Allahut të Madhëruar, të çdo dukurie në këtë botë, quhet *"kader"*. Për shkak se nuk mund ta perceptojmë dot Allahun, ne nuk duhet t'i qasemi "dijes" së Tij me njësi matëse që vlejnë vetëm për ne, si "më herët apo më vonë"...

Për shembull:



Dijetarë te kelamit, e kanë konsideruar të domosdoshme që dikush, të cilit nuk i ka arritur asnjë shpallje hyjnore dhe nuk e ka dëgjuar zërin e profetit, duhet ta vërtetojë ekzistencën e dhe njëshmërinë e Allahut duke parë manifestimet e pafundme të madhështisë dhe urtësisë së Tij në univers.

Kaderi ynë është i caktuar, por ne kryejmë adhurime; kaderi ynë dihet, por ne lutemi dhe japim sadaka, sepse ne vet nuk njohim asgjë prej kaderit tonë.

Allahu i Madhëruar, i Cili di me përpikëri çdo gjë, e di shumë mirë edhe se ne do të lutemi dhe do të japim sadaka. Nëse Allahu i Madhëruar nuk do ta njihte kaderin tonë, vendimet, veprimet dhe sjelljet që ne realizojmë me vullnetin tonë të pjesshëm, kjo do të ishte një "mangësi" për Të, i Cili është i pastër dhe larg çdo mangësie. Mosnjohja e të fshehtës/të ardhmes, vlen vetëm për krijesat e Allahut, ku bën pjesë edhe njeriu. Ndërsa Vetë Allahu është i pastër nga kjo e metë.

Debatet lidhur me kaderin, nuk i bëjnë dobi askujt. Gjatë historisë, si rezultat i këtyre debateve, shumë njerëz kanë arritur deri aty sa të mohojnë ose kaderin, ose vullnetin. Mirëpo, të dyja këto përfundime janë shumë larg prej së vërtetës.



Edhe mëshira, edhe zemërimi i Allahut mund të shkaktohet nga diçka shumë e vogël. Kuptimi i urtësisë së kësaj, e tejkalon mendjen tonë. Robit i takon të strehohet tek Ai.

Ne duhet të shqetësohemi më tepër për pyetjet që do të na bëhen neve, sepse ditën e ringjalljes ne nuk do të pyetemi: *"a e zgjidhe apo jo çështjen e kaderit?"*, por:

- *"Ku e shpenzove jetën?"*

- *"Çfarë bëre me dijen që zotëroje?"*

- *"Ku e fitove dhe si e shpenzove pasurinë?"*

- *"Ku e mplake trupin?"*

Po ashtu, edhe kjo pyetje tregojnë injorancë dhe mungesë të meditimit mbi fuqinë hyjnore:

"Përse na sprovon Allahun ndërkohë që Ai nuk ka nevojë për këtë?"

Vërtet që Allahu i Madhëruar nuk ka nevojë për asgjë, sepse nevoja vlen për qeniet e dobëta. Mirëpo, nevojtarët jemi ne.

Ne kishim nevojë që Allahu të na krijonte për të ekzistuar. E Ai na krijoi.

Ne kishim nevojë për mirësinë e jetës, mendjes dhe shëndetit. E Ai na i dha.

Ndërsa tani, ne nuk kënaqemi me jetën tonë të përkohshme, por duam jetë të përjetshme, pra, Xhenetin. Por, edhe

mënyrën për ta arritur atë, Allahu na e ka treguar duke na falur udhëzuesin e Tij.

Pra, si mund të pyesim ne: *"përse na sprovon?"*

Përkundrazi, ne duhet të falënderojmë për shkak se gjithë ato mirësi na i ka dhënë falas. Po ashtu, Ai na thotë:

"Kryeji edhe këto detyra të lehtësuara të devotshmërisë në këtë jetë të përkohshme, me qëllim që Unë të të jap edhe Xhenetin e përjetshëm!"

Mirëpo, ne kthehemi e themi:

"Përse nuk na i jep falas edhe këto?"

E në fakt, një mendim i tillë nuk ka aspak dobi!

***Pyetje:** "Nëse në Xhenet dua dikë, por ai do dikë tjetër, si do të bëhet?"*

Fakti që në Xhenet do të bëhet ajo që dëshirojmë, do të jetë në përputhje me dëshirat e banorëve të tjerë të Xhenetit. Nëse me të vërtetë kemi arritur kënaqësinë e Allahut, edhe personi që duam do të na dojë neve. Por, nëse ai nuk na meriton, dashuria për të mund të fshihet prej zemrës sonë.

Këto lloj mendimesh, nuk kanë asnjë vlerë në krahasim me gjendjen e tmerrshme në ditën e gjykimit.

Neve na është dhënë lajmi i mirë se bashkëshortët, fëmijët dhe prindërit e mirë e të devotshëm, do të jenë bashkë në Xhenet. (shih. Ra'd, 23; Gafir, 8.)

Në Kuranin Fisnik, na tregohen



"Sikur të gjithë drurët, që gjenden në Tokë, të ishin pena e deti bojë shkrimi e t'i shtohen atij edhe shtatë dete të tjera, nuk do të shtereshin fjalët e Allahut. Pa dyshim, Allahu është i Plotfuqishmi dhe i Urti."

(Lukman, 27.)



Ditën e ringjalljes, nuk do të pyetemi; "a e zgjidhe çështjen e kaderit?", por; "Ku e shpenzove jetën?", "Çfarë bëre me dijen që zotëroje?", "Ku e fitove dhe si e shpenzove pasurinë?", "Ku e mplake trupin?"

këto skena që do të përjetohen ditën e kiametit:

Njerëzit që kanë qenë të devotshëm ndaj Allahut dhe do të shkojnë në Xhenet, do të priten me një ceremoni të madhe dhe fjalë shumë miqësore:

سَلَامٌ قَوْلًا مِنْ رَبٍّ رَحِيمٍ

"«Paqe!» do të jetë fjala prej një Zoti Mëshirëplotë." (Jasin, 58.)

Mirëpo, atyre që kanë jetuar në këtë botë në kundërshtim me urdhrat e Allahut, edhe pse mund të jenë më të afërmit e të devotshmëve, do t'u thuhet:

وَامْتَازُوا الْيَوْمَ أَيُّهَا الْمُجْرِمُونَ

"(Ndërsa keqbërësve Ai do t'u thotë): **"Veçohuni sot ju, o kriminelë!"** (Jasin, 59.)

Kjo do të jetë edhe ndarja më e hidhur. Prandaj, për të mos e shijuar ndarjen e përjetshme, ne duhet të ruajmë edhe veten, edhe të dashurit tanë nga zjarri... Për këtë arsye, një nga detyrat tona më të rëndësishme, është t'i lëmë fëmijëve tanë si trashëgim një personalitet dhe karakter Islam.

Një tjetër pyetje që buron prej paditurisë së fesë, është edhe kjo:

"Ne i kritikojmë idhujtarët, por edhe ne rrotullohemi rreth Qabes!"


Qabeja është një simbol!

QABEJA, PIKA E DREJTIMIT

Zoti ynë ka krijuar disa simbole. Për rrjedhojë, vendet si Qabeja, Haxheru'l-Esued, kodrat Safa dhe Merve, Arafati dhe Muzdelifja ku bëhen ndalesa gjatë haxhit dhe Bejt-i Makdis (Xhamia Aksa), e cila ka qenë kibla jonë e parë dhe vendi ku ka ndodhur miraxhi i Profetit ﷺ, janë vende të shenjta të cilat Allahu i Madhëruar i ka caktuar si simbole.

Respekti ndaj këtyre vendeve, është tregues i devotshmërisë. Ndërsa shenjtëritë e shpikura nga njerëzit, janë të ndaluara në Islam. E drejta për të vendosur rregullat e fesë, i takon vetëm Allahut të Madhëruar. Për rrjedhojë, edhe e drejta për të caktuar kible (drejtim), vend dhe praktika për adhurim, i takon vetëm Atij.

Për hir të egove të tyre, kapitalistët shkatërruan vende të ndryshme, si Siria, Palestina, Egjipti, Jemeni, Iraku, e shumë të tjerë. Çdonjëri prej këtyre vendeve është në zi dhe fatkeqësi. Mirëpo, ashtu siç ka ndodhur gjatë gjithë historisë, edhe sot e kësaj dite, kapitalistët veprojnë gjithmonë si të verbër, të shurdhër dhe pa ndjenja ndaj të vuajturve, të dobtëve dhe të papërkrahurve. Ata nuk i dëgjuan dhe nuk deshën t'i dëgjojnë kurrë rënkimet e tyre me zë e pa zë, që thërrasin: "Mëshirë!".



Përse kapitalistët, të cilët premtuan paqe, për hir të parasë thonë, "lërini të veprojnë, lërini të kalojnë", duke konsideruar të lejuar çdolloj paturpësie dhe duke pasuruar korporatat gjakpirëse?

Allahu i Madhëruar, duke iu drejtuar melekëve, urdhëroi:

"Bëni sexhde Ademit!"

Melekët e zbatuan këtë urdhër, përveç Iblisit, i cili kundërshtoi.

Sexhdeja të cilën Allahu urdhëroi t'i bëhej Ademit عليه السلام, nuk ishte sexhde adhurimi, por sexhde nderimi ndaj krijesës së Tij. E për rrjedhojë, një sexhde ndaj Vetë Allahut të Madhëruar. E njëjta gjë vlen edhe për rastin e Qabes. Ajo përfaqëson pikën ku drejtohen sexhdet që bëhen ndaj Allahut. Uniteti në një kibël (drejtim), eliminon ndarjet dhe i bashkon besimtarët në një pikë të vetme.

Sa tablo e bukur e unitetit është gjendja e mrekullueshme e një xhemati që fal bashkë namazin në Qabe!

Në fenë tonë, çdo gjë mbështetet në parimet e Kuranit dhe Sunetit, të cilat janë pjesë e argumenteve fetare. Ndërsa në lidhje me adhurimet nuk mund të bëhen krahasime, sepse ato janë të caktuara nga Vetë Allahu. Për këtë arsye, Qabeja nuk është si idhujt. Ajo është ndërtuar nga Ibrahimi عليه السلام, me urdhër të Allahut.



A ka ndonjë sistem tjetër përveç Islamit, që arrin të sigurojë një transferim të konsiderueshëm të pasurisë nga i pasuri tek i varfri, si zekat, dhurim, sadaka, fitre, vakëf, shpagim dhe përgjegjësi të tjera fetare të ngjashme, duke e bërë këtë me dashuri për adhurimin, e jo me dhunë?

Për ta kuptuar më mirë këtë çështje, është me vend të tregojmë këtë ndodhi shumë kuptimplote:

Omeri رضي الله عنه e puthi Haxheru'l-Esuedin (Gurin e Zi) dhe tha:

"Unë e di shumë mirë se ti je vetëm një copë guri pa dobi, e pa dëm... Mirëpo, unë po të puth vetëm se të ka puthur i Dërguari i Allahut!"

Është rregull fikhu se: Nëse Qabja rrëshqet nga vendi ku ndodhet aktualisht, shenjtëria e asaj ndërtese që është larguar nga vendi i saj, humbet. Kjo, sepse shenjtëria i takon vendit, dhe jo gurëve e mureve. E në fakt, gjatë gjithë historisë, Qabja është rrënuar dhe rindërtuar disa herë.

Pyetje: *"Po sikur të krishterët dhe ateistët të kenë të drejtë?"*

S'ka asnjë mundësi që ata të kenë të drejtë, sepse çdo gjë duket qartë. Më herët e kemi sqaruar se si krishterimi ka marrë formën e një feje të shpikur nga mendja e njeriut. Po ashtu, e kemi sqaruar edhe se çfarë verbërie dhe absurditeti është ateizmi. Për rrjedhojë, një mendim i tillë, është i pavend.

Një herë, një femohues i thotë Aliut ﷺ:

"Ju lodheni kot në këtë botë. Po sikur të mos ketë as Xhenet, e as Xhehenem?"

Aliu ﷺ i përgjigjet:

"Nëse ajo që thua ti është e vërtetë, unë nuk do të humb asgjë. (e në fakt, urdhrat e fesë Islame janë domosdoshmëri për të qenë njerëz të mirë) Mirëpo, nëse ajo që them unë është e vërtetë dhe Xheneti ekziston, a e dini ju se çfarë do të humbisni? Po sikur edhe Xhehnemi të jetë i vërtetë, -e në fakt është-, a e dini se ku do të shkoni?"

Komunistët erdhën me premtimin për barazi dhe e ngritën pushtetin e tyre mbi miliona jetë. Por më pas pasuruan vetëm një grusht partiakësh. A ka mbetur tek njerëzit sadopak shpresë tek kapitalizmi dhe komunizmi?

Feja duhet të përfshijë çdo fushë



Ku është bollëku, paqja dhe lumturia që premtuan kapitalistët? Mirëqenie, rehat dhe pasuri vetëm për një grusht njerëzish, ndërsa të tjerët le t'i zemërohen fatit! Kështu? Ah ndërgjegje të kthyera në ngjyrë katrani!

të jetës dhe duhet t'i përgjigjet të gjitha pyetjeve të një njeriu. Por të gjitha fetë njerëzore janë të mangëta në këto çështje. Ato kanë cekur vetëm disa fusha të caktuara të jetës, por edhe aty nuk janë fort të suksesshme.

Një fe që mund t'i përgjigjet të gjitha pyetjeve, mund të vijë vetëm prej Allahut të Madhëruar. Dhe kjo fe është Islami. Në Kuranin Fisnik urdhërohet:

"Feja e vërtetë tek Allahu është vetëm Islami!.." (Al-i Imran, 19.)



Komunistët erdhën me premtimin për barazi dhe e ngritën pushtetin e tyre mbi miliona jetë. Por më pas pasuruan vetëm një grusht partiakësh. A ka mbetur tek njerëzit sadopak shpresë tek kapitalizmi dhe komunizmi?

A ËSHTË E MUNDUR QË LIGJET FIZIKE TË KËRCËNOJNË ATË QË I KA KRIJUAR?

Pyetje: *"Ne kemi mësuar se ekzistojnë mrekulli, por nuk kemi asnjë argument të tyre. Ato janë vetëm tregime dhe për mendimin tim nuk ekziston asnjë provë!"*

Atyre që kanë të tilla kundërshtime, u themi se edhe një pjesë e njerëzve që ishin dëshmitarë okularë të atyre mrekullive, nuk besuan. Ata thanë se këto janë vetëm "magji, iluzione dhe mashtrime".

Shkaku që disa njerëz e kanë të vështirë të pranojnë mrekullinë, është se mendja e tyre i pranon si absolute dhe të detyrueshme ligjet me të cilat funksion universi. Mirëpo, nëse do të mendonin pak, do të kuptonin se edhe ato ligje i ka vendosur Vetë Allahu i Madhëruar. Për rrjedhojë, ligjet

që ka vendosur Ai, nuk mund ta kufizojnë fuqinë e Tij të pakufishme.

Përveç kësaj, njeriu duhet të dijë se, njerëzimi nuk ka arritur t'i kuptojë të gjitha ato ligje dhe nuk i njeh përjashtimet.

Për shembull, një person që nuk e ka njohur më parë magnetin, e ka të vështirë të pranojë se një material në formë guri mund të tërheqë disa metale. Mirëpo, kur e sheh dhe e mëson, atëherë nuk habitet më. Nëse Allahu ka vendosur ligje të tjera, në saje të të cilave krijon mrekulli, ne mbase nuk mund t'i kuptojmë ato. Por, nuk është e drejtë as t'i mohojmë ato.

Sot, në filmat fantastiko-shkencorë shohim të hapen dritare mes dy dimensioneve, shohim njerëz dhe sende që teletransportohen në vende të largëta, shohim se bëhen udhëtime në kohë, etj... Mendja nuk e ka të vështirë t'i pranojë këto. Madje, shumë njerëz thonë se "vërtet sot nuk e kemi arritur këtë teknologji, por në të ardhmen mund të bëhet realitet".



Nëse ata i binden urdhrit të namazit, njoftoji se Allahu u ka bërë obligim të shpërndajnë zekatin, ku të pasurit japin nga pasuria e tyre për të varfrit.

Por, përse të njëjtët njerëz, të mos e pranojnë se Zoti i botëve, Allahu që ka krijuar dhe është i plotfuqishëm për çdo gjë, të mund të krijojë menjëherë edhe shkaqet për çdo gjë që dëshiron të bëjë?

Më herët, njerëzit nuk i njihnin fare rrezet "beta", "gama" dhe "alfa". Por sot, ata i kanë mësuar ato. E Allahu i Madhëruar na ka bërë të ditur se njeriut i është dhënë shumë pak dije.[7]

7. shih. Isra, 85.



Deist, kapitalist, shekullarist... A të duket e ndritur e ardhmja e sistemit të kësaj bote? Ja ku është Mjanmari, Siria, Jemeni!.. Vepra e kujt është?

Në sajë të kësaj diturie të pakët, njeriu ka mundur t'i realizojë këto zbulime hap pas hapi për mijëra vite me mund dhe përpjekje të madhe.

Pra, a i beson teknikave që njeriu ka zhvilluar hap pas hapi, e nuk arrin ta pranosh fuqinë e pafundme të Allahut?

Ndërkohë, disa dijetarë kanë thënë se mrekullitë ia hapin horizontin njeriut në çështjen e dijes dhe shkencës.

Për rrjedhojë;

Në saje të mrekullisë, Ibrahimi عليه السلام nuk u dogj nga zjarri në të cilin e hodhën. Ndërsa sot, njerëzit kanë zhvilluar rroba, bojëra dhe materiale të tjera që nuk digjen nga zjarri.

Isai عليه السلام, në saje të mrekullisë ringjalli të vdekurit, shëroi sëmundje që nuk u dihej kura dhe u dha shikimin të verbërve të lindur. Ndërsa sot, zemra mund të rivihet në punë me anë të elektroshokut dhe në saje të ndërhyrjeve kirurgjikale dhe kurave, që nuk njiheshin më parë, mund të shërohen shumë sëmundje.

Sulejmani عليه السلام, me anë të erës, në një ditë përshkonte distanca që mund të bëheshin vetëm për një muaj duke ecur. Ndërsa sot, njerëzimi mund të shkojë nga një cep i botës në tjetrin brenda një dite.

Këto fakte mjaftojnë për të na ndihmuar të kuptojmë se mrekullitë ekzistojnë, sepse edhe njeriu, në saje të përpjekjeve të njëpasnjëshme, mund ta zhvillojë veten dhe atë që nuk ka

mundur ta bëjë dje, mund ta bëjë sot. Për rrjedhojë, përse duhet të habitemi me mrekullitë e Allahut të Madhëruar, i Cili posedon fuqinë absolute?

Aborti; sipas shumë sistemeve të paskrupullta dhe të bazuara thjesht në mendje, është i lejuar! Madje, është e drejtë dhe liri themelore!.. Një moral që buron prej mendjes që e konsideron të drejtë vrasjen?!.

Pyetje: *"Përse Allahu e ka lejuar prishjen e librave të mëparshëm?"*

Allahu i Madhëruar ka premtuar se do ta mbrojë Kuranin deri në kiamet, sepse pas tij nuk do të zbritet asnjë libër tjetër. Ndërsa më herët, vazhdimisht janë dërguar profetë dhe janë zbritur shpallje. Kjo, për shkak se nevojat e njerëzve dhe strukturat e popujve ndryshonin vazhdimisht. Të gjithë profetët kanë pasur të njëjtat parime të besimit, pavarësisht se janë dërguar me ligje dhe urdhra sipas veçorive të popullit ku kanë ushtruar detyrën.



Nëse e jetojmë Islamin me dinamizëm, sinqeritet, devotshmëri, dashuri dhe pasion, me lejen e Allahut, do të bëhet e mundur që pishtari i dashurisë për fenë, të ndizet edhe në zemrat e fëmijëve, nxënësve dhe atyre që na rrethojnë.

Pyetje: *"Ndërkohë që në fillim pija alkoolike është ndaluar dalëngadalë me etapa, përse neve na është bërë direkt haram?"*

Zbatimi i gradualitetit është realizuar gjatë zbritjes së shpalljes. Në fund, feja u plotësua. E sigurisht që pas plotësimit, s'mund të kthehesh më pas, sepse do të ishte një sjellje arbitrare.

Mirëpo pavarësisht kësaj, në fushën e edukimit ky gradualitet vazhdon të jetë një parim. Për shem-



A mund ta lejosh vrasjen e një fëmije (në bark të nënës) të cilit i rreh zemra, vetëm se nëna nuk e do? A mund ta pranojë ndërgjegjja jote këtë krim? Islami nuk e lejon, por mendja moderne po!.. A do ta pranoje këtë, nëse ai fëmijë do të ishe ti?

bull, gjatë predikimit të fesë tek një individ apo shoqëri e cila sapo është njohur me Islamin, natyrisht duhet bërë kujdes në radhitjen e çështjeve. Mirëpo, kjo nuk e eliminon ligjin hyjnor. Ky është vetëm një zbatim që buron prej urtësisë dhe largpamësisë së myslimanit.

Kur Profeti ﷺ po e përcillte Muadhin رضي الله عنه në Jemen, i tha:

"Ti po shkon tek një popull i cili është ithtar i librave të mëparshëm dhe do ta ftosh atë të besojë se nuk ka Zot tjetër përveç Allahut dhe se unë jam i Dërguari i Tij.

Nëse i përgjigjen pozitivisht ftesës tënde, informoji ata se Allahu ua ka bërë farz të falin pesë namaze në një ditë-natë.

Nëse ata i binden urdhrit të namazit, njoftoji se Allahu u ka bërë obligim të shpërndajnë zekatin, ku të pasurit japin nga pasuria e tyre për të varfrit.

Nëse i binden edhe këtij urdhri, bëj kujdes të mos marrësh prej tyre pasurinë më të veçantë dhe më të vlefshme për ta! (Pra mos merr as më të vlefshmen, e as më të pavlefshmen, por të mesmen.)

Ruaju shumë nga mallkimi i atij të cilit i ke bërë padrejtësi, sepse mes mallkimit të njeriut që i është bërë padrejtësi dhe Allahut, nuk ekziston asnjë perde!" (Buhari, Zekat 41, 63, Megazi 60, Teuhid 1.)

Pas plotësimit të fesë, aty nuk ka më nevojë për gra-

dualitet. Mirëpo, me qëllim që njerëzit të udhëzohen, Allahu i Madhëruar ka urdhëruar që gjatë predikimit të fesë të përdoret "kaulen lejjina / gjuhë e butë". Lidhur me metodën e predikimit të bukur të fesë, në Kuranin Fisnik urdhërohet:

اُدْعُ اِلٰى سَبِيلِ رَبِّكَ بِالْحِكْمَةِ وَالْمَوْعِظَةِ
الْحَسَنَةِ وَجَادِلْهُمْ بِالَّتِى هِىَ اَحْسَنُ

"Thirr në rrugën e Zotit tënd me mençuri dhe këshillë të bukur dhe diskuto me ata në mënyrën më të mirë!.."

(Nahl, 125.)

Pyetje: *"Më duket e çuditshme që Allahu thotë gjithmonë: «Unë e bëra, Unë e krijova»"*

Allahu nuk është qenie njerëzore. Prandaj ty nuk duhet të të shqetësojë fakti që Ai thotë "Unë". Askush nuk duhet të ndihet keq kur Zoti ynë, i Cili është më i madhi, më i fuqishmi dhe krijuesi i çdo gjëje, thotë "Unë". Fjalët "Unë" dhe "Ne", që përdoren në Kuran, janë shprehje të veçanta të madhështisë.



Duke filluar prej shkatërrimit të natyrës, e deri tek speciet e rrezikuara nga zhdukja, tek armët e shfarosjes në masë, padrejtësitë dhe kolonizimet; a nuk janë të gjitha këto veprat e një bote të mbështetur në mendje dhe shkencë? Si ta ruajmë mendjen nga çmenduria dhe barbaria?

Pyetje: *"Përse në Kuran gruaja dhe burri nuk janë të barabartë?"*

Në Islam, burri dhe gruaja nuk konsiderohen të barabartë në mënyrën siç kuptohet në kohën tonë (nga qarqet feministe). Statusi i tyre në Islam, bazohet në ekuilibrin e drejtësisë.

NDERI I GRUAS ËSHTË NË ISLAM!



Fytyra e shëmtuar dhe e neveritshme e qytetërimit perëndimor!

Nëse i rivlerësojmë vlerat familjare dhe njerëzore të perëndimit pa u ndikuar nga forca e tyre teknologjike dhe materiale, a mund të themi se kanë ndonjë aspekt për t'u marrë shembull? Apo mos vallë perëndimi është vetëm një egërsirë e mbetur me një dhëmb?

Tek Allahu gruaja dhe burri janë të barabartë. Pra, para Allahut burri dhe gruaja janë plotësisht të barabartë në çështjet e besimit, adhurimit dhe përgjegjësive. Edhe burri, edhe gruaja, janë të ngarkuar me përgjegjësinë e besimit, namazit, agjërimit, zekatit dhe haxhit. Këtë e vërtetojnë këto fjalë të Allahut në Kuran:

"Dhe kushdo që bën vepra të mira, qoftë ai mashkull ose femër, duke qenë besimtar, do të hyjë në Xhenet dhe nuk do t'i bëhet asnjë padrejtësi." (Nisa, 124. Shih. Al-i Imran, 195; Nahl, 97; Gafir, 40.)

"Me të vërtetë që;

- **Për myslimanët dhe myslimanet,**
- **Besimtarët dhe besimtaret,**
- **Të bindurit ndaj Allahut dhe të bindurat ndaj Allahut,**
- **Të drejtët (të sinqertët) dhe të drejtat (të sinqertat),**
- **Durimtarët dhe durimtaret,**
- **Të përulurit dhe të përulurat,**
- **Mirëbërësit dhe mirëbërëset,**
- **Agjëruesit dhe agjërueset,**
- **Ruajtësit e nderit dhe ruajtëset e nderit,**
- **Përkujtuesit e Allahut vazhdimisht dhe përkujtueset,**
- **Pra, për të gjithë këta Allahu ka përgatitur falje dhe shpërblim të madh."** (Ahzab, 35.)

Në shumë fe gruaja konsiderohet si shtresë e dorës së dytë, madje edhe si burim i së keqes. Ndërsa në Islam, gruaja e devotshme vlerësohet ndër mirësitë më të çmuara të botës. Madje, Xheneti ndodhet nën këmbët e nënave të devotshme.

Mirëpo, në aspektin e krijimit dhe natyrës, gruaja dhe burri nuk janë të barabartë. Ata nuk janë të barabartë as në aspektin trupor dhe as në atë emocional. E megjithatë, ata janë plotësues të njëri-tjetrit. Për këtë arsye, mes burrit dhe gruas ekziston një ndarje përgjegjësish shoqërore në përputhje me natyrën e krijimit të secilit.

Për shkak se Islami është një fe e natyrshme, ky dallim fizik dhe emocional që ndodhet në natyrën e krijimit, është reflektuar në të drejtat dhe detyrat e burrit dhe gruas.

Në një hadith fisnik thuhet:

"Të gjithë jeni çobanë dhe të gjithë jeni përgjegjës për tufën tuaj (ata që keni nën vete).

• *Imami është çoban dhe përgjegjës për tufën e tij.*

• *Burri është çobani i familjes së tij dhe përgjegjës për tufën e tij.*

• *Gruaja është çobane në shtëpinë e burrit të saj dhe po ashtu është përgjegjëse për tufën e saj.*

• *Shërbyesi është përgjegjës për pasurinë e pronarit të vet dhe për tufën e vet."* (Buhari, Ahkam 1; Muslim, Imaret 20.)

Ndërsa në kohën tonë, në botën "moderne", gruaja po shtyhet drejt rrugës dhe po abuzohet me të në saje të propagandave për barazi me burrin.



Mollët e kalbura dhe të shëndosha nuk mund të pranohen njësoj. Thjeshtë, do të ishte një gabim logjik. Atëherë me cilën logjikë mund ta konsiderojmë të njëjtë një fe të prishur dhe Islamin, që nuk është prishur aspak dhe është e vetmja fe e vërtetët?



Një aksident në rrugë, një turbulencë në aeroplan, një tërmet... Një moment të tillë e ke përjetuar me patjetër. Çfarë është ai tmerr dhe frikë që përjeton në atë moment? Në një moment të tillë, e ke ndjerë dëshirën për t'iu lutur dhe kërkuar ndihmë një qenieje që ka fuqi për çdo gjë, apo jo?

Femra duhet të marrë përsipër detyrën e gruas dhe të nënës, nga ku merr jetë institucioni i shenjtë i familjes. Prandaj, më tepër se logjike, femra është emocionale. Për këtë arsye, Islami e ruan gruan me parime të tilla si turpi, nderi dhe mbulesa. Ai e mbron atë brenda mburojës së familjes.

Kur bëhet fjalë për barazinë gruaburrë, duhet parë fytyra e vërtetë e perëndimit, jo ajo e maskuara dhe e zbukuruara. Në një shoqëri ku kërkesat për martesë janë pakësuar, ku shumë martesa përfundojnë me divorce, ku marrëdhëniet jashtëmartesore (zinaja) janë përhapur shumë dhe janë bërë të natyrshme, ku numri i popullsisë është ulur dhe ku prindërit e moshuar janë dënuar me vetmi dhe vdesin në shtëpi boshe, a mos duhet të shihet si ndonjë talent kur gruaja arrin të bëhet shofere kamioni apo kasap si burrat?

Në fakt Islami nuk është kundër angazhimit të gruas me profesione, dije dhe shërbime të ndryshme, nëse asaj i përgatiten kushtet e nevojshme për të ruajtur nderin dhe dinjitetin e saj. Për shembull, nëna jonë Aishja ﷺ ka pasur rreth treqind nxënës. Ndërsa në periudhën Osmane, ekzistonin shumë vakëfe të themeluara nga gratë.

Mirëpo, një mendje e shëndoshë, e pranon se profesioni më i natyrshëm i gruas është mëmësia. Pra, të jetë kurora e institucionit të shenjtë të familjes. Padyshim se pas njerëzve

të suksesshëm qëndron një nënë e mirë dhe e devotshme. Kështu, fitoren në Çanakkale, krahas atyre që dhanë jetën, ia kemi për borxh edhe nënave që i dërguan ata në frontin e luftës.

Shkurtimisht:

Islami përfshin çdo fazë të jetës. Ai i jep përgjigje çdo pyetje për të realizuar qëllimin e arritjes së lumturisë në të dyja botët. Dhe, mes të gjitha përgjigjeve nuk mund të gjesh as edhe një kontradiktë. Islami ka sistem dhe disiplinë. Ai është më i përsosuri i të përsosurve. Ai përgatit dhe realizon lumturinë e të dyja botëve për besimtarët e devotshëm.

Në përbërje të Islamit ka besim, ligj, praktikë, rregull shoqëror dhe moral të bukur.


Islami na ndihmon të kuptojmë qëllimin e krijimit të gjithësisë dhe njeriut. Po ashtu, ai na sistemon çdo fushë të jetës që prej djepit deri në varr. Madje, prej frymëmarrjes e deri tek hapat që hedhim...

Allahu i Madhëruar na e bëftë të mundur ta jetojmë Islamin dhe ta mbajmë gjallë atë në jetët tona! Allahu na ruajtë të gjithëve prej hileve dhe vesveseve të egos dhe shejtanit, duke i edukuar mendjet dhe zemrat tona me shpalljen hyjnore! Allahu i sjeltë ndjenjat dhe mendimet tona në përputhje me kënaqësinë e Tij! Allahu na e bëftë të mundur faljen dhe mëshirën hyjnore, me mirësinë dhe bujarinë e Tij!

Amin!



Profeti ﷺ, shkoi tek Allahu në vitin 632. Mirëpo, ai na ka lënë hadithe të atillë, në të cilat përshkruhen ditët e sotme. Kështu që, a është e drejtë të mos i besojmë lajmet për botën tjetër që na ka sjellë ky profet?



E VËRTETA ABSOLUTE DHE FEJA E VËRTETË

Islami përfshin çdo fushë të jetës.
Ai i jep përgjigje çdo pyetjeje për të realizuar
qëllimin e arritjes së lumturisë në të dyja botët.
Dhe, mes të gjitha përgjigjeve nuk mund të gjesh as
edhe një kontradiktë. Islami ka sistem dhe disiplinë.
Ai është më i përsosuri i të përsosurve. Ai përgatit
dhe realizon lumturinë e të dyja botëve
për besimtarët e devotshëm.



E VËRTETA ABSOLUTE DHE FEJA E VËRTETË

Mendimet e pabaza që deistët i përdorin si justifikim për tu larguar nga feja, janë këto:

Sipas botëkuptimit të tyre të pabazë, të gjitha fetë ekzistente në botë, janë produkt njerëzor. Të gjithë njerëzit bëhen automatikisht pjesë e fesë që ndodhet në zonën dhe kulturën ku jetojnë dhe nuk e zgjedhin atë.

Sipas botëkuptimit të tyre të pabazë, fetë janë pjesë e evolucionit shoqëror të njeriut dhe tashmë e kanë humbur vlefshmërinë e tyre.

Sipas botëkuptimit të tyre të pabazë, të gjitha fetë nxisin për luftë, duke përplasur popujt me njëri-tjetrin.

Prandaj në bazë të pretendimeve të tyre, fetë duhen braktisur. Sipas tyre, deizmi është i mjaftueshëm, sepse është një besim "i natyrshëm" i mbështetur në rregullat morale njerëzore të ndërtuara mbi mendimin dhe arsyen.

Ky pretendim, në shekujt e shkuar është hedhur edhe nga pozitivistët. Edhe sipas tyre, feja ka qenë një pjesë e evolucionit shoqëror të njeriut dhe tashmë e ka humbur vlefshmërinë e saj. Ndërsa vendin e saj gjoja duhej ta zinte "shkenca".

Po ashtu, edhe socializmi me komunizmin pretendonin se feja është si opium që drogon popujt dhe janë përpjekur ta hedhin fenë jashtë sistemit shoqëror. Por, megjithëse në sistemet e ndryshme komuniste, si ai i Rusisë dhe Kinës, feja u përjashtua pothuajse plotësisht nga shoqëria për 70-80 vjet, ajo në të vërtetë nuk u zhduk. Madje, as fetë e prishura nuk u zhdukën. Pavarësisht gjithë propagandës dhe luftës ndaj fesë, ajo vazhdoi të ekzistojë, sepse besimi është në natyrën njerëzore.



Islami nuk është ideologji, por zotëron një botëkuptim mbi të gjitha ideologjitë, të vërtetë dhe të përsosur që i fal individit dhe shoqërisë lumturinë e të dyja botëve.

Ndërsa feja e vërtetë, Islami, qëndron ende në këmbë pavarësisht gjithë sulmeve asgjësuese, sepse ai është nën mbrojtjen e Vetë Allahut të Madhëruar.

Pretendimet e pabaza se feja e ka mbushur kohën e saj dhe e ka humbur vlefshmërinë, në fakt burojnë nga mosnjohja e Islamit që është feja e vërtetë.

Ata që e dinë se çfarë disipline

të përsosur ka Islami dhe mësojnë parimet e tij që të çojnë drejt lumturisë së të dyja botëve, nuk mund të këmbëngulin në këto lloj pretendimesh.

Mirëpo, ata që i qasen Islamit me paragjykime nën hijen e shpifjeve, ofendimeve dhe përbaltjeve dhe nën ndikimin e sulmeve Islamofobe, duhet t'i rishikojnë njohuritë e tyre në lidhje me fenë e vërtetë.



Çdo qytetërim formon modelin e vet njerëzor. Qytetërimi ynë, është qytetërimi i Kuranit dhe Sunetit. Nisur nga kjo, periudhat e Hulefa-i Rashidin, Omer bin Abdulazizit dhe tre shekujt e parë të Osmanëve, kur botën e sundonte botëkuptimi Islam, kanë qenë periudhat më të mira të historisë njerëzore.

FETË E TJERA DHE ISLAMI

Përveç Islamit, fetë e tjera janë shumë larg nga e vërteta. Ose janë fe të shpikura nga njeriu, ose janë manipuluar nga ai dhe janë larguar nga e vërteta.

Më herët folëm gjerë e gjatë në lidhje me erozionin dhe manipulimin që ka përjetuar krishterimi në çështjet e besimit, adhurimit dhe ligjeve. Por le të japim edhe këtu një shembull:

Mbretëresha e Kastiljes, Isabella, e cila është e famshme për dhunën dhe torturat çnjerëzore që ka ushtruar mbi myslimanët e Andaluzisë, në histori njihet si Isabela e Pisët. Kjo, sepse sipas botëkuptimit absurd të krishterimit, moslarja dhe mospastrimi janë shenja që njeriu nuk po i jep vlerë kësaj bote. Për rrjedhojë, për shkak se Isabella ishte një katolike fanatike dhe nuk lahej asnjëherë, kundërmonte erë aq të keqe, sa ishte e pamundur t'i afroheshe. Gjatë gjithë jetës së vet, ajo është larë vetëm dy herë.

Për shkak të këtij botëkuptimi absurd, që përveç mbretëreshës e praktikonin edhe gratë e tjera të martuara që ishin fetare, burrat i linin gratë e tyre që kundërmonin erë të keqe si pasojë e këtij fanatizmi katolik dhe shkonin me prostitutat të cilat laheshin rregullisht, duke bërë që prostitucioni, i cili është një sëmundje shoqërore, të përhapej edhe më tepër. Në këtë mënyrë, sëmundja e prostitucionit që rrënon familjet, shkatërroi shpirtra dhe breza të tërë.

Gjendja e mjeruar e një feje të manipuluar nga njeriu!..

Krishterimi, i cili prej Palit e këtej është manipuluar vazhdimisht nga dora njerëzore, sot vazhdon ende të manipulohet përballë presioneve të ateistëve.

Sa i çuditshëm është fakti se, në disa vende si Holanda, kisha pranon të lidhë kurorë martesore edhe për persona të së njëjtës gjini, megjithëse deri pakë kohë më parë, ajo përpiqej ta kundërshtonte këtë akt të shëmtuar. Mirëpo, tani ajo ka lëshuar pe edhe në këtë çështje. Pra, kisha pranon të mbështesë me duart e veta një gjynah të rëndë si ky, që e çon shoqërinë njerëzore drejt greminës.



Krishterimi u lëshon pe vazhdimisht ateistëve. Për shembull, në disa vende si Holanda, priftërinjtë u lidhin kurorë edhe çifteve të të njëjtës gjini. A mund të jetë feja pa personalitet dhe dinjitet aq sa t'i nënshtrohet vazhdimisht presioneve nga jashtë?

A mund të bëhet feja vegël e gjynaheve dhe kundërshtimeve ndaj Zotit? A mund të jetë feja pa personalitet dhe dinjitet, aq sa t'i nënshtrohet vazhdimisht presioneve nga jashtë? A mund t'i japë lumturi njeriut një fe e tillë? Sigurisht që jo!..

Edhe jahudizmi nuk është më ndryshe. Edhe kjo fe është bërë lodër e manipulimeve njerëzore dhe është

kthyer në një fe që i shërben vetëm një race dhe konsideron si armiq pjesën tjetër të njerëzve, duke legjitimuar dhunën dhe shfrytëzimin e tyre.

Jahudizmi është larguar aq shumë nga e vërteta, saqë nuk e fton askënd në fenë e vet, sepse sipas tyre, kjo fe u takon vetëm hebrenjve!..

Besëtytnitë kanë pushtuar kulturën e tyre orale dhe të shkruar. Edhe ato që u kanë mbetur prej librave të shenjtë, Zeburi dhe Teurati, janë manipuluar aq shumë, saqë profetëve u atribuohen poshtërsi dhe absurditete, si "mundje me Zotin", "mohim i Zotit", "imoralitete", etj.

Po ashtu, edhe adhurimet janë tjetërsuar. Një shembull i kësaj është riti fetar "kaparot":



Shumë njerëz janë ftohur prej besimit për shkak të kontradiktave në fetë e prishura. Por, sikur ata të arrinin të takoheshin me fenë Islame dhe sikur të shihnin se këto lloj kontradiktash nuk gjenden në fenë e vërtetë dhe se Islami është feja më e përsosur, do të shpëtonin nga paragjykimet fanatike në lidhje me institucionin fetar dhe do të arrinin lumturinë e të dyja botëve.

Jahudizmi është ndarë në shumë fraksione dhe, njësoj si krishterimi, edhe ai ka një fraksion të quajtur "Ultra Ortodoks", të cilët performojnë një rit të tillë:

Para festës fetare Jom Kipur, besimtari merr një pulë dhe duke kënduar disa lutje mbi të, e rrotullon tre herë përreth kokës së vet, duke shpresuar që gjynahet e tij t'i kalojnë pulës. Më pas ai e ther pulën duke menduar se ka eliminuar edhe gjynahet e veta!..

Ky rit nuk ka asnjë bazë në fe, gjë të cilën e pohojnë edhe vetë ata. Para se të rrënohej Tempulli i Sulejmanit عليه السلام, ata ia ngarkonin gjynahet e veta një dhie, të cilën më pas e lëshonin në shkretëtirë, duke menduar se kanë shpëtuar

prej gjynaheve. Mirëpo, pas shkatërrimit të tempullit, ata shpikën ritin me pulën.

Në të dyja fetë e manipuluara, shpëtimi nga gjynahet arrihet me rituale shumë të thjeshta. Ndërsa në Islam, i vetmi autoritet që mund të falë gjynahet, është Allahu i Madhëruar dhe, askush nuk mund të jetë i sigurt në jetën e kësaj bote, nëse i janë falur apo jo gjynahet. Për rrjedhojë, myslimani vazhdon t'i lutet Allahut për falje deri në frymën e fundit.

Me këtë rast, dëshiroj t'ju përcjell një kujtim që e kam dëgjuar nga poeti Nexhip Fazëll:

Njëherë, sociologu i shquar Arnold Toynbee shkoi në Egjipt. Për arsye se ishte sociolog, iu afrua një lypësi të gjorë dhe e pyeti:

"Çfarë do të bësh nëse të jap para?"

"Do t'i lutem Allahut për ty!"- përgjigjet lypësi.

"Mirë, por a e pranon Allahu lutjen tënde?"- e pyet Toynbee.

"Zotëri, unë i lutem Atij, e nuk i përzihem me të tjerat. Nëse Allahu dëshiron e pranon lutjen time, nëse jo, nuk e pranon."- thotë lypësi.

Pas kësaj Toynbee tha:

"Priftërinjtë tanë të shkolluar, thonë se ua pastrojnë gjynahet njerëzve. Ndërsa këtu, një njeri i gjorë i kësaj feje, thotë: «Nëse Allahu dëshiron e pranon lutjen time, nëse jo, nuk e pranon!»"

Ja pra, ky është dallimi i Islamit nga fetë e manipuluara... Kjo vërehet



Çështja e pastrimit të gjynaheve në krishterim, është një absurditet shumë mashtrues. Si mundet një rob, të fal gjynahun që një rob tjetër ka bërë kundër Allahut? Kontradiktat në fetë e manipuluara, e ftohin njeriun nga feja.

edhe tek vetëdija që ai i ka falur çdo besimtari të saj...

Një shembull tjetër:

Një pjesëtar i kishës pyetet:

- Si duhet të veprojë njeriu kur bën gjynah?

- Duhet të shkojë tek prifti, të japë para dhe të pastrohet nga gjynahet.

- Po nëse bën përsëri gjynahe?

- Shkon përsëri, jep para dhe prifti do ta falë prapë.

- Po sikur ndër ato gjynahe të ketë edhe shkelje të të drejtave të njerëzve? Si do ta falë prifti këtë?

- ?!...

S'ka përgjigje...



Në Islam, i vetmi autoritet që mund të falë gjynahet, është Allahu i Madhëruar dhe, askush nuk mund të jetë i sigurt në jetën e kësaj bote, nëse i janë falur apo jo gjynahet. Për rrjedhojë, myslimani vazhdon t'i lutet Allahut për falje deri në frymën e fundit.

Çështja e pastrimit të gjynaheve në këtë formë, është një absurditet shumë mashtrues.

Si mundet një rob, të fal gjynahun që një rob tjetër ka bërë kundër Allahut? E kush mund ta pranojë që një i huaj ta falë vjedhjen apo krimin që një tjetër ka bërë kundër tij? Kush mund të pranojë mosfunksionimin e drejtësisë?

Ja pra, pikërisht këto kontradikta, i kanë ftohur shumë njerëz nga feja. Por, sikur ata të arrinin të takoheshin me fenë Islame dhe sikur të shihnin se këto lloj kontradiktash nuk gjenden në fenë e vërtetë dhe se Islami është feja më e përsosur, do të shpëtonin nga paragjykimet fanatike në lidhje me institucionin fetar dhe do të arrinin lumturinë e të dyja botëve.

Ndërsa fetë e Lindjes së Largët, janë larguar plotësisht prej mendjes së shëndoshë.

• Një sistem kastash armike ndaj lirisë njerëzore dhe me zakone e tradita mizore që abuzojnë me njerëzit.

• Një emigrim shpirtëror absurd i quajtur reinkarnacion, që nuk i shërben së vërtetës dhe drejtësisë dhe që është shpikur për të mohuar botën tjetër...

• Një misticizëm me qëllime absurde, adhurim statujash, idhujtari dhe tempuj në gjendje të pistë e të turpshme...

• Një kaos i vërtet, pa krijues dhe pa botë tjetër, i përzierë me mitologji dhe legjenda...

• Edhe pse kanë disa pjesë mistike dhe praktika që e joshin njeriun perëndimor, siç janë dietat vegjetariane, meditacioni dhe joga që i ngjan pehrizit, meditimit dhe sportit, në këto fe ku nuk ka Zot, orientim dhe qëllim, është e pamundur të gjesh lumturinë.

Përveç këtyre, edhe në Afrikë ka shumë fe të shpikura. Fe gjysmë të egra, ku njeriu bëhet kurban dhe ku adhurohen gurët...



Islami, përveçse nuk ka pësuar manipulime, por në të nuk është mundur as që ndonjë autoritet fetar të përcaktojë parimet e besimit, apo të vendosë harame dhe hallalle sipas mendjes së vet. Kjo, sepse në Islam, vendimi i takon Allahut.

Asnjë fe aktuale (përveç Islamit) nuk i ofron njerëzimit një recetë lumturie. Asnjë nuk jep zgjidhje për individin, familjen, shoqërinë, ekonominë, prindërit, fëmijët, të moshuarit, të varfrit dhe të dobëtit.

Edhe pse mbase në fillimet e tyre mund të kenë qenë të drejta, si pasojë e manipulimeve, tashmë ato arrijnë të cekin vetëm një apo dy fusha të jetës...

Është e padrejtë të gjykosh në mënyrë përgjithshme në lidhje me fenë si institucion, duke parë vetëm këto fe.

Islam, është emri i fesë së vërte-

të. Në Islam nuk zë vend asnjë prej këtyre praktikave të palogjikshme, mizore, të pista dhe absurde.

Islami, jo që nuk ka pësuar manipulime, por në të nuk është mundur as që një autoritet fetar të përcaktojë parimet e besimit, apo të vendosë harame dhe hallalle sipas mendjes së vet. Kjo, sepse në Islam, vendimi i takon Allahut të Madhëruar.

Islami, të gjitha parimet e veta i ka të përcaktuara në Fjalën e Allahut dhe traditën profetike, pra, në Kuran dhe Sunnet.

Dijetarët e fesë mund të marrin vendime vetëm në lidhje me çështjet e hasura në periudhat pas shpalljes, duke përdorur metodën e krahasimit me vendimet e Kuranit dhe Sunetit. Pra, ata mund të nxjerrin vendime vetëm në përputhje të plotë me frymën e Kuranit dhe Sunetit.



Për shkak se Islami e ka sistemuar të gjithë jetën dhe nuk i ka lënë vend jetës sipas qejfit, ndaj tij drejtohen sulme të ndryshme, të cilat sot janë bërë edhe më të shpeshta. Kjo bëhet e qartë edhe në shtimin e frikës ndaj Islamit (Islamofobisë), e cila shekullin e fundit ka arritur kulminacionin e saj. Me qëllim të përbaltjes së Islamit dhe të vendosjes së pengesave mes tij dhe njerëzve, kundër tij po hidhen shpifje dhe gënjeshtra nga më të neveritshmet. Ndërkohë që Islami, dëshiron vetëm t'i sigurojë besimtarët nga të gjitha frikat e përkohshme dhe t'i bëjë udhëtarë të Xhenetit.

Për shkak se Islami e ka sistemuar të gjithë jetën dhe nuk i ka lënë vend jetës sipas qejfit, ndaj tij drejtohen sulme të ndryshme, të cilat sot janë bërë edhe më të shpeshta. Kjo bëhet e qartë edhe në shtimin e frikës ndaj Islamit (Islamofobisë), e cila shekullin e fundit ka arritur kulminacionin e saj. Me qëllim përbaltjen dhe vendosjen e pengesave mes Islamit dhe njerëzve, ndaj tij po hidhen shpifje dhe gënjeshtra nga më të neveritshmet. Ndërkohë, Islami dëshiron vetëm t'i sigurojë besimtarët nga të gjitha frikat e përkohshme dhe t'i bëjë udhëtarë të Xhenetit.

Në të njëjtën kohë, ndaj feve dhe sistemeve të tjera tregohen më tolerantë, sepse në to nuk gjendet asnjë detyrim që i jep formë njeriut dhe jetës.

Njeriu është armik i së panjohurës. Për rrjedhojë, shumë njerëz që dalin kundër Islamit në fakt nuk e kanë studiuar atë ashtu siç duhet.

Prandaj, e shohim të arsyeshme që këtu ta përmbledhim shkurtimisht përmbajtjen e Islamit:

Islami përfshin çdo fazë të jetës. Ai i jep përgjigje çdo pyetjeje për të realizuar qëllimin e arritjes së lumturisë në të dy botët. Dhe mes të gjitha përgjigjeve nuk mund të gjesh as edhe një kontradiktë. Islami ka sistem dhe disiplinë. Ai është më i përsosuri i të përsosurve. Ai përgatit dhe realizon lumturinë e të dy botëve për besimtarët e devotshëm.



Kultura më e përsosur dhe më madhështore, është ajo e Kuranit. Ashtu siç ka ndriçuar të djeshmen dhe të sotshmen e njerëzimit, edhe nesër, i vetmi botëkuptim që do ta udhëzojë atë, është Islami.

Në ditët tona, në injorancën moderne që ka bërë që të harrohet bota tjetër, ekziston një botëkuptim fetar "i vakët" që përbëhet vetëm nga parime morale të burgosura në ndërgjegje dhe në vend-adhurime. Po ashtu, janë shfaqur edhe botëkuptime absurde si "deizmi" që është larg ligjeve dhe gjykimeve hyjnore, dhe "historicizmi" që është një lloj injorance e cila pretendon të nxjerrë në pension gjykimet e fesë.

Ndërsa Islami, që është feja e vërtetë, nuk mjaftohet vetëm me sistemimin e jetës fetare të besimtarëve, por njëkohësisht vë rregull edhe në jetën e tyre në mënyrën më

të bukur dhe me kriteret më ideale, duke filluar prej individit tek familja, prej familjes tek shoqëria, prej jetës private tek ajo publike, prej ushqimit tek ekonomia dhe në çdo fushë tjetër të jetës. Pra Islami posedon udhëzime dhe vendime në lidhje me të gjitha aktivitetet njerëzore.

Feja na ndihmon të kuptojmë qëllimin e krijimit të gjithësisë dhe njeriut. Po ashtu, ajo na sistemon çdo fushë të jetës që prej djepit deri në varr. Madje, prej frymëmarrjes e deri tek hapat që hedhim...



Feja na ndihmon të kuptojmë qëllimin e krijimit të gjithësisë dhe njeriut. Po ashtu, ai na sistemon çdo fushë të jetës që prej djepit deri në varr. Madje, prej frymëmarrjes e deri tek hapat që hedhim...

Feja është një sistem ligjesh dhe rregullash që i jep paqe shpirtërore njeriut në këtë botë dhe i hap rrugën e lumturisë së përjetshme në botën tjetër.

Kurani Fisnik është burimi kryesor i kulturës së vërtetë dhe origjinale. Dijet që përmban Kurani, mund të përmblidhen në këto pesë tema kryesore:

KULTURA E KURANIT

1. Shkenca e gjykimeve juridike

- Mëson parimet lidhur me besimin.
- Njofton me gjykimet lidhur me adhurimet.
- Shpjegon cilësitë negative që të largojnë nga Allahu, pra haramet e dukshme dhe të fshehta.
- Radhit gjykimet e nevojshme për përmirësimin e shoqëë risë, pra farzet (obligimet) e dukshme dhe të fshehta.

• Predikon parimet e përgjithshme të së drejtës në çështjet ekonomike dhe financiare.

• Ndërton gjykimet në lidhje me familjen.

• Shpall ligjin e luftës.

• Përcakton ligjet në lidhje me robërit e luftës.

• I jep qetësi mendjes me anë të dorëzimit ndaj temave që predikon shpallja hyjnore dhe zhvillon zemrën.

2. Shkenca e dialogut

- I jep përgjigje pretendimeve që nuk përputhen me besimin monoteist dhe shpalos pavlefshmërinë e të kotës dhe të prishurës.



Mbretëresha e Kastiljes, Isabela e Pistë, për shkak se nuk lahej asnjëherë, kundërmonte aq erë të keqe, sa nuk mund t'i rrije afër. Në kohën e saj, burrat i linin gratë e tyre që nuk laheshin dhe shkonin me prostitutat që laheshin. Kjo është gjendja e fesë së prishur!..

3. Ajetet në lidhje me botën

- Përkujtojnë mirësitë e Allahut dhe nxisin në meditimin rreth tyre. Po ashtu, të vetëdijesojnë ndaj artit të Allahut në botën tonë të brendshme dhe të jashtme, duke na ndihmuar të arrijmë tek Artisti nëpërmjet artit, tek Shkaktari nëpërmjet pasojës.

4. Morali i historive

Tregon dhe shpjegon ndërhyrjet e Allahut në historinë njerëzore, historitë e profetëve, skenat mësimdhënëse prej ithtarëve të librit (jahuditë dhe të krishterët) dhe fatkeqësitë që pësuan popujt e devijuar si Sodoma dhe Gomorra, me qëllim që njerëzimi të marrë mësim.

Po ashtu, Kurani është edhe burimi më i rëndësishëm i historisë së Profetit ﷺ, që është shembulli më i mirë për ne.

5. Njohuritë në lidhje me vdekjen dhe përtej saj

Na njofton me fazat e vdekjes dhe çka vjen përtej saj. Na përgatit për jetën e përjetshme, e cila është edhe jeta e vërtetë, dhe na njeh me mënyrat për t'u miqësuar me Allahun e Madhëruar, me qëllim që të çlirohemi nga frika dhe hidhërimi në ditët e vështira në botën tjetër.



Jahuditë "Ultra Ortodoksë", para festës fetare Jom Kipur, marrin një pulë dhe, duke kënduar disa lutje mbi të, e rrotullojnë tre herë përreth kokës së tyre, duke shpresuar që gjynahet e tyre do t'i kalojnë pulës. Më pas, ata e therin pulën, duke menduar se kanë eliminuar edhe gjynahet e veta!.. Kjo pra është gjendja e për të ardhur keq dhe qesharake e fesë së prishur...

Të gjitha këto që përmendëm formojnë "Kulturën e Kuranit". Kultura më e përsosur dhe më madhështore është ajo e Kuranit. Ashtu siç ka ndriçuar të djeshmen dhe të sotshmen e njerëzimit, edhe nesër i vetmi botëkuptim që do ta udhëzojë njerëzimin është Islami. Ndërsa udhëheqësi i vetëm i kësaj kulture, në të gjitha fushat e jetës, është Profeti ﷺ. Gjithashtu, ata që e kanë mësuar më mirë e më bukur këtë kulturë prej Profetit ﷺ, janë sahabët dhe dijetarët.

Islami nuk është ideologji, por zotëron një botëkuptim mbi të gjitha ideologjitë, i cili është i vërtetë, i përsosur dhe i fal individit e shoqërisë lumturinë e të dyja botëve.

Çdo qytetërim formon modelin e vet njerëzor. Qytetërimi ynë është qytetërimi i Kuranit dhe Sunetit. Nisur nga kjo, mund të themi se periudha e Hulefa-i Rashidin, ajo e Omer

bin Abdulazizit, dhe tre shekujt e parë të Osmanëve, kur botën e sundonte botëkuptimi Islam, kanë qenë periudhat më të mira të historisë njerëzore.

Dhe me të vërtetë që;

Njerëzit më të qetë në botë janë ata që posedojnë besim të vërtetë. Allahu i Madhëruar, gjendjen e qetësisë ia fal robërve të tij të mirë e të devotshëm. Ata janë të qetë, edhe në kushtet më të vështira.

Besimi dhe devotshmëria i falin njeriut një qetësi shpirtërore të atillë që e bëjnë personin t'i shoh të gjithë me dashuri e mëshirë dhe të kërkojë falje madje edhe për ata që e bëjnë të vuajë.

Për shembull, pothuajse të gjitha ngjarjet që kanë ndodhur në Epokën e Lumturisë janë përcjellë deri tek ne në formën e transmetimeve. Ndër to nuk hasim asnjë problem psikologjik tek sahabët. Pavarësisht vuajtjeve dhe vështirësive që kanë kaluar, ata kanë jetuar përherë të qetë dhe të lumtur...



Paqja është në Islam, në fenë e vërtetë, duke i besuar Allahut të Madhëruar, duke bërë punë të mira dhe duke jetuar me moral të bukur me devotshmëri.

Ndërsa njerëzit indiferentë dhe të pafe, janë të shqetësuar edhe mes mirësive dhe mundësive më të mëdha. Për këtë arsye, problemet psikologjike vërehen më tepër tek ata.

Pra, nëse njeriu kapet fort pas fesë së vërtetë, është gjithmonë i qetë shpirtërisht, sado të vështirë ta ketë gjendjen. Por, nëse largohet nga feja e vërtetë dhe morali i lartë, ai bie në kthetrat e problemeve shpirtërore dhe psikologjike.

Ja pra, kjo është gjendja e perëndimit...

Ata janë të pakënaqur për çdo gjë dhe për këtë arsye priren më tepër në vrasje, vetëvrasje, vjedhje, drogë dhe homoseksualizëm.

Në këtë gjendje, është e natyrshme;

Të eliminohet mëshira prej zemrave të njerëzve të tillë, t'u thahen ndërgjegjet dhe të rrëshqasin ngadalë drejt sadizmit. Ja pra, ky është edhe shkaku i mizorive dhe padrejtësive që ndodhin sot në Palestinë, Siri, Jemen, Mjanmar, etj.

Edhe në këtë botë, edhe në botën tjetër;



Paqja, është të besosh në ditën e gjykimit, ku do të vendoset drejtësia absolute dhe asnjë padrejtësi nuk do të mbetet pa u ndëshkuar. Paqja, është të realizosh qëllimin e krijimit.

Paqja është në Islam, në fenë e vërtetë, duke i besuar Allahut të Madhëruar, duke bërë punë të mira dhe duke jetuar me moral të bukur e devotshmëri.

Paqja është besimi në ditën e gjykimit, ku do të vendoset drejtësia absolute dhe ku asnjë padrejtësi nuk do të mbetet pa u ndëshkuar.

Paqja është realizimi i qëllimit të krijimit.

LIGJ HYJNOR I LEHTË DHE I NATYRSHËM

Në fenë që Allahu i Madhëruar dërgoi me Librin dhe Profetin e fundit, është predikuar një ligj posaçërisht i lehtësuar.

Nga ajetet e Kuranit Fisnik kuptojmë se;

Allahu i Madhëruar, për shkak të gjynaheve dhe kundërshtive që shfaqnin, hebrenjve u zbriste urdhra dhe gjykime më të vështira. Për shembull:

• U ishte ndaluar të punonin të shtunave.

• U ishte ndaluar të hanin mishin e kafshëve me thundra, si deveja, etj.

• Po ashtu e kishin haram të hanin edhe dhjamin e të brendshmeve të kafshëve, si lopa, delja, etj.

Sipas transmetimeve;

• Si zekat duhej të jepej një e katërta e pasurisë.

• Numri i namazeve farz ishte më i shumtë.

• Plaçka e luftës ishte e ndaluar.

• Adhurimet mund të bëheshin vetëm në faltore.

• Ndotja e rrobave nuk duhej të pastrohej me larje, por vendi ku ishte prekur nga ndotja duhej të pritej.

• Për faljen e disa gjynaheve, kërkohej që njeriu të vriss te veten.

E në fakt, Kurani Fisnik këto i quan "Isr / Ligje të rënda".

Për këtë arsye, në Kuran urdhërohemi të bëjmë këtë lutje që gjendet në ajetin e 286 të sures Bekare:

"...Zoti ynë, mos na ngarko barrë të rëndë, ashtu si i ngarkove ata para nesh!.."

Në saje të mëshirës hyjnore, Ligji Islam (sheriati) është quajtur, "el-Hanefijjetu's-semha / Feja e tolerancës dhe lehtësisë".

Në një ajet tjetër urdhërohet:

"...Ai ju ka zgjedhur dhe nuk ju ka vënë asnjë barrë në fenë tuaj, fenë e babait tuaj, Ibrahimit!.." (Haxh, 78.)



Njerëzit më të qetë në botë, janë ata që posedojnë një besim të vërtetë. Allahu i Madhëruar, gjendjen e qetësisë ia fal robërve të tij të mirë e të devotshëm. Ata janë të qetë, edhe në kushtet më të vështira.

Në fenë tonë, me qëllim që të mos ketë tepër vështirësi, janë njohur një sërë lehtësish edhe në rast sëmundjesh e udhëtimi:

Në ajetin që urdhëron agjërimin e Ramazanit, thuhet edhe se kush është i sëmurë apo udhëtar gjatë këtyre ditëve, mund të mos agjërojë ato ditë dhe t'i zëvendësojë ato më vonë. Menjëherë pas kësaj, urdhërohet: **"...Allahu dëshiron që t'jua lehtësojë dhe jo që t'jua vështirësojë..."** (Bekare, 185.)



Njerëzit indiferent dhe të pafe, janë të shqetësuar edhe mes mirësive dhe mundësive më të mëdha. Për këtë arsye, problemet psikologjike vërehen më tepër tek ata.

Ndërsa në ajetin që urdhëron për tejemum[8] në rast se nuk është e mundur të gjendet ujë, thuhet:

"...Allahu nuk dëshiron t'ju krijojë ndonjë vështirësi, por dëshiron t'ju pastrojë dhe t'i plotësojë dhuntitë e Tij ndaj jush, që të jeni falënderues." (Maide, 6.)

Pra, në të vërtetë, të gjitha urdhrat e Zotit tonë janë në të mirën dhe dobinë tonë.

FETË DHE LUFTËRAT

Ateistët dhe deistët pretendojnë se fetë janë përgjegjëse të luftërave në historinë njerëzore. Për rrjedhojë ata përpiqen ta prezantojnë fenë si diçka e dëmshme që fut në luftë njerëzit dhe shton urrejtjen.

8. Tejemum: Marrja e abdesit në mënyrë simbolike duke fërkuar fytyrën dhe duart me dhe të pastër në rast të pamundësisë së përdorimit të ujit. Për detaje këshillohet të lexohet Ilmihali.

Këtu duhet të theksojmë se;

Në natyrën e njeriut ekziston lakmia. E në fakt një nga shkaqet e zbritjes së Islamit është shpëtimi i njeriut nga kjo e keqe dhe injorancë që ndodhet në natyrën e tij.

Vrasja e parë në sipërfaqen e tokës është ajo që kreu Kabili kur i mori jetën vëllait të vet Habilit. Në këtë ngjarje të hidhur, Habili, i cili ishte besimtar i devotshëm, tha:

"Nëse ti ngre dorë të më vrasësh mua, unë nuk do ta ngre dorën që të të vras, sepse në të vërtetë, unë i frikësohem Allahut, Zotit të gjithësisë." (Maide, 28.)

Luftërat janë zhvilluar për shkak të lakmisë së njerëzve për të grabitur pasurinë dhe pronën e të tjerëve dhe për t'i sunduar ata.

Ata që janë shtyrë në luftëra për shkak të kësaj lakmie, në mënyrë të veçantë kanë përdorur edhe fetë e manipuluara. E në fakt dihet se, në shumë raste feja është përdorur vetëm si justifikim.



Islami ka parim paqen dhe mirëkuptimin. Por, nëse nuk ka asnjë zgjidhej tjetër për t'u ndaluar kaosin dhe dhunën, atëherë lejon luftën, duke vënë edhe ligjet e posaçme për të.

Për shembull, në periudhën Abasite, shkaku i vetëm i luftërave mes pushtetit qendror dhe kryengritësve, të cilët gjoja ushqenin kauzën Shiite, ishte politika dhe lakmia për pushtet, sepse edhe Abasitët i rrëzuan Emevitët duke u kapur pas kauzës së Ehl-i Bejtit.

Mirëpo, feja e vërtetë është kundër këtyre sulmeve të padrejta ndaj të tjerëve. Lufta është urdhëruar vetëm nëse nuk ka asnjë zgjidhje tjetër për të ndaluar kaosin dhe dhunën. Por

edhe në këto raste Islami ka caktuar rregulla dhe ligje të forta. Lidhur me këtë çështje, urdhrat e Profetit ﷺ janë shumë të qarta:

"Mos vrisni fëmijët, njerëzit që rrinë në vend-adhurimet e tyre dhe merren me adhurime, gratë, të moshuarit dhe njerëzit që janë pajtuar për punë të tjera jashtë luftës! Mos i digjni e mos i shkatërroni kishat. Mos i prisni pemët me gjithë rrënjë!" (Ahmed, I, 300; Taberani, Kebir, XI, 224/11562; Buhari, Xhihad, 148; Muslim, Xhihad, 25-25; Taberani, Eusat, I, 48/135; Ibni Maxhe, Xhihad, 30; Uakidi, III, 912; Abdurrezak, Musannef, V, 220.)



Ata që e studiojnë historinë në mënyrë objektive, nuk mund ta mohojnë respektimin e ligjeve të luftës nga ana e myslimanëve, gëzimin e popujve në zonat e çliruara, lirinë fetare, paqen dhe lumturinë e vendeve që administroheshin me parime Islame!

Ata që e studiojnë historinë në mënyrë objektive, nuk mund ta mohojnë respektimin e ligjeve të luftës nga ana e myslimanëve, gëzimin e popujve në zonat e çliruara, lirinë fetare, paqen dhe lumturinë e vendeve që administroheshin me parime Islame!

Le të mendojmë pak mbi historinë e luftërave:

Kryqëzatat i organizonin papët, por më tepër se prej ndjenjave fetare, ata motivoheshin nga dëshira për grabitje dhe për pasuri. Dhe padyshim se myslimanët nuk mund të rrinin duarkryq përballë këtyre sulmeve të padrejta.

Mahir Iz e kritikon me këto shpjegime logjike Tevfik Fikretin, i cili ishte sentimental, por në mënyrë të palogjikshme, edhe kundër luftës:

"Ka dy lloje njerëzish; njëri i mirë, tjetri i keq. "Habili" përfaqëson njeriun e mirë, ndërsa "Kabili" njeriun e keq. Ja pra, që prej fillimit të botës, këta dy lloj njerëzish janë në luftë me njëri-tjetrin.

Ligjet e të gjitha feve dëshirojnë që të gjithë njerëzit të kenë natyrën e Habilit.

Nëse do ta shohim nga ana sentimentale, njerëzit nuk mund të jetojnë në këtë botë pa derdhur gjak dhe gjatë gjithë historisë njerëzore kanë ndodhur me mijëra ngjarje të njëpasnjëshme.

Në këto situata, ka njerëz të shtypur që janë për të të ardhur keq dhe kanë nevojë për ndihmë. Përderisa ekzistenca e tiranit është e natyrshme dhe përderisa në të gjitha fetë dhe ligjet i shtypuri mbrohet e tirani dënohet, atëherë sulmi ndaj luftës dhe komandantit, nuk janë gjë tjetër veçse një dobësi sentimentale."

(Mahir İZ, Üstadım Mehmed Akif, [Haz. Ertuğrul DÜZDAĞ] s. 51)

E thënë me fjalë të tjera;

A nuk është padrejtësi që të gjitha luftërat t'i shohësh me të njëjtin botëkuptim?



A nuk është padrejtësi që të gjitha luftërat t'i shohësh me të njëjtin botëkuptim? A janë të njëjtë ata që sulmojnë për të pushtuar me ata që luftojnë për të mbrojtur veten, familjen, fenë, atdheun dhe pasurinë e tyre?

A janë të njëjtë ata që sulmojnë për të pushtuar me ata që luftojnë për të mbrojtur veten, familjen, fenë, atdheun dhe pasurinë e tyre?

Në botën e sprovave, lufta mes së drejtës dhe të padrejtës do të jetë e vazhdueshme. Për rrjedhojë, nëse në një situatë të tillë thuhet: *"mos të luftojmë, sepse feja nuk e lejon luftën!"*, është vetëm një dredhi që i bën punë vetëm pushtuesit.

Mos ndoshta deistët kritikojnë qëndresën e njerëzve kundër armiqve që përpiqen t'u pushtojnë atdheun?

Apo mos ndoshta deizmi është një përpjekje pasivizimi, zbutjeje dhe skllavërimi me qëllim që ta përgatisë

pushtimin perëndimor të tokave Islame, të cilat ende nuk janë pustuar në kuptimin e plotë të fjalës?

Këto dredhi janë provuar disa herë. Shembulli më i afërt është ai i "dialoguesve fetarë" që lavdëronin perëndimin dhe kryqtarët, e më pas derdhën plumba mbi vëllezërit e tyre.



Lufta mes së drejtës dhe të padrejtës do të jetë e vazhdueshme. Për rrjedhojë, nëse në një situatë të tillë, thuhet; "feja të mos e lejojë luftën!", kjo është vetëm një dredhi që i bën punë vetëm pushtuesit.

Dhe me të vërtetë që intelektualët Osmanë, të cilët e admironin perëndimin, para Luftërave Ballkanike, Luftës së Parë Botërore dhe Luftës Kombëtare, të cilat ndodhën brenda pesëmbëdhjetë viteve, e pandehnin perëndimin si shpëtimtar. Por, kur filluan luftërat, ata e panë se si perëndimi u vërsul si hienat mbi vendet myslimane, për të shtënë në dorë naftën dhe pasuritë e tjera të myslimanëve.

Poeti Mehmet Akif Ersoji, shprehet kështu në lidhje me qytetërimin Evropian ku mbizotëron filozofia materialiste e cila prodhoi deizmin dhe ateizmin:

"Qytetërimi!" prej kohësh i mpreh dhëmbët kundër jush;
Së pari dëshiron t'ju copëtojë, më pas t'ju gëlltisë.
...
Krijesën e poshtër të quajtur qytetërim, vështrojeni:
Pështyjeni ndërgjegjen e maskuar të shekullit, pështyjeni!

As sot Islami s'mund të konsiderohet përgjegjës për ecurinë negative të botës. Përkundrazi, gjendja aktuale e botës është shkaktuar nga luftërat egoiste për interesa të sistemeve njerëzore si kapitalizmi, socializmi, fashizmi, materializmi, sionizmi, etj.

Armën më të përgjakshme dhe më të pamëshirshme, që është bomba atomike, nuk e kanë prodhuar dhe përdorur fetarët, por shkencëtarët që gjoja ndjekin mendjen dhe arsyen (!) dhe njerëzit që gjoja mbrojnë demokracinë dhe të drejtat njerëzore.

Aty ku u hodh ajo bombë, u shuan me mijëra njerëz të pafajshëm, të moshuar, gra, fëmijë, foshnja, kafshë dhe të mbjella.

Ata që pretendojnë se luftërat nxiten nga fetë, le të thonë të vërtetën: a kishte qoftë edhe një arsye të vogël fetare për Luftën e II Botërore ku vdiqën me miliona njerëz?



Islami s'mund të konsiderohet përgjegjës për ecurinë e keqe të botës e cila është kthyer në një det gjaku. Përkundrazi, gjendja aktuale e botës, është shkaktuar nga luftërat egoiste dhe për interesa të sistemeve njerëzore si kapitalizmi, socializmi, fashizmi, materializmi, sionizmi, etj.

A kishin Hitleri dhe Mussolini qëllime fetare?

Çfarë feje kishte Stalini, i cili e ngriti pushtetin e vet mbi kokat e mijëra njerëzve? Apo mos vallë ai ishte armiku më i madh i fesë?

Pothuajse që prej dy shekujsh myslimanët janë vazhdimisht në pozitën e viktimës.

Shpëtimi i vetëm edhe i individit, edhe i shoqërisë, është vënia në jetë e Islamit në mënyrë të tërësishme. Fjala "Islam" rrjedh nga rrënja "selam", që do të thotë "paqe". Dhe me të vërtetë që Islami nuk merr për bazë luftën, por paqen dhe sigurinë.

Një tjetër prej pretendimeve të deistëve është se;

E VËRTETA ABSOLUTE NUK EKZISTON!



Armën më të përgjakshme dhe më të pamëshirshme, që është bomba atomike, nuk e kanë prodhuar dhe përdorur fetarët, por shkencëtarët që gjoja ndjekin mendjen dhe arsyen (!) dhe njerëzit që gjoja mbrojnë demokracinë dhe të drejtat njerëzore.

Thonë se;

"Të gjithë njerëzit ndjekin vetëm fenë e shoqërisë dhe prindërve të tyre. Nuk ka asnjë të vërtetë absolute. Gjithkush ka të drejtë sipas mendimit të vet..."

Mirëpo ky mendim është një shtrembërim i madh!

Ky hadith fisnik mund të jetë pika fillestare për t'iu përgjigjur këtij pretendimi:

"Çdo fëmijë lind me natyrë të pastër (në fenë islame). Gjendja e tij vazhdon e tillë derisa fillon të flasë. Më pas (nëse nuk takohet me fenë e vërtetë) prindërit e bëjnë atë jahudi, të krishterë ose adhurues të zjarrit..." (Ebu Daud, Sunnet, 18; Tirmidhi, Kader, 5.)

Profeti ﷺ na bën të ditur shkakun e natyrshëm të faktit që i bën njerëzit të hyjnë lehtë në fenë që gjejnë në shoqëri. Pra, për shkak se besimi është pjesë e natyrës njerëzore, çdokujt i duket më e lehtë të përvetësojë besimin që gjen në familje apo në shoqëri.

Mirëpo në fakt, ky është vetëm shpërdorim i veçorisë që ndodhet në natyrën njerëzore.

Nëse ne myslimanët e realizojmë siç duhet detyrën tonë të kumtimit të fesë, në botë nuk do të mbetet askush që nuk e njeh të vërtetën dhe të drejtën. Për shembull, sahabët e nderuar ishin të vetëdijshëm për këtë dhe, pavarësisht

mundësive të kufizuara të asaj kohe, ata e çuan Islamin në shumë vende të botës. Brenda një kohe shumë të shkurtër, Islami u përhap në lindje, në Kinë dhe Indi, në perëndim, në Gadishullin Iberik (Spanjë), në veri, në Ballkan, Kaukaz dhe tërë Azinë e Mesme dhe në jug, në brendësi të Afrikës dhe Indonezi.

Padyshim se për ata të cilët nuk e kanë mbërritur kumtesën Islame, përgjegjësia është më e vogël. Por, megjithatë, ata janë të detyruar t'i besojnë vetëm një Zoti dhe të mos adhurojnë idhuj.

Mendimtari mysliman, Ibn-i Tufejl, shkroi një libër të quajtur *"Hajj bin Jakzan"*. Tema e këtij libri është gjetja e Zotit nga ana e një fëmije që është rritur i vetëm në një ishull.

Nga ky libër është frymëzuar edhe shkrimtari Daniel Defoe, i cili shkroi librin Robinson Crusoe.



Ata që pretendojnë se luftërat i nxisin fetë, le të thonë të vërtetën; a kishte qoftë edhe një arsye të vogël fetare për Luftën e II Botërore ku vdiqën me miliona njerëz?

Mirëpo;

Sot është ulur ndjeshëm ndikimi i prindërve dhe shoqërisë mbi individin, sepse mundësitë e tjera, si interneti dhe televizioni, nuk mund të përdoren vetëm në aspektin negativ, por edhe në atë pozitiv. Për rrjedhojë, nuk është i paktë numri i njerëzve që e kanë kuptuar të vërtetën dhe janë udhëzuar duke bërë kërkime në internet.

Një vëllai ynë nga Haiti, në anën tjetër të botës, duke bërë një kërkim në lidhje me të drejtat e grave, hasi në një prej librave tanë të përkthyer në anglisht dhe u nderuar me Islam,

duke marrë edhe emrin Davud.[9]

Histori të tilla udhëzimi ka me qindra dhe më të famshmit prej këtyre janë personalitet si Muhammed Ali, Malcom X, Jusuf Islam (Cat Stevens), etj.

Sot myslimanët kanë xhami dhe bashkësi në çdo vend të botës.

Kjo do të thotë se;

Shoqëria, kultura apo familja, nuk janë pengesë për kërkimin dhe gjetjen e së vërtetës.

Ndërkohë, duhet të përmendim edhe këtë fakt:



A kishin Hitleri dhe Mussolini qëllime fetare? Çfarë feje kishte Stalini, i cili e ngriti pushtetin e vet mbi kokat e mijëra njerëzve? Apo mos vallë ishte armiku më i madh i fesë?

Shpesh herë, njerëzit dalin në udhëtime për të fituar prej pasurisë së kësaj bote. Po ashtu, ata shkojnë në vende të tjera edhe thjesht për kureshtje, argëtim, arsimim, etj.

Pra, a nuk duhet që njeriu të përpiqet edhe për të kërkuar fenë e vërtetë? Mos vallë, a është kusht që e vërteta t'i vijë patjetër prej shoqërisë dhe prindërve të vet?

Në çfarëdolloj kushtesh të jetojë, njeriu duhet të meditojë dhe të përpiqet t'i përgjigjet këtyre pyetjeve:

- Përse ka ardhur njeriu në këtë botë?

- Në pronën e kujt jeton?

- Cili është shkaku i krijimit i të gjithë këtij universi?

Këtë të vërtetë njeriu duhet ta gjejë kudo që të jetë!

9. Për më tepër mund të lexoni intervistën e zhvilluar me vëllain ton prej Haitit, të botuar në Revistën Yuzaki. «Haiti'den Eyüp'e Bir Hidâyet Hikâyesi», sa: 147; (2017, Mayıs) s. 26-30.

Nga ana tjetër;

Edhe ata që kanë lindur si fëmijë të dy prindërve të devotshëm brenda një shoqërie Islame, duhet ta falënderojnë pamasë Allahun e Madhëruar për këtë mirësi të madhe.

Shohim se;

Edhe një njeri që jeton mes të krishterëve apo budistëve, mund ta zgjedhë Islamin, ndërkohë që dikush tjetër që jeton rrëzë xhamisë, mund të jetë ateist. Nisur nga kjo, mund të thuhet se sot, në çështjen e besimit, më tepër ndikon vullneti personal sesa shoqëria.

Domethënë;

Islami duhet kumtuar me anë të një personaliteti shembullor dhe duhet përçuar në çdo formë, tek çdo zemër, afër apo larg qoftë, me qëllim që të privuarit të vrapojnë gjithmonë drejt udhëzimit...



Në çfarëdolloj kushtesh të jetojë, njeriu duhet të meditojë dhe të përpiqet t'i përgjigjet këtyre pyetjeve: - Përse ka ardhur njeriu në këtë botë? - Në pronën e kujt jeton? - Cili është shkaku i krijimit të gjithë këtij universi?

Pra, duke u mbështetur në cilësinë "el-Hadi / Udhëzuesi", të Allahut të Madhëruar, duhet të përpiqemi vazhdimisht të bëhemi shkak i udhëzimit të shumë zemrave që nuk e kanë gjetur ende të vërtetën.

Allahu i Madhëruar na ndihmoftë të jetojmë përherë të udhëzuar dhe të bëhemi shkak i udhëzimit të të tjerëve...!

Amin!..



METODA E PREDIKIMIT

Me qëllim që njerëzit të udhëzohen,
Allahu i Madhëruar ka urdhëruar që gjatë predikimit
të fesë të përdoret "kaulen lejjina / gjuha e butë".
Lidhur me metodën e predikimit të bukur të fesë,
në Kuranin Fisnik urdhërohet:

اُدْعُ اِلٰى سَبِيلِ رَبِّكَ بِالْحِكْمَةِ وَالْمَوْعِظَةِ الْحَسَنَةِ وَجَادِلْهُمْ بِالَّتِى هِىَ اَحْسَنُ

"Thirr në rrugën e Zotit tënd me mençuri
dhe këshillë të bukur dhe diskuto me ata në mënyrën
më të mirë!.." (Nahl, 125.)

Kjo është një përpjekje për të fituar zemrat.



METODA E PREDIKIMIT

Në këtë vepër, jemi përpjekur të shpjegojmë se çfarë është deizmi, si lindi ai, shkaqet materiale e shpirtërore dhe t'u përgjigjemi pyetjeve që bëhen për të turbulluar mendjet e njerëzve.

Në bazë të parimit të besimit;

"Vepra, nuk është pjesë e besimit."

Pra, mangësitë në vepra, gjynahet dhe braktisja apo neglizhenca e farzeve, edhe pse e dëmtojnë shumë aspektin shpirtëror të njeriut, nuk e shkatërrojnë besimin dhe nuk e çojnë njeriun drejtpërsëdrejti në mohim.

Por, nëse ky arsyetim e shpie njeriun në ekstrem, pra nëse përvetëson rrugën e "fraksionit Murxhie", që ishin aq liberalë dhe të vakët sa thoshin se *"nëse njeriu beson, atë nuk*

e dëmtojnë gjynahet dhe ai nuk do të dënohet për to", atëherë le ta dijë se kjo rrugë të çon në humbje.

Njerëz të tillë të shkujdesur duhen udhëzuar dhe duhet kërkuar një damar për të hyrë në shpirtin e tyre.

Nëse një gjilpërë injektohet pa u gjetur damari i duhur, ajo shkakton dëme në trup. Por, nëse ajo injektohet në damarin e duhur, atëherë trupi mund të shërohet. Në të njëjtën mënyrë, nëse të vërtetat injektohen tek njeriu, duke gjetur damarin e duhur të shpirtit dhe zemrës së tij, atëherë mund të arrihet shërimi shpirtëror dhe udhëzimi.



Për të udhëzuar njerëzit, duhet kërkuar një damar për të hyrë në shpirtin e tyre. Nëse një gjilpërë injektohet pa u gjetur damari i duhur, shkakton dëme në trup, por nëse ajo injektohet në damarin e duhur, atëherë trupi mund të shërohet. Në të njëjtën mënyrë, nëse të vërtetat injektohen tek njeriu, duke gjetur damarin e duhur të shpirtit dhe zemrës së tij, atëherë mund të arrihet shërimi shpirtëror dhe udhëzimi.

Për shembull;

Xhaferi ﷺ pati mundësinë të kumtonte Islamin në Etiopi para mbretit Nexhash. Kur iu kërkua të këndonte diçka prej Kuranit, ai gjeti damarin e duhur që do të shkonte në zemrat e atyre njerëzve të krishterë dhe lexoi ajetet në suren Merjem, të cilat bëjnë fjalë për lindjen e mrekullueshme të Isait عليه السلام. Për rrjedhojë, Nexhashi u prek shumë dhe, sipas transmetimeve, ai e pranoi menjëherë Islamin.

Xhaferi ﷺ mund të këndonte edhe ajete që u drejtohen jomyslimanëve, të cilat përmbajnë shprehje kërcënuese. Mirëpo, a do të kishin të njëjtin ndikim?

Pra, ftuesi në Islam duhet të jetë i zgjuar dhe largpamës. Ai duhet ta

fillojë punën e tij të kumtimit të fesë prej një pike të përbashkët, duke e bërë bashkëbiseduesin e tij të meditojë mbi fuqinë dhe madhështinë e Allahut të Madhëruar.

Për këtë arsye;

Mposhtja e çdo lloji të mohimit të Allahut dhe akuze, qoftë në aspektin intelektual, qoftë në atë shkencor dhe fetar, është detyra jonë si myslimanë. Mirëpo, ndërkohë, nuk duhet përdorur gjuhë etiketuese dhe cilësuese në formë negative, duke vënë në shënjestër drejtpërsëdrejti njerëzit e paditur që kanë rënë në këto gjynahe. Hedhja poshtë e mendimeve të gabuara është e drejtë, ndërsa poshtërimi i personalitetit të njerëzve nuk është aspak e drejtë.



Edukimi kërkon durim dhe palëkundshmëri. Është e pamundur ta bësh një rrjedhë uji të ngjitet në majën e një kodre që i del përpara! Mirëpo, është e mundur ta bësh të rrjedhë përreth tij. Rruga mund të duket e gjatë dhe e vështirë, por të çon drejt synimit.

Pra;

Nuk duhet ta detyrosh tjetrin të thotë: *"meqë mospraktikimi i fesë qenka deizëm, atëherë edhe unë jam deist!"*

Myslimani duhet të vazhdojë detyrën e udhëzimit, të marrë masat shpirtërore, të lutet dhe të jetë i mbushur me shpresë.

Madje;

Kur të ftohen në bindjen ndaj rregullave fetare dhe adhurim, ata që për shkak të paditurisë i kanë hapur derën propagandave deiste ose janë kapluar nga dëshirat dhe kënaqësitë moskokëçarëse të rinisë duke thënë: *"unë u bëra deist!"*, duhet bërë kujdes i madh në qasjen ndaj tyre.

Dihet se;

Vitet e rinisë janë të mbushura me energji. Prandaj, nëse kjo energji nuk vlerësohet, kjo moshë shkon drejt një lloj çmendurie. Nuk duhet anashkaluar edhe fakti se disa të rinj nuk veprojnë me gjithë zemër, por reagojnë për shkaqe emocionale. Pra, kjo gjendje e tyre është relative. Për rrjedhojë, nëse kjo gjendje bëhet e vazhdueshme për shkak të ndonjë reagimi të ashpër nga ana e edukuesit, kjo tregon pakujdesi të madhe në edukim.

Mënyra më e mirë është të zhvillohen biseda dhe aktivitete që i bëjnë të meditojnë dhe të thellohen.

Edukimi kërkon durim dhe palëkundshmëri. Është e pamundur ta bësh një rrjedhë uji të ngjitet në majën e një kodre që i del përpara. Mirëpo, është plotësisht e mundur ta bësh atë të rrjedhë përreth saj. Rruga mund të duket e gjatë dhe e vështirë, por padyshim që të çon drejt synimit.



Profeti ﷺ, që është shembulli më i bukur për ne, gjatë gjithë jetës së tij u ka folur të njerëzve për besimin. Ai fliste gjithmonë me idhujtarët dhe njerëzit e paditur dhe u shpjegonte atyre Islamin kudo që ishte, në panaire, gjatë kohës së haxhit, në oborrin e xhamisë, në rrugët e vështira të Taifit, etj.

Përballja me fjalë që shprehin mohim, i duket e rëndë një njeriu që është rritur në një shoqëri Islame dhe gëzon besim të shëndetshëm.

Mirëpo nuk duhet harruar se;

Profeti ﷺ, që është shembulli më i bukur për ne, gjatë gjithë jetës së tij u ka folur njerëzve për besimin. Ai fliste gjithmonë me idhujtarët dhe njerëzit e paditur dhe u shpjegonte atyre Islamin kudo që ishte, në panaire, gjatë kohës së haxhit, në oborrin e

xhamisë, në rrugët e vështira të Taifit, etj. Ai u lexonte Kuran dhe u bënte të ditura ajetet e tij. Dikujt që nuk e pranonte ekzistencën e botës tjetër, i dha si shembullin më të bukur ringjalljen e tokës në pranverë pas një dimri të ftohtë. Ai e predikonte fenë në çdo moment, me veprat e tij, fjalët dhe çdo gjë tjetër.

Nëse ne e jetojmë Islamin me dinamizëm, sinqeritet, devotshmëri, dashuri dhe pasion, me lejen e Allahut, do të bëhet e mundur që pishtari i dashurisë për fenë të ndizet edhe në zemrat e fëmijëve, nxënësve dhe atyre që na rrethojnë.

Besimi është vepra e zemrës dhe për ta bërë zemrën të dëgjojë, nuk mjaftojnë vetëm shpjegime logjike.

Atyre u bëhen pyetje që u turbullojnë mendjen.



Profeti ﷺ, u lexonte Kuran dhe u bënte të ditura ajetet e tij. Dikujt që nuk e pranonte ekzistencën e botës tjetër, i dha si shembullin më të bukur, ringjalljen e tokës në pranverë pas një dimri të ftohtë. Ai e predikonte fenë në çdo moment, me veprat e tij, fjalët dhe çdo gjë tjetër.

Ndërsa ne duhet t'u bëjmë pyetje shpirtërore që do t'u lëvizin ndërgjegjen dhe do t'u gjallërojë ndjenjat:

PYETJE QË PRESIN PËRGJIGJE

- Kur shikon botën e gjallesave, a nuk e ndjen se ndryshon prej tyre?

- A nuk të zgjon asnjë fije dyshimi në zemrën tënde gënjeshtra se, gjoja qenia e mrekullueshme e quajtur njeri është krijuar në saje të miliona proceseve të rastësishme njëra pas tjetrës?

- A e pranon zemra jote se dallimi tek njeriu qëndron vetëm në aspektin biologjik dhe në zhvillimin e trurit?

- A nuk e mendon fare jetën? A nuk të shkon fare në mendje se ardhja në këtë botë dhe ikja prej saj duhet të ketë një shkak dhe një qëllim? A është gjithçka ashtu rastësi?

- Mbase para pesëmijë vitesh njerëzit kanë qenë pesëgjashtë milionë. Mirëpo, sipas një statistike të kryer në vitin 1915, popullsia e botës kishte arritur 1.5 miliardë banorë. Ndërsa tani është mbi 7 miliardë. Përveç njerëzve, ka edhe shumë gjallesa të tjera, të cilat arrijnë një numër të paimagjinueshëm. Të gjitha këto gjallesa, përfshirë njeriun, kanë nevojë për furnizim, dhe të gjitha furnizohen pandërprerje, qoftë edhe për një moment. Kush e siguron furnizimin e gjithë këtyre qenieve të ndryshme dhe të panumërta? E mbi të gjitha, kush e ndan atë furnizim në mënyrë aq të përsosur? A nuk duhet të mendojmë qoftë edhe pakëz më me arsye?



Nëse në një skenë luhen dy pjesë të ndryshme, ato do të ngatërrohen me njëra-tjetrën. Por shiko skenën e kësaj gjithësie! Në një vend luhen me miliona pjesë të ndryshme pa u ngatërruar aspak me njëra-tjetrën. A ke menduar ndopak, si është e mundur kjo?

- Allahu i Madhëruar përgatit llojlloj mirësish për çdo stinë sipas vendeve të ndryshme, duke mos e lënë të uritur as njeriun që gjendet në pole, as atë në ekuador, e as të në shkretëtirë. Allahu i Madhëruar, për stinën e verës ka krijuar fruta që shuajnë etjen, si shalqiri, bostani, etj. Ndërsa për stinën e dimrit ka krijuar fruta që plotësojnë nevojat e asaj stine me vitaminë C, si portokalli, mandarina, limoni, etj. A nuk duhet menduar mbi urtësinë e këtyre dhuratave dhe a nuk duhet të falënderohet për to?

- Mendo rënien e borës! Ajo e mbulon tokën me një apo dy metra dhe bëhet si një batanije për shumë krijesa. E kur bora shkrin, ne nuk përballemi me kufoma gjallesash. Pra, kush është ai që i mbron gjallesat me një mbështjellje të tillë të veçantë?

- Ajo reshje dëbore si një fustan nusërie, i jep prehje shpirtit. Po sikur të binte e zezë si katrani ose e kuqe si gjaku, sa rëndë do t'i vinte shpirtit tonë?

- Kush e ka krijuar gjithë këtë univers dhe gjithë këtë sistem për të mbështetur posaçërisht jetën njerëzore, të cilën edhe vetë shkencëtarët e quajnë "parimi antropik"?



A kishe njohuri për këtë botë para se të vijë në të? Tani do të shkosh në botën e varrit, në lidhje me të cilën nuk ke asnjë dëshmi. Si do të jetë gjendja jote atje? Po sikur të shkosh i papërgatitur, e të pësosh?

Për shembull;

- A ke menduar ndonjëherë për nivelin preciz të Azotit (77%) dhe Oksigjenit (21%) që gjendet në ajër?

- A shqetësohet dhe shëtit ndokush me bombol oksigjeni pranë vetes nga frika se mos bie niveli i oksigjenit?

- A nuk është besim ndaj një fuqie hyjnore kjo siguri të cilën e ndjejnë edhe jobesimtarët?

- A kishe njohuri për këtë botë para se të vije në të? Tani do të shkosh në botën e varrit, në lidhje me të cilën nuk ke asnjë dëshmi. Si do të jetë gjendja jote atje? Po sikur të shkosh i papërgatitur?

- Nëse në një skenë luhen dy pjesë të ndryshme, ato do të ngatërrohen me njëra-tjetrën. Por shiko skenën e kësaj gjithësie! Në një vend luhen me miliona pjesë të ndryshme pa

u ngatërruar aspak me njëra-tjetrën. A ke menduar ndopak, si është e mundur kjo?

- Nëse je pronari i një biznesi, u kërkon llogari punëtorëve të tu qoftë edhe për një mangësi të vogël! Po Allahu i Plotfuqishëm, i Cili të ka krijuar prej asgjësë, a nuk do të pyesë fare për jetën dhe mirësitë që të ka dhënë?


"O njeri, ç'të mashtroi ty që nuk i besove Zotit tënd bujar, i Cili të krijoi ty, të dha përmasa të rregullta dhe të harmonizoi dhe, që të ka mbrujtur në çfarëdo forme që ka dashur?!" (Infitar, 6-8.)

- Lexon dhe rend pas dijes? Por, a e di se cili është arsimimi yt i vërtetë? A mund të ndjehesh i kënaqur prej një arsimi që nuk të njeh me kuptimin dhe qëllimin e ekzistencën tënde?

A e kupton se arsimi yt kryesor është bindja ndaj urdhrit hyjnor;

اِقْرَاْ بِاسْمِ رَبِّكَ الَّذِى خَلَقَ

"Lexo me emrin e Zotit tënd që krijon!" (Alak, 1), të lexosh madhështinë e Allahut, ta njohësh Atë me zemër dhe të jetosh përherë si falënderues për mirësitë e Tij! A e bën ti një lexim të tillë?



Lexon dhe rend pas dijes. Por, a e di se cili është arsimimi yt i vërtetë? A mund të ndjehesh i kënaqur prej një arsimi që nuk të njeh me kuptimin dhe qëllimin e ekzistencën tënde?

- A ka kulturë më të madhe dhe më gjithëpërfshirëse se kultura Islame? A ka ndonjë sistem tjetër që mund të sjellë paqe dhe rregull në çdo fazë të jetës, ashtu siç mund të bëj Islami?

- Çfarë është vdekja? Asgjësim?



A e kupton se arsimi yt kryesor, është t'i bindesh urdhrit hyjnor; "Lexo me emrin e Zotit tënd që krijon!" (Alak, 1.), të lexosh madhështinë e Allahut, ta njohësh Atë me zemër dhe të jetosh përherë si falënderues për mirësitë e Tij? A e bën ti një lexim të tillë?

Çfarë mund të thotë deizmi për vdekjen dhe për çka vjen përtej saj? Në lidhje me vdekjen dhe kohën përtej saj na ka njoftuar vetëm Allahu i Madhëruar, i Cili di çdo gjë, dhe profetët të cilëve u është dhënë një dije e pjesshme nga e Tij.

- A duhet të mbetet padrejtësia pa u ndëshkuar? Apo duhet që një ditë drejtësia të vihet në vendin e vet? Si mendon?

- A nuk është shumë teorik pretendimi se mendja mund t'i tregojë rrugën njeriun në mënyrë absolute? A ka ndonjë shembull për këtë? A e ndihmoi mendja Aristotelin përballë presioneve të Aleksandrit? A mundën të zgjuarit që shpikën bombën atomike ta ruanin atë prej duarve të mizorëve që e hodhën mbi njerëzit e pafajshëm?

- A i ke lexuar ndopak biografitë e filozofëve? A e di se jetët e shumë prej atyre adhuruesve të mendjes që tentuan të sistemojnë botën, janë të mbushura me kontradikta, imoralitete, vetëvrasje, paturpësi dhe shumë krime të tjera? Si mund ta ndihmojë njerëzimin një mendje që nuk mund t'i bëjë dobi vetes?

- Kur do ta kuptosh se mendja është si një thikë me dy presa, e cila mund të përdoret edhe për mirë, edhe për keq?

- Mendo për bazën e moralit. A është i mundur morali pa fenë e vërtetë?


- A është e mundur që i gjithë njerëzimi të jetë dakord

me normat morale të vendosura nga mendja njerëzore? E çfarë dobie ka për njerëzimin një sistem i përzierë mbi të cilin s'mund të ketë dakordësi?

- Përse kapitalistët, të cilët premtuan paqe, për hir të parasë thonë: "lërini të veprojnë, lërini të kalojnë", duke konsideruar të lejuar çdo lloj paturpësie dhe duke pasuruar koorporatat gjakpirëse?

- Ku është bollëku, paqja dhe lumturia që premtuan kapitalistët? Mirëqenie, rehat dhe pasuri vetëm për një grusht njerëzish, ndërsa të tjerët le t'i zemërohen fatit! Kështu?! Ah ndërgjegje të kthyera në ngjyrë katrani!

- Komunistët erdhën me premtimin për barazi dhe themeluan pushtetin mbi miliona jetë. Por, pse më pas pasuruan vetëm një grusht partiakësh?



A ka kulturë më të madhe dhe më gjithëpërfshirëse se kultura Islame? A ka ndonjë sistem tjetër që mund të sjellë paqe dhe rregull në çdo fazë të jetës ashtu siç mund të bëj Islami?

- A ka ngelur tek njerëzit sadopak shpresë tek kapitalizmi dhe komunizmi?

- A ka ndonjë sistem tjetër përveç Islamit, që arrin të sigurojë një transferim të konsiderueshëm të pasurisë nga i pasuri tek i varfri, si zekat, dhurim, sadaka, fitre, vakëf, shpagim dhe përgjegjësi të tjera fetare të ngjashme, duke e bërë këtë me dashuri për adhurimin, e jo me dhunë?

- Aborti për shembull për shumë mendje dhe sisteme të bazuara në një mendje të paskrupullt, është e drejtë dhe liri zgjedhjeje!.. Morali i një mendjeje që e konsideron të drejtë vrasjen!..



Ekzistojnë shumë vepra hyjnore, të cilat njeriu është i paaftë t'i imitojë. Për shembull, një dele apo një lopë; ato hanë bar, pinë ujë dhe japin qumësht! Le të ngrejë njeriu një fabrikë me teknologjinë më të përparuar dhe të prodhojë qumësht të njëjtë prej barit dhe ujit! S'është e mundur!

- A mund ta lejosh vrasjen e një fëmije (në bark të nënës) të cilit i rreh zemra, vetëm se nëna nuk e do? A mund ta pranojë ndërgjegjja jote këtë krim? Islami nuk e lejon, por mendja moderne po!.. A do ta pranoje këtë, nëse ai fëmijë do të ishe ti?

- Ja pra, kjo është mendja që në emër të lirisë i hap rrugën, e madje i nxit perversitetet seksuale, të cilat e shkatërrojnë rrënjësisht institucionin familjar!..

- Ja edhe pesë vendet me të drejtë vetoje në OKB, të cilat mbrojnë padrejtësitë e vendeve që dëshirojnë t'i favorizojnë për interesat e veta. Të gjithë këta drejtues, kanë mendësi materialiste, humaniste, kapitaliste, ose socialiste...

- Deist, kapitalist, shekullarist... A të duket e ndritur e ardhmja e sistemit të kësaj bote?

- Duke filluar prej shkatërrimit të natyrës e deri tek speciet e rrezikuara nga zhdukja, tek armët e shfarosjes në masë, padrejtësitë dhe kolonizimet; a nuk janë të gjitha këto veprat e një bote të mbështetur në mendje dhe shkencë?

- Si ta ruajmë mendjen nga çmenduria dhe barbaria?

- Nëse i rivlerësojmë vlerat familjare dhe njerëzore të perëndimit pa u ndikuar nga forca e tyre teknologjike dhe materiale, a mund të themi se kanë ndonjë aspekt për t'u marrë shembull?

- Duke u nisur nga bollëku, rehatia dhe komoditeti; kush

ka qenë më i qetë dhe më i lumtur, njeriu i djeshëm, apo njeriu i sotëm? Po, pavarësisht këtyre, ja ku janë vendet fatkeqe, të vuajtura, të robëruara dhe të vetmuara nën kthetrën e ndërgjegjeve të verbra e të shurdhëta!

- A je i qetë shpirtërisht kur sheh padrejtësitë që po ndodhin sot në Egjipt, Siri, Palestinë, Jemen dhe Mjanmar? A të vret ndopak ndërgjegjja?

- Një aksident në rrugë, një turbulencë në aeroplan, një tërmet... Një moment të tillë e ke përjetuar me patjetër. Çfarë është ai tmerr dhe frikë që përjeton në atë moment? Në një moment të tillë, a e ke ndjerë dëshirën për t'iu lutur dhe kërkuar ndihmë një qenieje që ka fuqi për çdo gjë, apo jo?

- A e di se vdekja dhe çka vjen përtej saj, do të shkaktojnë tronditje më të tmerrshme dhe më të gjata se këto?

- Mendo pak për ata që të kështillojnë për moskokëçarje dhe devijim në çështjet e fesë dhe besimit. A do të të ndihmojnë ata në çastet e tmerrshme në botën tjetër?



O ti që thua se je deist; - A ke menduar ndonjëherë për pafundësinë? - Xheneti apo Xhehenemi i pafundmë? - A ja vlen ta djegësh përjetësinë në botën tjetër për tre ditë qejf në këtë botë?

- Fjala e kujt duhet dëgjuar në lidhje me botën tjetër?

- Profeti ﷺ, shkoi tek Allahu në vitin 632. Mirëpo, ai na ka lënë hadithe në të cilat përshkruhen ditët e sotme. Kështu që, a është e drejtë të mos i besojmë lajmet për botën tjetër që na ka sjellë ky profet?

- Mollët e kalbura dhe të shëndosha nuk mund të pranohen njësoj. Thjeshtë, do të ishte një gabim logjik. Atëherë, me cilën logjikë mund ta konsiderojmë një fe të prishur të

barabartë me Islamin që nuk është prishur aspak dhe është e vetmja fe e vërtetë?

- A je i sigurt se ke njohuri të mjaftueshme në lidhje me Islamin?

- A është e drejtë të formosh një mendim pa pasur njohuritë e duhura në lidhje me një çështje?

- Nëse mendon se ke njohuri dhe dije, nga cilat burime i ke përfituar? A të sigurojnë dije të vërtetë informacionet false dhe shpifëse?



A e di se të gjitha adhurimet dhe rregullat që Allahu i Madhëruar kërkon që ne të zbatojmë në këtë botë, janë për të mirën dhe dobinë tonë?

- **O ti që thua se je deist;**

- A ke menduar ndonjëherë për pafundësinë?

- Shpërblim ose ndëshkim i pafundmë?

- A ja vlen ta djegësh përjetësinë në botën tjetër për tre ditë qejf në këtë botë?

- A e di se të gjitha adhurimet dhe rregullat që Allahu i Madhëruar kërkon që ne të zbatojmë në këtë botë, janë për të mirën dhe dobinë tonë?

- Kur një i ri përpiqet të zgjedh universitetin ku do të vazhdojë studimet, mendon gjatë e gjerë, duke thënë: "vallë a po zgjedh atë që duhet?" Po ti, a je i sigurt se ke menduar mjaftueshëm në lidhje me vendimet dhe zgjedhjet që ke bërë për jetën e përjetshme? Apo mos ndoshta edhe ti shkon pas shumicës?

- A mendon njeriu se ka mundësi të lihet në qejf të vet në këtë botë, ku çdo gjë, që prej grimcës më të vogël e deri tek trupi më i madh, është në një ekuilibër të përsosur dhe asgjë nuk është lënë jashtë kontrollit?

- Mendo se çfarë kaosi do të shkaktohej në ekuilibrin ekologjik të kësaj bote nëse, krijesat, mundësitë dhe mirësitë që janë vënë në dispozicionin tonë nga Allahu i Madhëruar me qëllim që të përfitojmë prej tyre dhe të meditojmë, nuk do të ishin në shërbimin tonë, por do të vepronin të gjitha në kokë më vete, pa asnjë kontroll! Asnjë gjallesë nuk do të kishte mundësi jete. Çdo gjë do të shkatërronte përnjëherë njëra-tjetrën dhe universi do të kthehej në gërmadhë. Mirëpo, hapi sytë dhe shih se si universi funksionon brenda një harmonie madhështore!..

- Nuk humbet asgjë nëse mendon pak se çfarë kërkon të thotë ky ajet fisnik:

"Mos vallë, keni menduar që Ne ju kemi krijuar kot dhe që nuk do të ktheheshit te Ne (për t'ju gjykuar)**?!"** (Mu'minun, 115)



Ditën kur të dalësh para Zotit tënd; a do të mund të gjesh një justifikim për faktin që e ke mohuar Atë, ke përgënjeshtruar profetët e tij, nuk i ke lexuar librat që ka zbritur Ai dhe që nuk i ke marrë ato si udhëzues për veten?

- E kush mund ta dijë me siguri se Allahu nuk ndërhyn në çështjet e gjithësisë pasi e ka krijuar atë? A ka ndonjë provë për këtë?

- Nëse thua se gjithësia funksionon sipas disa ligjeve fizike, atëherë kush i ka vendosur ato ligje? A i ka zbuluar shkenca të gjitha ligjet fizike që të mund të jetë absolutisht e sigurt se gjithçka në univers funksionon vetëm sipas atyre ligjeve?

- E në fakt, dihet se në fizikën kuantike ekzistojnë disa pika që nuk mund të shpjegohen me marrëdhëniet shkak-pasojë dhe nuk mund të përcaktohen sipas ligjeve fizike. Për

rrjedhojë, a është e drejtë të pretendosh se Allahu nuk ndërhyn në funksionimin e gjithësisë?

- Po ndërhyrjen e pashpjegueshme nga ligjet fizike të një caktimi/kaderi hyjnor në rrjedhën e ndodhive sociale, në jetën tënde personale dhe në historinë e popujve, a nuk e sheh?

- Ditën kur të dalësh para Zotit tënd, a do të mund të gjesh një justifikim për faktin që e ke mohuar Atë, ke përgënjeshtruar profetët e tij, nuk i ke lexuar librat që ka zbritur Ai dhe që nuk i ke marrë ato si udhëzues për veten?

- Nëse ke parasysh Xhenetin që të ka premtuar, a mendon se janë shumë ato detyra që Allahu i Madhëruar ka kërkuar prej teje në jetën e shkurtër të kësaj bote?



Mendo se çfarë kaosi do të shkaktonte në ekuilibrin ekologjik të kësaj bote nëse krijesat, mundësitë dhe mirësitë që janë vënë në dispozicionin tonë nga Allahu i Madhëruar me qëllim që të përfitojmë prej tyre dhe të meditojmë, nuk do të ishin në shërbimin tonë, por do të vepronin të gjitha në kokë më vete pa asnjë kontroll!

Mendo për këto pyetje dhe kërko përgjigjen!

Këto janë pyetjet e vërteta që presin përgjigje prej teje. Nëse ia mbyll gojën egos dhe orientohesh drejt urdhrave të Allahut të Madhëruar me shpirt e me zemër, do të shohësh se çfarë paqeje dhe lumturie do të sjellë feja e vërtetë në zemrat tona. Paqartësitë do të zhduken dhe do të ndriçohesh.

Paqja qoftë mbi ata që ndjekin udhëzimin në rrugë të drejtë!..



FJALA E FUNDIT NUK LYHET DIELLI ME BALTË!

Gjendja e ateistëve dhe deistëve
i ngjan humbjes së diellit në mes të ditës.
Personi që ka rënë në indiferencë
i ngjan anijes që i është thyer timoni
në mes të oqeanit dhe nuk dihet se
në cilën vorbull do të mbytet.



(FJALA E FUNDIT)

NUK LYHET DIELLI ME BALTË!

Edhe një e vërtetë e thjeshtë mund të kuptohet vetëm pasi të jetë analizuar në të gjitha aspektet e saj.

Përndryshe;

Nëse një e vërtetë që ka njëqind aspekte analizohet vetëm në tre prej tyre, e më pas thua se e ke parë, e ke njohur dhe e ke kuptuar atë, duke bërë interpretime, duke dhënë gjykime dhe vendime në bazë të saj, do të thotë vetëm largim prej asaj të vërtete dhe mashtrim i vetvetes. E për më tepër, të kërkosh paqe në këtë vetëmashtrim idiot, të kërkosh një të ardhme të ndritur dhe të shpresosh për mirëqenie në të, nuk është asgjë tjetër veçse një humbje brenda një dizekuilibri të çuditshëm.

Ky është edhe i tërë ngërçi, nyja dhe dredhia e ateizmit dhe deizmit;

Pra, të tentosh të bësh hije me errësirë mbi të vërtetën e qartë si dielli, duke prodhuar pika qorre... Të mos i shohësh faktet e panumërta në të vërtetën dhe të fokusohesh vetëm në disa aspekte që i shkojnë përshtat fiksimeve... Të përpiqesh të ngushtosh sipas qejfit kalimtar një gjerësi të tërë, me qëllim që ta groposësh atë në një idiotësi të kotë...



Frojdi dhe filozofë të tjerë të ngjashëm, e kanë interpretuar jetën duke analizuar vetëm një aspekt të saj dhe duke e konsideruar atë si të vetmin aspekt të jetës. Në këtë mënyrë, janë anashkaluar shumë të vërteta, duke i hapur rrugën shumë mendimeve të devijuara dhe perverse.

E pamundur!

A mund të lyhet dielli me baltë?

Sidomos të vërtetat, urtësitë dhe ajetet hyjnore, që janë më të qarta se dielli, nuk mund të përbalten në asnjë mënyrë.

Në përgjithësi, e vërteta kuptohet duke e analizuar nga të gjitha anët. Por ndonjëherë, as kjo nuk mjafton për ta kuptuar siç duhet një të vërtetë.

Metoda më e mirë për të kuptuar një çështje, nuk është të eliminosh sa më shumë aspektet që duhen analizuar, por t'i shtosh ato sa më shumë të jetë e mundur.

Për shembull;

Frojdi dhe filozofë të tjerë të ngjashëm, e kanë interpretuar jetën duke analizuar vetëm një aspekt të saj dhe duke e konsideruar atë si të vetmin aspekt të jetës. Në këtë mënyrë, janë anashkaluar shumë të vërteta, duke

i hapur rrugën shumë mendimeve të devijuara dhe perverse.

Mirëpo, mendimi Islam asnjëherë nuk i analizon çështjet në mënyrë të njëanshme, sepse Islami përfshin çdo të vërtetë dhe fazë të jetës. Për këtë arsye, Islami është rruga e paqes dhe e shpëtimit në të dyja botët.



Mendimi Islam, asnjëherë nuk i analizon çështjen në mënyrë të njëanshme, sepse Islami përfshin çdo të vërtetë dhe fazë të jetës. Për këtë arsye, Islami është rruga e paqes dhe shpëtimit në të dyja botët.

Sepse;

Të ndërrosh të vërtetat me iluzione të shpikura, nuk e çon njeriun në asnjë vend, por e mbyt atë në mbeturinat e dështimit ku është zhytur.

Për këtë arsye;

Çdo llogari duhet bërë pa anashkaluar dhe pa errësuar asnjë aspekt. Të bësh llogari duke u fokusuar vetëm në një pikë dhe duke i mbyllur sytë ndaj pikave të tjera, të çon drejt falimentimit të mendjes, jetës, të tashmes dhe të ardhmes. Kjo nuk është gjë tjetër veçse vetëvrasje, ku fajtor është vetë ai që ka rënë në këtë gjendje të mjeruar.

Është njësoj sikur një tregtar t'i bëjë llogaritë pa marrë parasysh të gjitha aspektet e punës dhe të anashkalojë të gjitha shifrat. Kjo gjë, padyshim do ta çonte atë drejt falimentimit.

Prandaj;

Njerëzit më ateistë dhe më deistë asnjëherë nuk veprojnë me mendjen e tyre në tregti. Me qëllim që të fitojnë sa më shumë, ata përqendrohen në çdo gjë, pa neglizhuar asnjë pikë dhe asnjë shifër. Kështu veprojnë edhe në mjekësi.

Për shembull;

Tek një pacient, para së gjithash, me patjetër do të evidentojnë shkakun e sëmundjes. Përndryshe, diagnoza do të jetë e gabuar dhe kura do të dështojë. Për këtë arsye, në fillim kërkojnë shkakun, e gjejnë atë dhe e shpjegojnë. Më pas thonë se shërimi mund të realizohet vetëm me kurë dhe ilaçe, duke e vërtetuar këtë me shumë argumente. Pra, ata kapen pas shkakut, e gjejnë atë dhe e shpjegojnë më së miri. Kjo metodë vlen edhe për një puçërr të thjeshtë.

Mirëpo, kur vjen puna të flasin për gjithësinë dhe, në veçanti për njeriun i cili është një prej krijesave më madhështore të Allahut, ata ngulin këmbë se të gjitha janë rastësore dhe pa asnjë qëllim. E çfarë mund të thuash për këtë absurditet qesharak?



A mund të lyhet dielli me baltë? Sidomos të vërtetat, urtësitë dhe ajetet hyjnore, që janë më të qarta se dielli, nuk mund të baltosen në asnjë mënyrë.

Në fakt;

Ky qëndrim pa përllogaritje matematike, pa logjikë dhe pa mençuri, e indiferentëve që përpiqen vazhdimisht të përparojnë teknologjikisht në saje të matematikës, është rezultat i pavlerë i përpëlitjeve, me mendimin: *"si vallë mund të shpëtoj nga përgjegjësitë e mia në këtë botë?"*.

A nuk mendojnë se;

Si katandiset bota kur njeriu ikën prej përgjegjësisë që i ka ngarkuar Allahu? Si katandiset vetë ai?

Historia e njerëzimit dihet. Çdo lloj shembulli është treguar me miliona herë, akoma tregohet dhe do të vazhdojë të tregohet. E vërteta e pandryshueshme dihet:



T'i ndërrosh të vërtetat me iluzione të shpikura, nuk e çojnë njeriun në asnjë vend, por e mbysin atë në mbeturinat e dështimit ku është zhytur.

Sa herë që njeriu i hedh përtokë përgjegjësitë që i janë ngarkuar dhe largohet prej tyre, ai e hedh veten në mes të barbarizmave, fatkeqësive dhe dështimeve. Padrejtësitë, vrasjet, mizoritë, gjenocidet dhe shumë e shumë të këqija të tjera, janë rezultat i kësaj indiference. Gjithmonë, për shkak të këtij absurditeti, në botën njerëzore nuk mbetet as paqe e as vetëdije... bota dhe njeriu shkatërrohen plotësisht. Ndërsa udhëtimi i përjetshëm përfundon mes dhimbjeve të mëdha.

Mirëpo;

Sa herë që njeriu është i vetëdijshëm për përgjegjësitë që ka dhe i del zot atyre, edhe vuajtjet më të tmerrshme të kësaj bote të përkohshme, kthehen në lumturi dhe shumë udhëtime të përjetësisë finalizohen me Xhenet.

Për rrjedhojë;

E gjithë çështja është: të mund ta shohësh të vërtetën me të gjitha aspektet e saj dhe ta kuptosh ashtu siç duhet.

Pra;

Duhet të përqendrohesh siç duhet tek pyetjet: *"Pse jemi krijuar? Nga kemi ardhur, për ku dhe pse po shkojmë? Si duhet të përgatitemi për baticat dhe zbaticat e jetës? Dhe si mund të shpëtojmë?"*

Po ashtu, nuk duhet të zhytesh në pyetje të shpikura me logjikë të cekët dhe të mangët në mënyrë të qëllimshme, duke

mos i parë mirësitë e Allahut dhe duke qenë mosmirënjohës ndaj Tij.

Duhet ditur se;

Ateistët dhe deistët kapen gjithmonë pas pyetjeve të njëanshme dhe të palogjikshme me interpretime të pallogaritura. Kur bëhet fjalë për krijimin e gjithësisë dhe në mënyrë të veçantë të njeriut, ata janë gati të pranojnë se arti s'ka artist, mjeshtëria nuk ka mjeshtër dhe shkaqet nuk kanë shkaktar.

Shejh Sadi ka thënë:

"Për njerëzit e mençur, çdo gjethe peme është një poezi e mrekullueshme që dëfton Allahun. Ndërkohë që për të shkujdesurit, të gjitha pemët nuk vlejnë as sa një gjethe."



Nëse Allahu e di se ne do të hyjmë në Xhenet apo në Xhehenem, atëherë përse na sprovon? Mirëpo, ata harrojnë se, vetë ata, për të dhënë vetëm një copë letre të thjeshtë, të cilën e quajnë certifikatë apo diplomë, bëjnë provime pas provimi për vite me radhë në emër të arsimimit.

Në këtë mënyrë, indiferentët vazhdojnë të vijnë vërdallë si të mjerë në pikën e verbër të mendjes, sikur gjoja atyre pyetjeve nuk mund t'u jepet përgjigje dhe se do të vërtetohet që ata kanë të drejtë. Në fakt, ata, edhe pse mund të jenë të ditur, kanë zgjedhur injorancën dhe fatkeqësinë e moskuptimit të përgjigjes më të fuqishme dhe të jetuarit në mohim, i cili gjoja u jep të drejtën e mos përgjegjësisë.

Në këtë mënyrë;

Megjithëse kjo ka të bëjë plotësisht me ta dhe se fundi i hidhur do t'i shkatërrojë po ata, për fat të keq, ata shfaqin këmbëngulje të çuditshme



Duhet të përqendrohesh siç duhet tek pyetjet; "Pse jemi krijuar? Nga kemi ardhur, për ku dhe pse po shkojmë? Si duhet të përgatitemi për baticat dhe zbaticat e jetës? Si mund të shpëtojmë?".

përballë çështjeve madhore. Dhe këtë e bëjnë vetëm e vetëm që të jetojnë si krijesa moskokëçarëse, dembele, pa ndjenja dhe pa vetëdije, përballë përgjegjësive të cilat konsiderohen të vështira për ta. E thënë ndryshe, ata sillen kështu me qëllim që të zhyten në një botë çnjerëzore, ndërkohë që janë njerëz.

Për shembull, ata thonë:

"Nëse Allahu e di se ne do të hyjmë në Xhenet apo në Xhehenem, atëherë përse na sprovon?"

Mirëpo, ata harrojnë se;

Vetë ata, për të dhënë vetëm një copë letre të thjeshtë, të cilën e quajnë çertifikatë apo diplomë, bëjnë provime pas provimesh për vite me radhë në emër të arsimimit. Ata veprojnë kështu sepse e dinë që dembeli do të mbesë në klasë, ndërsa nxënësi i mirë do të kalojë. Më pas, kur duan ta marrin në një punë, i kërkojnë vetëm diplomat që i janë dhënë sipas kritereve të suksesit në provimet e shumta. Përndryshe, as nuk e shohin me sy atë punë.

Tani;

Nëse dikush, i cili vepron me një sistem të tillë në të gjithë botën, refuzon idenë e sprovimit nga Zoti, dhënies së një diplome dhe përcaktimit të një vendi ku do shkojë në bazë të rezultateve, atëherë bie në një kundërshtim absurd me vetveten.

Ndërkohë që vetë ai i bën të tjerët të përjetojnë humb-

je apo fitore në bazë të sistemit të provimit dhe diplomës, me çfarë logjike e quan të gabuar të njëjtin veprim nga ana e Allahut?


Sa bukur e kanë thënë të moçmit:

Nuk lyhet (nuk ndotet) **dielli me baltë!**

Gjendja e ateistëve dhe deistëve i ngjan humbjes së diellit në mes të ditës. Ai që ka rënë në indiferencë, i ngjan anijes që i është thyer timoni në mes të oqeanit dhe nuk dihet se në cilën vorbull do të mbytet.

Zoti ynë i Madhëruar na bëftë prej atyre që shohin të ndriçuar me Kuran dhe besim, e jo prej atyre që verbojnë veten dhe shohin kuturu!


Amin!..



"Atij nuk mund t'i afrohet gënjeshtra nga asnjëra anë. Kjo është shpallje prej një të Urti që meriton të gjitha lavdet."

(Fussilet, **42***)*





Një përgjigje e mrekullueshme logjike për ata që nuk mendojnë:

"A nuk sheh njeriu se si Ne e krijuam atë prej pikës së farës, e megjithatë ai bëhet kundërshtar i hapët?!

Ai na sjell shembull, duke harruar krijimin e vet dhe thotë: «Kush do t'i ngjallë eshtrat kur të kalben?»

Thuaj:

«Do t'i ngjallë Ai që i krijoi ato për herë të parë; Ai ka njohuri të plotë për çdo krijesë.»" *(Jasin, 77-79.)*

Paralajmërim hyjnor për mohuesit:

"A s'ka qenë një pikë fare që derdhej, pastaj u bë droçkë gjaku e më pas Allahu e krijoi dhe i dha formë e përmasa të caktuara, e prej tij bëri çiftin: mashkullin e femrën?! Vallë, Ai Krijues, a nuk ka fuqi që t'i ngjallë të vdekurit?!"

(Kijame, 37-40)



Allahu i Madhëruar urdhëron:

"A mendon njeriu se nuk do të mund t'i mbledhim eshtrat e tij?! Po, si jo! Ne jemi të Zotë t'ia ribëjmë bashkë me përsosmëri edhe majat e gishtave të tij." *(Kijame, 3-4)*

Mrekullia e shenjave të gishtave:

Allahu i Madhëruar na e bën të ditur këtë vepër të Tij të mrekullueshme që prej 1400 e ca vitesh. Pra kjo e vërtetë, të cilën perëndimi e ka zbuluar afro një shekull më parë dhe e ka quajtur "shkenca e daktiloskopisë", na është bërë e ditur nga Allahu para 1400 e ca vitesh.

Ja pra një prej mrekullive të panumërta të Kuranit!

